

**RINTEGRIMI I TË RINJVE MIGRANTË NË SHQIPËRI;
SFIDAT DHE PROBLEMET QË AI SHFAQ
NË ARSIMIN E LARTË PUBLIK DHE JOPUBLIK**

SILVANA AGO

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës,
në Fakultetin e Shkencave Sociale, me profil Sociologji-Antropologji
Sociale, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr.Aleksandër Dhima

Numri i fjalëve: 51,089

Tiranë, Janar 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË

Në përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se ky punim është i shkruar prej meje, në kërkim të gradës Doktor Shkencash në sociologji. Deklaroj që punimi nuk është prezantuar asnjëherë më parë nga dikush tjetër dhe nuk është botuar në tërësi dhe në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban materiale të shtuara nga ndonjë individ tjetër përveç rasteve të mirë cituara nga ana ime edhe të referuara. Të gjitha përfundimet nga autorë të tjerë janë referuar nga ana ime me hollësi duke respektuar gjithmonë punimin origjinal në formë. Asnjë pjesë e këtij studimi nuk mund të kopjohet, riprodhohet apo dhe të shumëfishohet pa lejen e autorit të këtijdisertacioni shkencor.

E drejta e autorit @ 2020 të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

ABSTRAKT

Punimi shkencor merr në studim fenomenin e migracionit në vendin tonë. Ky punim vendos në qendër të studimit kategorinë e të rinjve studentë që janë kthyer nga emigracioni. Studimi merr në shqyrtim të rinjtë migrantë nga mosha 18-24vjeç dhe fokusohet tek ri-integrimi i tyre në universitetet shqiptare. Duke marrë parasysh krizën ekonomike që po kalojnë vendet e Ballkanit dhe Europa shumë nga të rinjtë migrantë janë ndjerë të detyruar të rikthehen në Shqipëri, vetëm ose me familjet e tyre. Shumica nga këta të rinj ende nuk kanë përmbyllur studimet. Atyre ju duhet të ri-integrohen jo vetëm me jetesën e tyre në vendin e origjinës por edhe të përshtaten me jetën universitare. Ata janë kryesisht të rinj të kthyer nga migracioni nga vendet fqinje si Greqia dhe Italia etj. Objekti i studimit janë rishikimi i politikave sociale dhe reforma arsimore që ofron vendi ynë për këta të rinj. Gjithashtu pjesë e objektit kërkimor është edhe studimi i mekanizmave që përdorin universitet shqiptare në ri-integrimin e tyre në jetën universitare dhe atë akademike. Hipoteza që shtrohet është "Institucionet e Arsimit të Lartë në vendin tonë janë ende të papërgatitura për të gjetur zgjidhje dhe alternativa institucionale në ri-integrimin e studentëve që janë kthyer nga migracioni".

Në këtë studim janë përfshirë 200 studentë migrantë të kthyer në vitet e fundit të cilët vazhdonin studimet në institucionet arsimore të vendit. Shpërdarja e intervistave është bërë në mënyrë të barbartë midis universiteteve publike dhe jo publike. Intervistat janë zhvilluar në mënyrë të drejtpërdrejt (ballë për ballë) dhe në formatin online. Krahas studentëve në intervistim janë përfshirë edhe zyrtar pranë universiteteve.

Fjalët kyçe: migrim, student, universitet, ri-integrim, Shqipëria

ABSTRACT

This paper provides an opportunity to study the phenomenon of reintegration of Albanian migrants and mainly Albanian youth returnee in the last years. Taking into account the economic crisis facing the Balkan countries and Europe, many of the young migrants have felt obliged to return to Albania alone or with their families. They are young people returning from emigration from neighboring countries like Greece and Italy. In the study the focus was on young people aged 18-24. Therefore, the study aims to highlight the impact of Albanian society on the reception of these migrants, as well as to reflect educational reforms on their education and education. The returnees are young people who are still in the study phase. Most of these young people have not yet completed their studies. They need to reintegrate not only with their lives in our country but also adapt to university life. The subject of the study is the social policies and educational reforms that our country offers to these young people. Also part of the research area is the study of the mechanisms that Albanian universities use in their integration of university and academic life.

The hypothesis that we try to emphasize in this paper is precisely the fact that: "our country is still very unprepared to find solutions and institutional alternatives in re-integrating students who have returned from emigration".

This study included 200 returning migrant students who were studying in educational institutions in the country in recent years. Interviews are distributed equally between public and non-public universities. The interviews were conducted live (face to face) and online. In addition to the students interviewed, the university offices are also included.

Key words: Migration, Students, University, Reintegration, Albania

DEDIKIMI

Për doktor Razip Agon

Përpara teje dhe Zotit unë përulem me krenari, baba!

FALENDERIME

Janë të shumtë ata që dua të falenderoj dhe t'iu shpreh mirënjohjen time për të gjithë mbështetjen e dhënë në këtë studim. Fillimisht falenderoj Universitetin European të Tiranës për mundësinë e studimeve pranë këtij institucioni, të gjithë stafin akademik të këtij universiteti me të cilët më është dhënë rasti të kem mundësi të shkëmbej eksperiencë të vyera në studimet e mia doktorale. Mund të jenë të panumërta vështirësitë dhe pengesat që më janë paraqitur në këtë studim, por pa mbështetjen, sugjerimet dhe gadishmërinë e mentorit tim shkencor Prof.Dr. Aleksandër Dhimes si edhe sugjerimet e domosdoshme të profesor Prof.Asc.Dr. Tomi Treska nuk do të kisha arritur në këtë disetracion shkencor.

Dua të falenderoj gjithashtu të gjithë studentët e kthyer nga emigracioni në të gjitha universitetet shqiptare që pranuan të jenë pjesë e këtij kërkimi si dhe të gjitha zyrat e institucioneve për gadishmërinë në dhënien e informacioneve. Nuk dua të lë pa falenderuar familjen time për gjithçka, sidomos babain tim, të cilit ja dedikoj këtë punim shkencor, sepse ky ka qënë ëndërra jonë e përbashkët. Nuk mund të lë pa anashkalur Mozën dhe Maksin, dy miqtë e mi që bashkëpunuan me mua për intervistat në të gjitha universitetet e vendit. Në fund nuk mund të lë pa falenderuar vëllain tim Dr.Orjon Ago për mbështetjen dhe sugjerimet.

Mirënjohje për të gjithë ju!

Tabela e përmbajtjes

KAPITULLI I

HYRJE	1
1.1 Qëllimi i studimit.....	5
1.2 Qasja e studimit	7
1.3 Pyetjet kërkimore të studimit.....	8
1.4 Modeli konceptual i temës dhe parashtrimi i hipotezave.....	9
1.5 Hipotezat e studimit.....	9
1.6 Struktura e studimit	10
1.7 Rëndësia e studimit.....	12
1.8 Kufizimet e studimit	13
1.9 Përkufizimi i termave kyç të përdorura në studim.....	15

KAPITULLI II

FENOMENI I MIGRACIONI DHE QASJET INTERPRETATIVE TË TIJ	18
2.1 Koncepti i migracioni të kthimit	18
2.2 Tipologjitë e migracionit	20
2.3 Faktorët e migrimit	26
2.4 Qasjet interpretative sipas migracionit të kthimit	33
2.4.1 Qasja ekonomike	33
2.4.2 Qasja Strukturore mbi migracionin e kthimit	36
2.4.3 Qasja Sociologjike: Transnacionalizmi	39
2.4.4 Qasja socio-psikologjike: procesi i ri-akulturimit	41
2.5 Këndvështrim mbi lëvizjet migratore në Shqipëri	48
2.6 Efektet e migrimit pas viteve '90 në Shqipëri.....	56

KAPITULLI III

RI-INTEGRIMI I STUDENTËVE TË KTHYER NË UNIVERISITETET SHQIPTARE	67
3.1 Dimensioni dhe fuqia e Kartës së Bolonjës në ndërkombëtarizmin e diplomave	67
3.2 Funksioni i Kartës së Bolonjës	73
3.3 Kuadri ligjor i Arsimit të Lartë si rregullator për kategorinë e studentëve migrantë	80

KAPITULLI IV

METODOLOGJIA	89
4.1. Metodat e përdorura.....	89
4.2. Triangulimi metodologjik	91
4.3 Analiza statistikore e të dhënave sasiore	94
4.4 Modeli Ekonometrik i analizës së të dhënave cilësore.	95
4.5 Instrumentët matës të metodologjisë	96

4.6 Struktura e intervistës për institucionet.....	105
4.7 Vlefshmëria e të dhënave të rezultateve të punimit	107
4.8 Përzgjedhja e kampionit/popullatës.	109
4.9 Përcaktimi i variablave	114
KAPITULLI V	
REZULTATET E STUDIMIT DHE ANALIZA.....	115
5.1. Statistika Përshkruese (sesioni 1)	115
5.2 Motivet e rikthimit (Sesioni 2).....	122
5.3 Përfshirja e studentëve në jetën universitare (Sesioni 3).....	130
5.4 Problemet që hasin studentët e rikthyer (Sesioni 4).....	137
5.5 Jeta pas kthimit(Sesioni 5).....	142
5.6 Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët (Sesioni 6)	147
5.7 Analiza e të dhënave nga pyetsorët në institucionet e universiteteve pubike dhe jo publike	152
5.7.1 Zyrat e Këshillimit të Karrierës	159
5.8 Regresioni i shumfishtë	169
5.9 Testimi i hipotezës	172
5.10.Rezultatet e regresionit	173
5.10.1 Hipoteza	173
KAPITULLI VI	
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	177
6.1 Përfundime	177
6.2 Rekomandime.....	194
BIBLIOGRAFIA.....	198
SHTOJCA.....	213

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1: Modeli konceptual i temës	9
Figura 2-1: Format e Migrimit (Dustmann & Weiss, 2007)	22
Figura 2-2: Ri-integrimi i suksesshëm (Cassarino, 2004)	36
Figura 2-3: John W. Berry “Immigration, Acculturation and Adaptation”	45

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 2-1: Numri i të kthyerve (në mijë).....	66
Grafiku 5-1: Gjinia e studentëve të intervistuar.....	115
Grafiku 5-2: Mosha e studentëve të intervistuar.....	116
Grafiku 5-3: Viti akademik i studentëve të kthyer.....	117
Grafiku 5-4: Universiteti ku janë zhvilluar intervistat.....	118
Grafiku 5-5: Preferencat studimore të të kthyerve.....	119
Grafiku 5-6: Orientimi për të ndjekur studimet.....	120
Grafiku 5-7: Konsultimi për të zgjedhur këtë universitet.....	121
Grafiku 5-8: Ideja e kthimit u vendos vetëm pas krizës ekonomike.....	122
Grafiku 5-9: Ideja e rikthimit deri në momentin e kthimit ka qënë diçka nostalgjike.....	123
Grafiku 5-10: Vendimin për t'u kthyer në Shqipëri:.....	124
Grafiku 5-11: A e patët të vështirë kthimin në Shqipëri.....	125
Grafiku 5-12: Njohuri mbi migracionin e kthimit.....	126
Grafiku 5-13: Burimet e informacionit të migracionit të kthimit.....	127
Grafiku 5-14: A ekziston mundësia e ri-emigrimit familjar.....	128
Grafiku 5-15: Emigrimi i studentit përsëri pas mbarimit të studimeve.....	129
Grafiku 5-16: Ndjesia e studentëve në universitete.....	130
Grafiku 5-17: Ndihma nga stafi univeritar kundrejt të kthyerve.....	131
Grafiku 5-18: Sa të ri-integruar ndjehen studentët e kthyer.....	132
Grafiku 5-19: Kontributi nga ana e universiteteve për ri-integrimin e studentëve.....	133
Grafiku 5-20: Ftesa në aktivitete.....	134
Grafiku 5-21: Pjesëmarrja në klubet universitare.....	135
Grafiku 5-22: Pjesëmarrja në qeverinë studentore.....	136
Grafiku 5-23: I detyruar për të ndjekur leksionet edhe pse ato janë fakultative.....	137
Grafiku 5-24: Të detyruar për të ndjekur aktivitete që nuk kanë lidhje me studimet.....	138
Grafiku 5-25: Si janë marrëdhëniet pedagog-student?.....	139
Grafiku 5-26: Detyrimi për të blerë libra pa dëshirë.....	140
Grafiku 5-27: Presioni i për të mos folur për probleme pasi ndikon në vlerësimin.....	141
Grafiku 5-28: Me kë jetoni.....	142
Grafiku 5-29: Gjendja ekonomike.....	143
Grafiku 5-30: Shpenzimet mujore.....	144
Grafiku 5-31: Mbështetja e familjes në të gjitha drejtimet dhe në pagesën e shkollës.....	145
Grafiku 5-32: Vështirësitë në shkollë dhe biseda rreth tyre në familje.....	146
Grafiku 5-33: Komunikimi me bashkëmoshatarët për çdo gjë të rëndësishme.....	147
Grafiku 5-34: Paragjykimi i shoqërisë për të rinjtë e rikthyer.....	148
Grafiku 5-35: Ndihmesa nga bashkëmoshatarët.....	149
Grafiku 5-36: Shoqëria me migrantë dhe jo-migrantë.....	150
Grafiku 5-37: Kurioziteti i shoqërisë rreth eksperiencës së këtyre të kthyerve.....	151
Grafiku 5-38: Shoqërimi i të rinjve studentë me bashkëmoshatarët e tyre.....	151

LISTA E TABELAVE

Tabela 4-1: Të kthyerit shqiptarë sipas grupmoshës(INSTAT, 2016).....	110
Tabela 5:1 Përfaqësimi i zyrave të këshillimit të karrierës sipas univesiteteve.....	168
Tabela 5-2: Faktorët e ndikimit në ri-integrim.....	171
Tabela 5-3: Përmbledhja e modelit të regresionit	174
Tabela 5-4:Tabela ANOVA	175
Tabela 5-5:Koeficientet.....	176

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AFALC-Forumi Shqiptar për Aleancën dhe Civilizimin

APEK -Këshilli Ekonomik Paqësor Atlantik

DAR-Drejtoria Arsimore Rajonale

ESU-European Student University

IDK-Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit

INSTAT- Instituti Ndërkombëtar i Statistikave

IOM- Organizata Ndërkombëtare për Migrimin

MASR-Ministria e Arsimit e Sporteve dhe Rinisë

NELM-Ekonomia e Re e Migracionit të Punës

OJQ-Organizata Jo Qeveritare

OKB-Organizata e Kombeve të Bashkuara

OECD- Organizata Europiane e Komuniteteve dhe Departamentit

SENJOD-Sektori i Njohjeve të Diplomave dhe i Bashkëpunimit Ndërkombëtar

UN/ DESA-United Nations Department of Economic and Social Affairs

UNECE -United Nations Economic Commission for Europe

UNESCO-United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization

RPSSH –Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë

ZA-Zyrat Arsimore

KAPITULLI I

HYRJJE

Një nga aspektet më të rëndësishme të shkencës së sociologjisë është studimi i “*Migrimit njerëzor*”. Që prej vitit 1960, migracioni i kthimit dhe lëvizja e lirë e njerëzve ka qenë objekt i disiplinave sociale, gjeografisë, sociologjisë, demografisë, ekonomisë dhe disiplinave të tjera të ngjashmeduke tërhequr së tepërmi vëmendjen e studiuesve. Migracioni në ditët e sotme po bëhet edhe më kompleks. Migracioni po shtohet së tepërmi për shkak të faktorëve politikë, ekonomikë apo gjeopolitikë.

Migracioni është i shpërndarë pothuajse në të gjitha zonat e globit. Migracioni më i madh është normalisht në zonat me klimë dhe ekonomi më të favorshme. Në pjesë të ndryshme të botës migracioni bëhet për shkaqe të ndryshme. Në rajonet e zhvilluara si Europa apo SHBA, migracioni është i karakterit ekonomik, ndërsa në vendet më pak të zhvilluara migracioni është i karakterit politik. Në këtë këndvështrim migracioni shtrihet në rang global dhe prek të gjitha shtetet (Bazeley, 2002).

Të gjitha këto forma të migracionit mund të sjellin pasoja pozitive ose negative si për vendin ku ata vendosin të migrojnë qoftë edhe për vendin e origjinës. Studiuesit janë përpjekur të studiojnë fenomenin e migrimit nga këndvështrime të ndryshme. Migrimi është një term që përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të lëvizjeve të njerëzve. Migrimi si proces i shumanshëm prek ekonominë, politikën dhe ndikon në lëvizjen e lirë.

Gjysma e dytë e shek të XX dhe vitet e para të mijëvjeçarit të ri ka parë një rritje të migracionit për shkaqe të ndryshme. Migracioni ndodh për shkak të konflikteve, persekutimit, degradimit dhe ndryshimit të mjedisit social, si dhe mungesës së thellë të

sigurisë njerëzore (Bazeley, 2002). Krahas migracionit të rregullt egziston edhe migracioni ilegal. Migracioni i parregullt përbën shqetësimin më të madh që kanë sot vendet e zhvilluara si Europa apo SHBA. (Datta, 2013)

Shumica e migrantëve, migrojnë në vendet me të ardhura të larta dhe që janë më sigurta për punësim. Puna është arsyeja kryesore që njerëzit migrojnë. Punëtorët migrantë përbëjnë një shumicën e migrantëve në botë. Shumica e tyre jetojnë në vendet me të ardhura të larta dhe janë shumë të angazhuar në sektorin e shërbimeve.

Si pasojë e rritjes së këtij fenomeni shtetet e kanë bërë migracionin pjesë të axhendave të tyre politiko-ekonomike dhe migracioni ndikon sidomos në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Rëndësia e migracionit për prosperitetin ekonomik, zhvillimin njerëzor dhe sigurinë tregon që migracioni mbetet një përparësi kryesore për të ardhmen. Marrëveshjet ndërkombëtare midis vende po i japin një rëndësi edhe statusit të migrantit. Politikat sociale mbi fenomenin e migracionit mbeten ndër politikat më të rëndësishme.

Migracioni i viteve të fundit ka ndikuar shumë për rritjen ekonomike prandaj shtete të ndryshme ndërrmarin hapa të rëndësishme për të kontrolluar migracionin. (IOM, 2018)

Mediat publikojnë të dhëna të rëndësishme mbi numrin e migrantëve. Nga diskutimet dhe debatet e shumta si ato politike, sociale dhe mediatike mbi migracionin si dhe nga përvojat, njohuritë dhe analizat e bëra rezulton që migracioni është një proces vazhdimisht në lëvizje. Sidoqoftë, diskutime të tilla vazhdojnë të jenë kritike në lidhje me format dhe manifestimet e ndryshme të migrimit, si edhe dhënien e zgjidhjeve për sfidat që paraqet migracioni. (IOM, 2018)

Duke u bazuar në rritjen e migracionit gjatë viteve të fundit, ka të ngjarë që vlerësimi i ardhshëm i numrit të migrantëve në rang global sipas të dhënave të (UNDESA, 2003) të

tregojë një rritje të mëtejshme. Për shembull, në vitin 2003, numri i migrantëve përbënte 2.6% të popullsisë globale ose 230 milionë migrantë. Sipas të dhënave të vitit 2010 migrimi global është në një nivel të lartë se ai i viteve 2003, me numrin e të migruarve mbi 40 milionë migrantë më shumë dhe numrin e refugjatëve 22 milionë më shumë krahasuar me atë vitit 2003(European Commision, 2010). Sipas këtyre parashikimeve shifrat tregojnë se numri i migrantëve do të rritej në nivel global, me 3.3% më shumë krahasuar me popullsinë e një dekadë më parë. (European Commision, 2010) Siç është vënë re, rritja e migrantëve ka qenë mjaft e dukshme në dekadën e fundit. Parashikimet për të ardhmen vlerësojnë se në vitin 2050 numri do të shkojë 405 milionë migrantë në nivel global. Megjithatë, demografët theksojnë se *“migrimi ndërkombëtar në të kaluarën ka patur luhatshmëri të madhe dhe si pasojë e këtyre ndryshimeve do të ishte vështirë të projektohej me saktësi numri në të ardhmen*. Ndër vendet më të preferuara për migrim mbeten Europa dhe Azia, me një numër gati rreth 75 milionë migrantë (IOM, 2018).

E gjithë nga kjo pasiguri, është e lidhur ngushtë me ngjarje gjeopolitike dhe ekonomike si kriza financiare globale në 2008 dhe konflikti aktual në Republikën Arabe të Sirisë etj, ka të ngjarë që kjo tendencë të vazhdojë të rritet. Autorë si Brady vënë dukje se: “BE ka një rol mjaft kompleks në menaxhimin e flukseve të migracionit dhe ndoshta është mirëmenaxhimi i flukseve migratore, që i shtyn migrantët nga vendet e Azisë drejt Europës”(Brady, 2008).

Këto shifra gjithnjë e në rritje bëjnë që migracioni të shihet si një rrezik për BE-në, e cila ka qenë gjithnjë e kërcënuar nga një rritje e numrit të migrantëve të paligjshëm. Për këtë Bashkimi European parashikon para së gjithash një grant ekonomik të përbashkët në lidhje

me menaxhimin e këtyre migrantëve. Nga ana tjetër kjo shfaqet si një mundësi e migrantëve për të përfituar. Europa shihet si një oaz paqeje dhe rajon që tërheq gjithmonë migrantë.

Eurozona po përballlet me fenomenin tjetër në aspektin e kontekstit demografik, atë të plakjes së popullsisë. Plakje e popullsisë do të thotë pamundësi për të mbuluar nevojat e punës e cila do të favorizonte migrantët të punësohen në këtë rajon (European Commission, 2009).

Kriza europiane ndikoi në sistemin arsimor prandaj në këtë periudhë u vunë re inisiativa të shumë vendeve për të qënë pjesë e marrëveshjeve ekonomike, politike dhe arsimore. Sipas Bashkimit European në vitin 2020 pritet të ketë ndryshime të mëdha. Europa pritet të dalë nga kriza ekonomike dhe kjo presupozon rritje më të mëdha të shërbimeve në sektorin e “jakëbardhëve”. Rritja ekonomike do të kërkojë specialistë të ndryshëm. Sipas strategjisë së Bashkimit European kjo rritje nënkupton fuqizimin e njerëzve nga pikëpamja ekonomike dhe do të nxisë edhe punësimin. Pasojë e kësaj do të jetë nevoja për më shumë cilësi në arsim. Kjo do të kërkojë investime më të mëdha në rritjen e kualiteteve njerëzore, modernizimin e tregut të punës dhe garantimin e një shoqërie të qëndrueshme (IOM, 2018). Sidoqoftë po sipas studimeve të bëra nga BE rezulton se nëse migracioni nuk menaxhohet në mënyre korrekte ai ka rrezik të japë efekte jo pozitive tek vendet antare të BE-së. Sipas të dhënave të fundit nga Euro-Zona, numri i migrantëve të paligjshëm sa po vjen dhe po rritet, si rrjedhojë edhe numri i atyre që aplikojnë për tu pajisur me dokumentacion për qëndrim të përhershëm është i madh. E ndodhur në këto kushte sidomos Europa has vështirësi për të përballuar tryshninë hyrëse të migranëve. Kjo tryshni hyrëse e migrantëve lidhet me dëshirën e tyre jo vetëm për t’u pajisur me dokumenta por edhe me integrimin e tyre në vendin ku ata kanë migruar. Duke marrë parasysh faktorët social në lidhje me

fenomenin e migracionit fëmijët e lindur në migrim përshtaten me kulturën e vendit ku ata janë vendosur. Ata krijojnë identitetin e tyre të ngjashëm me atë të banorëve të vendit ku janë vendosur. Prandaj edhe procesi i migracionit është në vetvete një hallkë e rëndësishme e lëvizjes. Lëvizje e cila krahas aspektit gjeopolitik prek aspektin social.

Ky fenomen prek pa dyshim edhe vendin tonë. Ky fenomen gjatë viteve të fundit është bërë shumë i ndjeshëm. Si rezultat nga sa përmendëm më sipër fenomeni imigracionit ka sjellë pasoja për migrantët shqiptarë të cilët janë kthyer. Kjo do të thotë që migrantët shqiptarë të rikthyer tashmë do të hasin vështirësi për tu ri-integruar në vendin e origjinës.

1.1 Qëllimi i studimit

- ✓ *Së pari* rishikimi i politikave sociale dhe reformave arsimore që ofron vendi ynë për kategorinë e të rinjve të sapo kthyer nga emigracioni. Kjo nënkupton rishikimin e politikave që kanë ministratë përkatëse për këtë kontigjent migrantësh. Sigurisht në këtë këndvështrim qëllimi kryesor është që të shihet me përparësi roli që luan Ministria e Arsimit Sportit dhe e Rinisë në rishikimin e këtyre politikave dhe ndërmarrjen e reformave për t'iu ardhur në ndihmë studentëve të kthyer. Të japë një pasqyrim sa më real të numrit të të rinjve migrantë të rikthyer që duan të ndjekin Arsimin e Lartë në universitetet shqiptare. Të rishikojë më përparësi rolin dhe funksionin që luajnë universitetet për këtë kategori studentore.
- ✓ *Së dyti* rishikimi i mekanizmave që përdorin universitet për ri-integrimin e studentëve migrantë në jetën studentore. Krahas rolit që kanë institucionet e arsimit dhe Ministria e Arsimit një nga qëllimet kryesore mbetet rishikimi i mekanizmave që përdorin universitet publike dhe jo publike. Qëllimi kryesor në këtë aspekt është ai

kontrollit të këtyre mekanizmave në mënyrë që të shihet sa funksionale dhe ndihmuese janë për studentët migrantë. Të bëhet një analizë e thelluar në lidhje me rolin që kanë universitetet në procesin e ri-integrimit të studentëve si edhe të analizohet pozicionimi që kanë universitetet aktualisht. Të analizojë ndikimin e shërbimeve të ofruara në universitetet shqiptare në mënyrë që të sjellë një formë më bashkëkohore në ri-integritetin e të rinjve migrantë të sapo ardhur nga një eksperience nga vendet e Europës

- ✓ *Së treti* garantimi i vazhimit të studimeve duke ju përmbajtur reformave arsimore në përputhje me direktivat arsimore të BE-së. Një nga qëllimet kryesore në këtë studim është siguria që duhet t'iu garantohet studentëve për vazhdimin e studimeve të lëna në mes në përputhje me sistemin e Kartës së Bolonjës.
- ✓ *Së katërti* të verifikojë rolin parësor që luajnë zyrat e Këshillimit të Karrierës në procesin e ri-integrimit të studentëve. Të rishikohet funksioni dhe roli që luajnë këto zyra në angazhimin e studentëve në jetën studentore dhe në mundësinë për punësim. Të parashtrijë problematikat që duhet të mbulojnë zyrat e Këshillimit të Karrierës dhe sekretaritë mësimore, në mënyrë që studentëve t'ju garantohet një ri-integrim sa më i shpejtë.
- ✓ *Së pesti* të analizohet thellësisht marrëdhënia bashkëpunuese që ofron vendi ynë me vendet ku studentët kanë qenë emigrantë. Të rishikohen mekanizmat dhe zgjidhjet bashkëpunuese ndërmjet rrugëve ndër institucionale.
- ✓ *Së gjashti* të paraqes problemet sociale që hasin këta studentë gjatë kthimit dhe të parashtrijë rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të mekanizmit social në mënyrë që ky mekanizëm të garantojë njëri-integrim më të shpejtë.

Këto janë së paku gjashtë qëllimet kryesore që ky studim ka marrë në konsideratë dhe që i shikon me përparësi për këtë kontigjent studentësh.

1.2 Qasja e studimit

Studimi është tepër specifik dhe shumë i veçantë në Shqipëri. Ky është një nga studimet e para mbi fenomenin migracionit mbi kategorinë e studentëve të kthyer. Ky është studimi i parë i cili trajton problematikat sociale dhe politike të institucioneve të larta arsimore mbi kategorinë e studentëve të kthyer nga emigracioni të cilët duan të vazhdojnë studimet e ndërprera në vendin ku ata kanë qenë emigrantë.

Migracioni në Shqipëri është trajtuar gjithnjë si emigracion dalës. Popullsia shqiptare më tepër ka qenë një popullsi e *migracionit dalës* sesa atij *hyrës*. Ky është një studim sociologjik pasi trajton një nga problemet shqetësuese në vitet e fundit dhe fokusohet në atë të migracionit. Studimi jep rezultate specifike si edhe qëndrime të rëndësishme sociale mbi fenomenin e ri-integrimit të të rinjve të kthyer nga migracioni.

Në këtë punim janë studiuar format e migracionit hyrës dhe dalës. Migracion hyrës si proces në vendin tonë ka filluar të vërehet si fenomeni lëvizjes gjatë vitit 2008 e në vazhdim. Në lidhje me faktorët dhe arsyet e kthimit janë evidentur me tepër faktorët me karakter ekonomik, social dhe politik. Tek aspektet politike janë trajtuar politikat dhe marrëdhëniet midis vendit të origjinës dhe atij pritës. Studimi ngjashëm në lidhje me problematikën e ri-integrimit është ai i vitit 2006 për nxënësit e kthyer nga migracioni i cili dha ndihmesë në evidentimin e problematikave të arsimit të parauniversitar.

Qasja studimore e bërë në këtë kërkim shkencor është një qasje sociologjike pasi trajton problematika të një grupi të caktuar si edhe evidenton problematikat sociale të vendit tonë në lidhje me këtë kategori shoqërore.

Një nga problematikat që krijon *migracion hyrës* trajton vështirësitë studentëve të kthyer nga emigracioni dhe merret me ri-integrimin e tyre. Në studime të ngjashme si këto janë evidentuar problematika kryesore sociale si ri-integrimi dhe dëshira për të qënë të përfaqësuar.

Duke analizuar problematika të tilla dhe duke parë kushtet në të cilat ndodhet aktualisht Shqipëria një studim i tillë do të ndihmonte në evidentimin e problematikave që kanë universitetet publike dhe jo publike në Shqipëri në lidhje me ri-integrimin e të rinjve të sapo kthyer nga emigracioni. Duke marrë shkas nga problematikat qasja studimore në kontekstin sociologjik është më e përshtatshme për të arritur në rezultatet që duam të arrijmë.

1.3 Pyetjet kërkimore të studimit

Gjatë këtij studimi lindën shumë pyetje të cilat çuan edhe në modelin dhe hartimin konceptual të temës, pyetje të cilat më vonë erdhën në ndihmë të hartimit të hipotezave. Nëpërmjet këtyre pyetjeve kërkimore synohet të analizohet situata e studentëve të kthyer dhe vëmendja e institucioneve ndaj këtij fokus-grupi të marrë në shqyrtim. Pyetjet kryesore të cilat ngrihet gjatë këtij studimi:

- Çfarë shërbime arsimore ekzistojnë për studentët migrantë ?
- Çfarë ndikimi kanë universitet publike dhe jo publike në ri-integrimin e studentëve në vendin e tyre?

- Sa aplikohet njehsimi/ekuivalentimi i diplomave të marra jashtë?!
- Cili është roli i Kartës së Bolonjës në njohjen e diplomave të marra jashtë vendit?
- Sa efektive janë rregullat e njehsimit/ekuivalentimit të diplomave?
- Cili është roli që luajnë zyrat e Këshillimit të Karrierës në procesin e rintegrimit?
- Sa ju garantohet punësimi studentëve mbas mbarimit të studimeve në vendin tonë?

1.4 Modeli konceptual i temës dhe parashtrimi i hipotezave




Figura1-1: Modeli konceptual i temës

1.5 Hipotezat e studimit

Në bazë të kësaj strukture konceptuale të studimit hipoteza jepen si më poshtë:

Hipoteza që parashtrohet në këtë punim është:

Hipoteza: “Institucionet e Arsimit të Lartë në vendin tonë janë ende të papërgatitura për të gjetur zgjidhje dhe alternativa institucionale në ri-integrimin e studentëve që janë kthyer nga emigracioni”.

Hipoteza kryesore është zbërthyer në disa nën hipoteza të cilat i vijnë nëndihmë hipotezës.

H1: “Praktikat e këshillimit mbi Asimin e Lartë nuk ofrojnë alternativa institucionale në ri-integrimin e studentëve që janë kthyer nga emigracioni”

H2: “Praktikat e këshillimit mbi Arsimin e Lartë ofrojnë alternativa institucionale në ri-integrimin e studentëve që janë kthyer nga emigracioni”

1.6 Struktura e studimit

Kapitulli I: Tek ky kapitull është përfshirë një paraqitje e përgjithshme e temës. Ky kapitull trajton qëllimin, objektivat e studimit, strukturën, rëndësinë, limitet e studimit, pyetjet kërkimore si dhe hipotezat. Kapitulli i parë përmban një paraqitje paraprake të tematikës dhe shpjegon elementet bazë të një punimi shkencor.

Kapitulli II: Ky kapitull paraqet një përmbledhje të literaturës së shqyrtuar për zhvillimin e këtij studimi. Literatura e huaj dhe kombëtare që shqyrtohet në lidhje me migracionin dheri-integrimin prek aspektin teorik. Trajton konceptin e teorive të migracionit. Rishikohen studimet e mëparshme dhe duke ju referuar atyre, formulon idetë mbi migrimin modern. Trajton modele të ngjashme studimore.

Ky është kapitulli më i madh për nga volumi i faqeve sepse bën shpjegime konceptuale dhe analiza të thelluara mbi emigracionin dhe migracionin. Ky kapitull na paraqet *fenomenin e migracionit, shkaqet e migracionit* si edhe *llojet e migracioni*. Në këtë kapitull trajtohet gjerësisht fenomeni i migracionit në vendin tonë. Kapitulli II ka rëndësi sepse na jep informacionin e mjaftueshëm për të vazhduar hulumtimin mbi bazën e modeleve të njohura. Gjithashtu ky kapitull trajton bazën e autorëve që kanë studjuar efektet migruese. Ky kapitull na prezanton shkollat dhe modelet e migrimit.

Kapitulli III: Kapitulli i tretë është konceptuar si një nga kapitujt që merret me pjesën e studimit të sistemit të Arsimit të Lartë. Kapitulli i III është realisht kapitulli i rëndësishëm për hulumtimin në fjalë. Ky është një kapitull ndihmues për të na orientuar në lidhje me mënyrën sesi funksionon sistemi universitar në vendin tonë, cilat janë politikat që ndjek ky sistem për ri-integrimin e kësaj kategorie studentore. Ky kapitull gjithashtu na parashtron alternativa dhe zgjidhje në bazë të marrëveshjeve që ka arritur sistemi ynë arsimor me vendet e tjera kryesisht ato të BE. Tek ky kapitull shtjellon reformat e sistemit arsimor ndër vite. Kapitulli III është parë si një lidhje midis fenomenit të migracionit dhe rrugës për integrim dhe është paraqitur kuadri ligjor për institucionet arsimore publike dhe jo publike.

Kapitulli IV: Kapitulli i IV shtjellon përdorimin e metodës sasimore dhe cilësore. Tek ky kapitull janë përpunuar të gjitha rezultatet e studimit sipas të dyjave metodave. Ky kapitull përfshin një analizë të kuadrit metodologjik. Pikërisht këtu kemi ndërthurur metodat për nxjerrjen e rezultateve mbi ri-integrimin e të rinjve. Tek ky kapitull do të rishikojmë në detaje elemente shumë të rëndësishëm të arsimit, të ndikimit të politikës si edhe të strukturave të migracionit. Ky është kapitulli i cili na jep përgjigjet që ne kemi kërkuar në të gjithë punimin, si edhe vërtetimin e hipotezës dhe matjen e variablave. Në këtë kapitull rezultatet janë ilustruar grafikisht dhe janë shprehur në shifra. Tek ky kapitull ne analizojmë vërtetimin e variablave dhe të hipotezës të cilën në bazë të përgjigjeve të marra e rrëzojmë ose e mbrojmë.

Kapitulli V: Kapitulli i pestë është bërthama e gjithë studimit. Tek ky kapitull janë respektuarta të gjithë pikat e prezantuara në kapitullin e parë si pyetjet kërkimore, hipotezat dhe kampionin e studimit. Kapitulli i pestë jep një analizë të përgjithshme të studimit.

Tek kapitulli i pestë ne merremi me instrumentat dhe më interpretimin e të dhënave, rezultatet e punimit duke patur parasysh metodat e kërkimit dhe interpretimin e të dhënave kërkimore. Tek kapitulli i pestë jepen përshkrimet e përgjigjeve të gjithë studimit dhe analiza e të dhënave të grumblluara gjatë gjithë studimit shkencor.

Kapitulli VI: Ky është kapitulli i cili jep zgjidhje dhe rekomandime dhe merret gjerësisht me nxjerrjen e rezultateve. Kapitulli i fundit argumenton përfundimet si edhe justifikon këto përfundime në bazë të rezultateve dhe të përgjigjeve të dhëna nga studentët. Tek ky kapitull është bërë një refletim në lidhje me punimin. Këtu ne paraqesim në mënyrë të përmbledhur rezultatet dhe arritjet e studimit si edhe qëndrojmë korrekt me pyetjet, hipotezën dhe variablat. Kapitulli i fundit rekomandon se çfarë risie mund të ketë në të ardhmen ky studim shkencor dhe se çfarë mund të përmirësohet.

1.7 Rëndësia e studimit

Ky studim ka një rëndësi të veçantë në Shqipëri sepse është ndër studimet e para që hedh dritë mbi studentët dhe të rinjtë migrantë në vendin tonë. Ri-integrimi i këtyre studentëve si në jetën sociale po ashtu dhe në univeristet përbën një risi sepse jep një pasqyrim të problemeve në universitetet shqiptare mbi kategorinë e migrantëve. Studimi ecën paralel me problemet e shumta që hasin të rinjtë e rikthyer nga migracioni, duke marrë parasysh faktin që këta të rinj tashmë janë kthyer me një potencial dhe dëshirë të re për të qënë pjesë e shoqërisë. Kjo gjeneratë e re gjithashtu kërkon të adoptohet me kulturën në vendin e tyre. Ky studim jep rekomandime për mënyrën e organizimit të kontekstit social në Arsimin e Lartë në lidhje me qasjen e të rinjve në shkolla dhe adaptimin e këtyre të rinjve në Arsimin e Lartë. Ofrimi i shërbimeve nga ana e institucioneve është një nga mundësitë më të mira që ju jepen studentëve. Pavarësisht reformave të shumta të Arsimit të Lartë dhe përpjekjes

së universiteteve publike dhe jo publike për të ri-integruar këta të rinj akoma ka shumë problematika. Ky studim gjithashtu kërkon të jetë një pikë reflektimi për ri-integrimin e të rinjve migrantë në arsimin tonë universitar. Parashikimet në bazë të dhënave të përgjigjeve të studentëve do të jenë një ndihmesë edhe për studimet e mëvonshme që do të kryhen në të ardhmen.

1.8 Kufizimet e studimit

Si çdo studim tjetër shkencor do të ishte ideale që edhe ky studim të mos kishte asnjë kufizim, por gjatë këtij studimi hasëm vështirësi. Deri më tani përveç të dhënave nga INSTAT dhe IOM nuk ka shifra konkrete apo studime të mirëfillta në lidhje me këtë grup shoqëror. Duke qënë se modele kërkimore në lidhje me ri-integrimin në përgjithësi janë bërë shumë pak dhe për këtë mund të themi se ky studim është i pari në llojin e tij. Fokus grupi i i marrë në shqyrtim janë vetëm studentët e kthyer nga emigracioni të moshës 18-24 vjeç gjë që limiton kufijtë e këtij studimi. Për rrjedhojë mungesa e studimeve shqiptare e kanë bërë tepër të vështirë edhe modelin teorik të këtij punimi. Ky model është marrë nga modele të autorëve të huaj dhe pse kemi të bejmë me një problem tërësisht shqiptar.

Grumbullimi i të dhënave dhe kërkimi i informacionit në zyrat përkatëse si në Ministrinë e Arsimit apo edhe në universitet tona publike dhe jo-publike ka hasur probleme gjatë rrugës. Vështirësi gjithashtu kemi hasur edhe tek vetë zyrat përkatëse të cilat nuk ishin të gatshme të bashkëpunonin me ne, sepse për ta nuk përbënte interes një temë e tillë. Grumbullimi i informacionin për të gjetur numrin e studentëve të përfaqësuar ishte një hallkë me vete, pasi as një institucion nuk kishte shifra të sakta mbi numrin e studentëve të kthyer.

Duhet theksuar se hasëm vështirësi edhe në vendosjen e kontakteve me sekretaritet mësiomore dhe zyrat e Këshillimit të Karrierës të cilat shpesh herë na ofronin informacione “të thata” dhe jo fort ndihmëse. Grumbullimi i informacioneve të ashtuquajtura “gri” sepse ishin informacione dytësore fillimisht ishin të vaktat. Duhet thënë se në dispozicion nuk ka u vunë dokumenta zyrtare. As edhe një nga universitetet e vendit nuk na dha një numër mbi studentët e kthyer. Të dhënat e përfituara nga sekretaritet dhe zyrat e Këshillimit të Karrierës njihnin raste të studentëve të kthyer por nuk kishin numër statistikor mbi numrin e të kthyerve. Vështirësia e dytë ishte bindja e sekretareve për të marrë pjesë në intervistë pasi një pjesë e tyre nguronin të jepnin informacion për shkak të vendit të punës. Ato mendonin se kjo intervistë mund të cënonte pozicionin e tyre të punës.

Duhet të veçojmë Universitetin Europian të Tiranës i cili nuk na vendosi limite. Ky ishte i vetmi universitet që kishte numra ndër vite të studentëve të kthyer. Madje ishin të gatshëm të na ndihmonin edhe me kryerjen e intervistave.

Kufizim tjetër ishte grumbullimi i informacionit nga zyrat e institucioneve. Kjo dhe për shkak se gjatë intervistave, intervistuesit nuk kanë pasur dëshirë t’ju përgjigjen pyetjeve ose kanë dhënë informacion shumë të përgjithshëm. Të gjitha këto mangësi informacionesh përkundrejt kësaj tematike në identifikimin e *grupit përfaqësues të studentëve* ka qënë një mangësi me vete. Pavarësisht problemeve që janë hasur në këtë kërkim shkencor mund të themi që ky është një studim me qasje pozitive pësa i përket trajtimit të çështjeve sociale, si edhe ka evidentuar problematika në lidhje me studentët migrantët, duke nxjerr në pah problematika të cilat studiues të tjerë nuk i kanë marrë më parë në studim. Si rezultat, ka pasur vështirësi fillestare në bindjen e të intervistuarve për t’i dhënë detaje të rëndësishme

studiuesit. Shumica e intervistave u zhvilluan gjatë ditës kur shumica e studentëve ishin në auditore ose angazhime të tjera.

Një tjetër vështirësi ishte identifikimi i studentëve. Na u desh të përdornim mekanizma të identifikimit të tyre në rrugë jo zyrtare për shkak të mungesës së informacionit, si edhe të shfrytëzonim forumet online dhe kontaktet ndërmjet njohjeve dytësore. Sfidë më e madhe ishte gjetja e studentëve të kthyer pasi vetë universitetet nuk kishin bërë hulumtime të ngjashme. Ishte shumë e vështirë për të gjetur studentët e kthyer, shpesh herë na u desh të pyesnim njerëz apo studentë të tjerë që njihnin studentë që sapo kishin ardhur nga migrimi. Kur u krijua kontakti, të studentët e kthyer ishin skeptikë për të folur me studiuesin.

Oraret e intervistave ishin planifikuar duke respektuar përshtatshmërinë e të intervistuarit në kohë. Ndodhte që koha e intervistës duhej të ndryshonte dhe t'i riprogramohej disa herë për shkak të problemeve të tyre. Në të njëjtën kohë kampioni e zgjedhur për studim siç është shpjeguar në kapitullin metodologjik ishte shumë i shpërndarë. Kampioni shtrihej pothuajse në të gjithë vendin. Prandaj nga një studim i menduar në universitetet e Tiranës u shtri në rang kombëtar në të gjitha universitetet e vendit si në Korçë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Shkodër etj. E gjitha kjo bëri që periudha e intervistave të zgjaste më shumë se 6(gjashtë) muaj.

1.9 Përkufizimi i termave kyç të përdorura në studim

Ndër termat kyç që u përdorën lidhen me migracionin, emigracionin, ri-integrimin, Karta e Bolonjës etj. Përshtatja dhe përkufizimi i tyre do të bëhet nën kuadrin e terminologjisë institucionale sepse pjesa më e madhe e tyre janë përshtatje nga vendet e tjera kryesisht ato të BE dhe SHBA. Shpjegimi i përgjithshëm konceptual na jep një kornizë të punimit shkencor.

Emigracioni: Me emigrim do të kuptojmë zhvendosjet individuale ose kolektive të njerëzve nga një zonë tek një zonë tjetër ose nga një shtet në një tjetër. Lëvizje e cila bëhet zakonisht me vullnet të lirë por që shpesh herë mund të jetë edhe e detyruar për shkak të rrethanave politike, social-ekonomike të vendit të origjinës. Emigracioni mund të jetë kryesisht në dy forma: i vullnetshëm ose jo i vullnetshëm. Emigracioni përfshin kategori të ndryshme moshore dhe gjinore dhe sipas sociologëve ka tendencë të orientohet drejt vendeve më të zhvilluara ekonomikisht dhe drejt vendeve me klimë më të ngrohtë (Portera, 2010). Këto zhvendosje mund të quhen edhe lëvizje migruese.

Migracion i kthimit: është një nga format më të reja. Në terminologjinë e sotme shihet si një proces rikthimi në vendin e origjinës. Migrantët për arsye ekonomike-politike-sociale vendosin të bëjnë një migracion të kthimit drejt vendit të origjinës. Ky migracion mund të jetë i përhershëm ose i përkohshëm. Pjesa më e madhe, sidomos kthimet ekonomike, janë të përhershme (Cassarino, 2004).

Migrant i kthyer (me dëshirë): migrant i kthyer me dëshirë është ai migrant i cili pas një periudhe disa vjeçare ose mujore vendos të kthehet me vullnetin e tij pa qënë nën presionin e askujt (vëndit apo politikës). Migrant i kthyer me dëshirë sipas Casarionos është ai i cili nuk ka arritur të integrohet në vendin e emigracionit ose e kundërta. Si migrant ai ka krijuar resurset e duhura monetare dhe kualifikimet e nevojshme dhe është në gjendje të investojë në vendin e origjinës (Cassarino, 2004).

Migrantii kthyer (pa dëshirë): është ai migrant i cili nuk ka arritur të integrohet më së miri në vendin që ka emigruar por që për arsye politike, krizës ekonomike ose prishjes diplomatike midis vendit të origjinës dhe vendit pritës është i detyruar të kthehet.

Cassarino përmend edhe migrantin që nuk ka arritur të sigurojë një qëndrim legal të rregullt në vendin pritës (Cassarino, 2004).

Reakulturimi: i referohet përshtatjes në kulturën e vet të personit (ose kulturës së trashëgimisë) pasi ka jetuar në një kulturë tjetër për një periudhë të zgjatur kohore. Sidoqoftë, migrantët kanë zhvilluar identitete pjesërisht ose tërësisht të reja në periudhën e migrimite cila e përvetëson përvojën e tyre të reaktulturës, nga njëherë më e komplikuar sesa përvoja e tyre origjinale e akulturimit në vendin pritës (Kim, 2001; Sussman, 2010).

Ri-integrimi arsimor: është term i cili ka ardhur rishtaz si rezultat i hipotezave studimore. Ri-integrimi arsimor sipas Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë nuk është gjë tjetër veçse një ri-integrim ose një ri-njehësim i suplementit të kualifikimeve midis vendit ku ka qënë emigrant dhe atij të origjinës (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 2010).

Ri-integrimi kulturor: me një shpjegim të thjeshtë është një ripërshatje e vlerave, normave dhe rregullave sociale (King R. , 2000).

Ri-integrimi social: lidhet me krijimin dhe përfitimin e marrëdhënieve të ndërsjellta shoqërore midis dy ose më shumë individëve. Këtu luajnë rol agjentë të rëndësishëm si shkolla, media, zyrat e punës, por dhe iniciativat e migrantëve për të pranuar veten dhe tjetrin (Cassarino, 2004).

Karta e Bolonjës: e themeluar në vitin 1988 është një marrëveshje ndërkombëtare midis 45 vendeve europiane për ndërkombëtarizimin dhe unifikimin e diplomave si dhe në shkëmbimin e vlerave arsimore në vendet e Europës dhe më gjerë (Bologna Process, 2006).

KAPITULLI II

FENOMENI I MIGRACIONI DHE QASJET INTERPRETATIVE TË TIJ

2.1 Koncepti i migracioni të kthimit

Migracioni i kthimit është studiuar nga një sërë disiplinash të tilla si ekonomia, sociologjia, antropologjia, gjeografia dhe psikologjia. Migracioni në ditët e sotme është i ndërthurur me gjeopolitikën, tregëtinë, kulturën dhe ofron mundësi përfitimi për shtetet, komunitetet dhe bizneset. Migrimi ka ndihmuar në përmirësimin e jetës së njerëzve në të dy vendet, atij të origjinës dhe atij të destinacionit dhe ka ofruar mundësi për miliona njerëz në mbarë botën. Studiues të ndryshëm janë përpjekur të përcaktojnë qartë konceptin e migracionit. Për shkak të qasjeve të tyre të ndryshme sociale, ekonomike e politike shpesh-herë ka patur një paqartësi për definimin e konceptit të migracionit. Ndërkohë që gjeografët kanë theksuar problemin e lëvizshmërisë në kohë dhe hapësirë, sociologët kanë vënë theksin tek pasojat sociale të lëvizjes, ndërsa ekonomistët i kanë dhënë rëndësi aspektit ekonomik të migracionit.

Migrimi i kthimit përkufizohet si: *“lëvizja e migrantëve që kthehen në vendet e tyre”* (Mitchell, 1969). Ndërsa sipas Dustmann dhe Weiss migrimi i kthimit përshkruhet si një: *“situatë ku migrantët kthehen në vendin e tyre të origjinës, pas një periudhe të konsiderueshme kohore jashtë vendit”* (Dustmann & Weiss, 2007, p. 238).

Sipas shumë studiuesve, kuptimi më i thjeshtë i konceptit migrim mund të jetë *“një ndryshim i thjeshtë në hapësirën fizike”* (Dustmann & Weiss, 2007). Në ditët e sotme si fushëveprimi ashtu edhe përcaktimi i migracionit janë bërë më të komplikuar, pra vetëm

lëvizshmëria në gjendjen fizike nuk mund të përcaktojë konceptin e migrimit. Kuptimi në shqip i konceptit të “*Migrimit*” është “*zhvendosja e individit ose grupit të individëve nga një zonë kulturore në tjetrën, zhvendosje e cila mund të jetë e përhershme ose e përkohshme*” (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 2010).

Në fjalorin e Webster-it University termi është definuar: së pari “*si akt ose një shembull i lëvizjes nga një vend ose rajon, për t'u vendosur në një vend ose rajon tjetër*”, së dyti, ajo përcaktohet si “*një veprim i lëvizjes nga një zonë në tjetrën në kërkim të punës*”. (University, Webster, 2018)

Sipas Caplow “*Migrimi në mënyrë të përgjithshme, është një ndryshim i vendbanimit dhe kjo nuk e bën atë domosdoshmërisht një zaptues, ai është i lidhur ngushtë me ndryshimin e profesionit. Drejtimet kryesore të migrimit ilustrohen nga lëvizjet pak a shumë të vazhdueshme nga zonat rurale drejt qytetit, nga zonat e popullsisë së qëndrueshme drejt qendrave të mundësive industriale ose tregtare, nga vendet e populluara në vende më pak të dendura dhe nga qendrat e qyteteve në rrethinat e tyre*”. (Caplow, 2015)

Eisenstadt e shikon migrimin si “*kalimin fizik të një individi ose një grupi nga një shoqëri në tjetrën. Ky tranzicion zakonisht përfshin braktisjen e një mjedisi shoqëror dhe hyrjen në një tjetër mjedis shoqëror*” (Eisenstadt, 1967). Megjithatë ky përkufizim nuk arrin akoma të shpjegojë psikologjinë e individëve apo grupeve që janë duke u zhvendosur nga një vendndodhje gjeografike në tjetrën. Eisenstadt ka studiuar fushat e migracionit suedez dhe ka përcaktuar migrimin në drejtim të ndryshimit të qendrës së gravitetit dhe ai ka përcaktuar se lëvizshmëria e një individi varet nga ndryshimi me qendrën e gravitetit, për shembull, rrugëtimi për në punë, lëvizshmëri të mund të mbeten të njëjta, ndërkohë që do të ketë ndryshime në lëvizjen ndër-urbane. (Eisenstadt, 1967)

Një autor tjetër i cili dha një përkufizim të plotë të migrimit ishte Arnold Rose. Përkufizimi i tij përcakton marrëdhëniet ndërmjet migrimit dhe rritjes së popullsisë edhe pse indirekt. Sipas Rose *“migracioni nuk shton ose zbret nga popullata e përgjithshme e botës, por mund të ketë ndikuar mbi popullsinë e përgjithshme duke përfshirë lëvizjen e njerëzve nga zonat ku ka mundësi të riprodhohen më pak në zonat ku ka mundësi të riprodhohen më shumë ose anasjelltas”* (Rose, 1969). Në kontekstin indian, kjo qasje paraqet probleme të caktuara. Safa shprehu mendimin e saj se *“Migrimi normalisht konsiderohet si një fenomen ekonomik, edhe pse faktorët jo ekonomik duket se kanë një farë sjelljeje”*. (Heleni.Safa, 2002)

Pas vlerësimit të të gjitha përkufizimeve të studiuesve të ndryshëm, arrijmë të kuptojmë se shumica e tyre e vënë theksin tek koha dhe hapësira, por asnjëri prej tyre nuk ka hedhur këndvështrimin në pasojat socio-ekonomike. Pas shqyrtimit të konceptit socio-ekonomik, mbi pasojat e migracionit aspekti socio-ekonomik, na parashtrohet një përkufizim i ri të parë në tri dimensione të migrimit njerëzor, në dimensionin: a)kohë, b)hapësirë dhe c)implikimet socio-ekonomike. Prandaj migrimi mund të përkufizohet si lëvizje e përhershme ose gjysmë e përhershme nga një vend në tjetrin, gjë që çon në përhapjen e kulturës dhe integrimin social. Gjithashtu ai bashkërendon jo vetëm aspektin ekonomik por edhe aspekti kulturor.

2.2 Tipologjitë e migracionit

Migrimi ndërkombëtar sot ndryshon nga ai shekullit të kaluar. Migrimi më parë ishte kryesisht lëvizje në një drejtim, me rrjedha të mëdha të migrantëve që largoheshin nga Evropa dhe Azia për në Amerikën e Veriut. Supozohet në përgjithësi se ata që u larguan

nga Bota e Vjetër nuk u kthyen kurrë. Megjithatë, në fillim të vitit 1885, Ravenstein kishte vërejtur parimin e migracionit të kthimit. Sipas tij: “*Çdo migrim kryesor aktual prodhon një kundër vlerë kompensuese*”(Ravenstein, 1885).

Pikëpamja e migrimit si fenomen i një lëvizjeje me një drejtim që rrodhi nga përvoja transatlantike e shekullit të nëntëmbëdhjetë dominoi studimet e migracionit (Jackson, 1969). Migracioni i kthimit që sipas Cassarino do të njihet me terminologjinë *migrim hyrës* (Cassarino, 2004). Zhvillimet e mëvonshme të ri-integrimit treguan që migrantët u detyruan të kthehen për shkak të keqmenaxhimit të politikave migruese.

Në vitet e fundit hasim edhe disa tipologji të migracionit si ***ato të jashtme*** dhe ***ato të brendshme***, si efektet globale edhe ato ekonomike etj.

Në 15 vitet e fundit, antropologjia sociale dhe disiplinat e saj kanë filluar ta trajtojnë *migracionin si një sistem*, i cili duke shqyrtuar si duhet, gjithashtu duhet parë në dy kahe si:

a) rrymë

b) kundra-rrymë.

Sipas këtyre këndvështrimeve ky sistem në vetvete lidh shkëmbimin e eksperiencave midis dy grupeve sociale, migrantëve dhe popullsisë vendase. Shumë migrame në Evropë gjatë dekadave të fundit janë të këtij lloji. Ky klasifikim është akoma i paplotë, madje migrimet që ne i shohim në kohët tona kanë marrë forma të tjera të lëvizjes. Natyrisht që janë të mundshme kombinime të ndryshme mes llojeve të ndryshme. Për shembull, migrimet qarkulluese janë shpesh migrame kontraktuale.




Figura 2:1 Format e Migrimit(Dustmann & Weiss, 2007)

Një klasifikim i përafërt i formave të migrimit është dhënë në figurën më sipër. Në figurë, tregohen ndarjet sipas motiveve. Ato janë motive ekonomike për migracionin dhe motivet që lidhen me katastrofën natyrore ose persekutimin. Gjatë gjithë historisë njerëzore, këto janë dy arsye kryesore pse individët migrojnë. Vendet pranuese sot bëjnë një dallim midis migrameve që janë për shkak të këtyre dy motiveve. Këto vende kanë marrëveshje të ndryshme për refugjatët dhe migrantët ekonomik.

Migracionet që janë **për shkak të motiveve ekonomike** përsëri mund të marrin forma të ndryshme dhe në figurë dallohet niveli i ardhshëm ndërmjet migrameve të përkohshme dhe migrameve të përhershme. Ky kategorizim nxirret nga perspektiva e vendit pritës: “një migrant është një migrant i përkohshëm nëse ai / ajo qëndron në një vend të caktuar për një periudhë të kufizuar kohore. Në të njëjtën kohë, migrimi mund të jetë i përhershëm nga perspektiva e migrantëve: ai/ajo mund të largohet përgjithmonë nga vendi i tij, por mbetet përkohësisht në çdo vend pritës”.(Çağlar, 2006).

Në paraqitjen e figurës në shohim format e migrimit ky dy ndarjet më të mëdha janë migrimi për **shkaqe ekonomike, katastrofa natyrore dhe presekutimet** që mund t'u ndodhin individëve të ndryshëm.

Gati më shumë sesa gjysma e globit lëvizjen migratore e bën për shkaqe kryesisht ekonomike pra për një mirëqenie me të mirë. Ndësa një pjesë tjetër e atyre që migrojnë janë nisur nga rrethanat të tjera si ato politike, luftrat midis shteteve apo edhe shkaqe të si katastrofat natyrore si cunamet, tërmetet, vullkanet etj. Ndër motive të tjera sociologët e migracionit listojnë edhe arsye të tjera si azil kërkues të njohur ndryshe si migrantë politikë. Kujtojmë këtu se pjesa më e madhe që po vjen nga Siria apo Iraku është lëvizje migratore për shkak të luftrave dhe presuktimeve.

Ndarja e migrimit për shkaqe kryesisht ekonomike ka edhe nënklasifike të tjera siç e kemi përmendur më poshtë si një migrim i cili mund të jetë ***i përkohshëm*** por edhe një migrim ***i përhershëm***.

✓ *Migrimi i përkohshëm përsëri mund të nën-klasifikohet.*

Një lloj i rëndësishëm i ***migrimit të përkohshëm*** është ***migrimi qarkullues***. Me migrimin e qarkullues kuptojmë lëvizjen e shpeshtë të migrantit midis vendit të migrimit dhe atij të origjinës. Zakonisht këta janë migrantët sezonalë. Ata qëndrojnë vetëm për një periudhë të shkurtër në vendin pritës, për shembull, për sezonin e korrjes. Migracioni qarkullues shpesh nxitet nga një kërkesë e tepërt sezonale për punë në vendin e migracionit, që nuk mund të furnizohet nga fuqia punëtore vendase me çmime të përshtatshme. Në Europë, një shembull i migrameve qarkulluese janë punëtorët e korrjes nga Europa Lindore në Gjermani, ose nga Afrika Veriore në Italinë Jugore (Bell, 1997).

Një **migrim i përkohshëm** përshkruan një situatë ku migrantët lëvizin nëpër vende të ndryshme pritëse përpara se të arrijnë një destinacion përfundimtar. Migrimet e përkohshme ishin të shpeshta gjatë viteve 1960 dhe 1970, ku migrantët nga vendet e Europës Jugore u zhvendosën drejt vendeve të Europës Veriore. Kohët e fundit, një numër në rritje i migrantëve (shpesh ilegal) nga Afrika apo Azia hyjnë në Europë nëpërmjet Italisë, Spanjës ose Portugalisë dhe pastaj kalojnë në vendet veriore të Europës si Gjermania, Britania e Madhe apo Suedia (Bell, 1997).

Një migrim me marrëveshje është një migrim i përkohshëm ku migranti jeton në vendin pritës për një numër të kufizuar vitesh dhe ku kohëzgjatja e migrimit është përcaktuar për shembull, nga një leje qëndrimi ose një kontratë pune. Për shembull, migracionet e punës në Zvicër u projektuan kryesisht për të qënë migrim me marrëveshje midis shteteve ose midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Shumica e migracioneve në vendet prodhuese të naftës në Lindjen e Mesme nga Azia, Evropa dhe vendet e tjera të Lindjes së Mesme janë migrim me marrëveshje. (IOM, 2018).

✓ *Migracioni i kthimit*

Migrimi i kthimit është ai model i migrimit që zakonisht i referohet një migrimi si të përkohshëm. Migrimi i kthimit përshkruan një situatë ku migrantët kthehen në vendin e tyre të origjinës sipas zgjedhjes së tyre, shpesh pas një periudhe të konsiderueshme jashtë vendit. Disa studiues e përkufizojnë migrimin e kthimit duke u bazuar: *tek koha* dhe *hapësira* duke bërë dallimin mes *kthimit të përkohshëm* dhe *të përhershëm*. Këta autorë ndër të tjera shprehen se: “*kthimi përkufizohet me leksikun e agjensive qeveritare apo jo si akti i largimit nga territori i vendit të destinacionit*” (Agunias, 2006).

Shumica e tipologjive të migrimit të kthimit bën një dallim themelor midis atyre

migrantëve që synojnë që migrimi tyre të jetë *i përkohshëm* dhe atyre që synonin që migrimi të ishte *i përhershëm*. Karakteristikat kryesoretë migrimit të kthimit mund të klasifikohen sipas tipologjisë së mëposhtme:

1. Të kthyerit që synonin migrimin e përkohshëm, por koha e kthimit të tyre përcaktohet nga objektivat që ata synojnë të arrijnë në kohën e emigrimit.
2. Të kthyerit që synonin migrim të përhershëm, por u detyruan të ktheheshin për shkak të faktorëve të ndryshëm, ose malli për vendlindjen çoi në vendimin e tyre për t'u kthyer (Richmond, A. Bovenkerk, King, R.I., 1968).

Në studime të tjera të ngjashme janë bërë shpesh pyetje përse migrojnë njerëzit. Edhe përgjigjet kanë qënë të ndryshme. Sipas mjaft sociologëve migrantët lënë vendin e tyre për arsye ekonomike, politike, sociale, natyrore duke u nisur nga rrethana të ndryshme. Sipas tyre këto lëvizje janë herë *vullnetare* herë *të detyruara*.

Në të njëjtën kategori që i përket tipologjive të integritetit mund të përmendim dy nën ndarje, *kthimi vullnetar* ose *kthimi i detyruar*. Megjithatë për këtë mund të hasen dhe kategorizime të tjera në varësi të përcaktimit të termit nga vetë migrantët apo autorëve që e studiojnë fenomenin.

Së fundi, termi migrant i kthyer po përdoret gjithnjë e më shumë. Termi i referohet njerëzve që kanë jetuar shumë larg nga vendi i tyre i origjinës për shkak të disa arsyeve politike, sociale, ekonomike dhe kulturore por që tanimë kanë vendosur të kthehen në vendet e tyre (Yijälä, 2010; Tsuda, 2003).

IOM e bazon rikthimin e tyre si një *kthim vullnetar* dhe *jo vullnetar*. Për meshkujt, arsyeja kryesore për t'u kthyer në vendin e origjinës është puna, ndërsa për femrat, arsyet familjare janë paksa më të rëndësishme. Për shkak se të kthyerit janë kryesisht meshkuj, numri aktual

i meshkujve që kthehen për arsye familjare është më i lartë se numri i femrave që kthehen për arsye familjare (UNECE, 2014).

2.3 Faktorët e migrimit

Përkufizimi i sugjeruar nga Lee në veprën “*Teoria e Migrimit*” paraqet disa probleme nga të cilat ne dallojmë lloje të ndryshme të migrimit ciklik (Lee, 1966). Lee është pasuesi i Ravenstein dhe sipas tij në migrim më shumë kanë rëndësi *faktorët e brëndshëm* sesa ato të jashtëm. Po sipas tij ka shumë barriera të mëdha si ndarjet klasore, barrierat fizike dhe politike që pengojnë në integrimin e migrantëve. Lee theksoi ndër të tjera se procesi i intergrimit tek migrantët varet shumë edhe nga gjinia, klasa dhe mosha e tyre. Ky është një nga faktoret kryesore shtytës-tërheqës në integrimin e tyre. Po sipas tij integrimi varet edhe nga inisiativa personale. Njohja e kulturës dëshira personale për të përfaqësuar kulturën është e rëndësishme për t’u përshtatur me migracionin (Lee, 1966).

Por ka edhe nga ajo kategori njerëzish të cilët nuk e arrijnë dot përshtatjen kulturore për shkak të nostalgjisë apo lidhjes së fortë me vendin e origjinës. Për të përshkruar dëshirën për tu kthyer në shtëpi një ditë, sot përdoret termi nostalgji, që rrjedh nga greqishtja ‘*nostos*’ (*kthim*) dhe ‘*algos*’ (*dhimbje*) (Quayson, 2013, p. 13). Ky term u përdor për herë të parë nga një mjek, për të përshkruar mallin për atdheun të ushtarëve zviceranë që shërbenin jashtë vendit të tyre (Hofer, 1934, p. 45). Megjithatë për brezat në vazhdim kthimi në atdhe bazohet kryesisht tek vizitat vjetore të verës, duke prekur kështu idealizimin që kishin për vendin e origjinës (Cohen, 1997; Tsuda, 2003; Wessendorf, 2007).

Në rastin e migrantëve të kthyer, ideja e “*shtëpisë*” më së shumti bëhet një koncept i paqartë pasi migrantët mund të përjetojnë pasiguri përsa i përket e vendit të cilit ata i

përkasin (King R. , 2000). Për këtë arsye ata janë në kërkim të një vendi që u jep atyre një ndjenjë të fortë të përkatësisë dhe identifikimit. (Wessendorf, 2007).

Studimet mbi motivet për migracionin e kthimit treguan se kthimi është shkaktuar nga faktorë të shumtë. Në një studim të kryer nga Tsuda u shqyrtua se problemi: “*çfarë ka shkaktuar që miliona migrantë të diasporës të kthehen në Japoni?*”, atdheun e tyre etnik, pasi kanë jetuar larg vendit të tyre për dekada të tëra. Ai deklaroi se: “*edhe nëse motivet ekonomike janë motivi kryesor i kthimit, lidhjet etnike dhe arsyet emocionale luajnë një rol të rëndësishëm gjithashtu përsa i përket vendimit*”(Tsuda, 2003).

Nesë bëjmë një ndarje mbi faktorët që do ndikonin në kthim do të theksonim:

- ✓ **Faktori politik:** Shumë shtete ndërmarrin politika tërheqëse për rikthimin e migrantëve sidomos atyre të kualifikuar. Sipas analizave të bëra së fundmi nga *Washington State Department of Enterprise Service*, mbi faktorët politiko-socialë që do të ndihmonin në kthimin dhe integrimin e shpejtë të migrantëve të kthyer është sigurimi i kushteve më të mira të punës në vendin e origjinës. Duket theksuar se është më rëndësi se *faktorët politikë* mund të jenë faktorë *politik tërheqës*, këtu kemi parasysh faktorët që vendos vendin e origjinës për të rikthyer migrantët. Gjithashtu mund të jenë edhe faktor *politik shtytës* dhe këtu ne kemi parasysh politikat e vendeve ku ata kanë migruar që nuk janë mbështetëse por janë jo favorizuese, migrantët në këtë rast janë të detyruar të kthehen.
- ✓ **Faktorët ekonomik:** Kriza e vitit 2008 në Europë do të prodhonte migrantë ekonomik. Sipas të dhënave nga raportet e IOM dhe ato të Bankës Botërore, migrantët ekonomik sa po vijnë dhe po shtohen (IOM, 2010). Gjithashtu raportohet se numri i migrantëve të kthyer është shumë herë më i lartë sesa numri në 10 vitet e

kaluara. Sipas këtyre raporteve migrantët me të *humbur vendin e punës* janë të detyruar të rikthehen në vendin e origjinës pasi nuk arrijnë të përballojnë shpenzimet dhe jetesën. Arsyet kryesore të kthimit të migrantëve shqiptarë pas vitit 2008 ishin kryesisht për shkak të *humbjes së vendeve të punës* në Greqi dhe Itali. *Një motiv i dytë* ishin dhe arsyet familjare. Pika kulmore e kthimit arriti në 2012-2013 (53.4% të totalit të migrantëve të kthyer). Rreth 34% e të kthyerve ishin të punësuar dhe 20% e tyre ishin të vetëpunësuar në kohën e studimit, gjë që tregon se shkalla e papunësisë tek të kthyerit është e lartë dhe arrinte (46%).

Megjithëse, Departamenti i Kufirit dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme ka informacion mbi të kthyerit migrantë, të miturit e pashoqëruar, viktimat e trafikimit dhe konvertimin e pavullnetshëm, kryesisht përmes fluturimeve të organizuara nga autoritetet e vendeve pritëse, kjo përbën vetëm të dhëna të pjesshme kur krahasohet me fenomenin e përgjithshëm i të kthyerve për arsye ekonomike (IOM, 2016). Ashtu sikurse Brady vë në dukje se: “*BE ka një rol vërtet kompleks në vendimarrjen dhe menaxhimin e migracionit si edhe të migracionit hyrës. Ajo është përgjegjëse si për krijimin e kushteve lehtësuese në emigracion ashtu edhe në vendosjen e kufijve*”(Brady, 2008, pp. 9-12). I zhvilluar në këtë kontekst migracioni është parë edhe si një fushë e cila ka patur nevojë të rishikohet si një kontekst më vete në zhvillimin e integritit, dhe atë të ri-integritit. Duke dashur t’i japim edhe një shtrirje më të gjerë fenomenit të migracionit sociologët dhe demografët sjellin shifra dhe informacione të reja mbi numrin migrantëve të kthyer për shkaqe ekonomike. Sipas të dhënave të nxjerra nga ata përgjatë hulumtimeve rezulton se pjesa më e madhe kthehen për shkak të humbjes të vëndit të punës, dhe dhe jo për shkaqe të mungesës së integritit.

- ✓ **Faktorët etno-kulturore** të cilat mund të ndryshojnë sipas *grupit etnik*. Në disa studime të mëvonshme të kryera në gjeneratën e dytë të migrantëve grekë në Gjermani, u konstatua se ata ktheheshin në Greqi kryesisht për shkak të arsyeve jo-ekonomike por për arsye të tilla si stili i jetës, familja dhe jeta (King, R.; Christou, A.; Ahrens, J., 2011), ose lidhjet etnike të tyre, si dhe rrjetet e mëparshme shoqërore ose ato ekzistuese si dhe lidhjet e tyre të afërsisë kulturore dhe fetare (King & Christou, 2014).

Arsyet relativisht etnike si ‘*faktorë tërheqës*’ shpesh janë dokumentuar dhe theksuar në literaturë si motivet kryesore për kthim. Megjithatë, mënyra sesi ata përshtaten në vendin pritës nuk është ajo që ata prisnin. Siç theksohet edhe në qëndrimet negative të shprehura nga vetë migrantët ata shpesh etiketohen si “*migrantë*”, dhe ndaj tyre shfaqen shenja të ksenofobisë, diskriminimit të perceptuar, racizmit, etj (Bolognani, 2007; Kunuroglu, Yagmur, Van de Vijver, & Kroon, 2015).

Gjatë analizës së studimeve rreth faktorëve të kthimit, shohim se, veprimet e migrantëve shihen si një rezultat i drejtpërdrejtë i “*përkatësisë*” së tyre në një bashkësi kombëtare.

Vetë-identifikimi kombëtar i migrantëve si dhe perceptimi i “*atdheut*” merren në konsideratë dhe janë faktorë që ndikojnë në vendimin e kthimit (Cassarino, 2004). Ka shumë studime që tregojnë se nocionet e përkatësisë dhe atdheut kanë një ndikim të fuqishëm sidomos në zgjedhjet e brezave të dytë lidhur me vendimet rreth zgjedhjeve të vendbanimit të tyre (Christou & King, 2006; Reynolds, 2008; Wessendorf, 2007).

Kushtet negative në kontekstin e migracionit krijojnë probleme të integritetit si dhe dështim në kuptimin e përkatësisë në vendin e imigracionit. Temi i përdorur sipas këtyre teoricientëve “*Second generation*” i referohet një grupi heterogjen migrantësh. Shumë

autorë këtë koncept e kanë referuar për të na dhënë një ndarje edhe më të plotë në lidhje me gjeneratën e migrantëve të rinj. Sipas tyre është me rëndësi të madhe është diferencimi i kësaj kategorie pasi kjo do të ndihmonte të analizonim kushtet e integritit të tyre. Portesi e ndan në mënyre kategorike grupin e gjeneratës së migrantëve dhe ai thotë që ka dy lloj migrantësh:

a) të lindurit në emigracion dhe

b) të lindurit në vendin e tyre, sigurisht që ai e bën këtë kategorizim për efekt të diversitetit social që do të krijohet (Portes, 1999). Sipas King ka një ndryshim thelbësor midis migrantit që ka lindur në vend të huaj dhe migrantit i cila ka emigruar pasi ka studiuar shkollën fillore në vendin e lindjes (King R. , 2000).

Shumë autorë të tjerë mendojnë që ka një ndryshim esencial midis migrantëve të cilët kanë lindur në vendin ku kanë emigruar prindërit dhe midis atyre që kanë shkuar atje rreth moshës 6 vjeçare dhe 12 vjeçare (Ruben.G.Rumbaut, 1997).

Sipas Mary Waters sa më gjatë të kenë qëndruar fëmijët në vendin pritës aq më të vështirë e kanë ata që të indentifikohen me vendin e tyre (Mary.C.Waters, 2010). Sipas Herbert Gans i cili u bazua në zhvillime akoma edhe më të rëndësishme në lidhje me grupin e gjeneratës së dytë të migrantëve, këta migrantë shpesh herë kanë hasur një lloj diskriminim në vendin mikëpritës dhe si të tillë ata kanë parë si një mundësi punësimi në fushën e marketingut duke paraqitur punën e tyre si një lloj simbolike të identitetit të tyre etnik (Herbert.J.Gans, 1962).

Mary Waters thoshte ndër të tjera se: “*simbolika e identitetit të migrantëve shërben një lloj patente në suksesin e tyre si një opsion i ri në integritetin e tyre*”(Mary.C.Waters, 2010).

Sipas studimeve empirike të bëra në USA për gjeneratën e dytë të grupit të migrantëve të

lindur në vendin pritës kanë vërejtur ndër të tjera një zhvillim vërtet kualitativ në funksion të interesave të tyre. Migrantët e gjeneratës së dytë jo vetëm që e shohin mundësinë e rimigrimit të tyre si shumë të largët por ata e shohin si diçka thjesht nostalgjike. Në fakt sipas teoricienëve që janë marrë me fushën e integritit të migrantëve të gjeneratës së dytë si psh Crul i cili ndër të tjera thekson se: *“vetë kërkesa e tyre për marrjen e shtetësisë në vendin pritës tregon një dëshirë për t’u integruar dhe për t’u institucionalizuar më shpejt”* (Crul, 2007).

E parë në këtë këndvështrim migrantët e gjeneratës së dytë të lindur kryesisht në vendin pritës janë më të predispozuar të ndërtojnë diçka në vendin ka ata janë vendosur sesa të shohin kthimin si një alternativë. Sipas Joppke shtetësia është një garanci akoma më e madhe për qëndrimin e tyre definitiv në vendin pritës dhe një ndihmesë e migrantëve për t’u integruar akoma më shpejt në vendin pritës (Joppke, 1999).

Studimet mbi pasojat e migrimit të kthimit theksojnë gjithashtu se migrantët që jetojnë për vite me ëndrrën e kthimit dhe më në fund e kuptojnë se ëndrra ka tendencë të shëndërohet në një përvojë zhgënjimi. Është vërejtur gjithashtu se migrantët përjetojnë një ndjenjë të njëkohshme të këputjes dhe tjetërsimit kur kthehen në vendin e quajtur *‘shtëpi’* (Quayson, 2013). Schiller dhe Fouron (2001) e krahasuan gjeneratën e parë të perceptimit të njerëzve të Haitit në shtëpi pas kthimit në *‘rrobat e vjetra që nuk përshtaten më’*. Për gjeneratën e dytë dhe të tretë të migrantëve që nuk kanë patur përvojën në vendet e origjinës, (Christou & King, 2006) ata i kthejnë përvojat duke nxitur ndjenja të ngjashme të përjashtimit dhe mospranimit) që gjenerata e parë përjetoi në qytetet perëndimore.

Qëndrimet e anëtarëve të shumicës pas kthimit janë vërejtur si një faktor i rëndësishëm gjatë periudhës së ripërtëritjes që çon (ri) emigrantët të mund të *‘ndihen në shtëpi’* ose *‘të*

mos ndjejnë nostalgjinë për vendin e origjinës’ pas kthimit (Christou & King, 2006; pp. 12-24; Ní Laoire, 2008).

Në studimet mbi migrantët grekë të kthyer, shumica e të anketuarve raportuan se kishin probleme në lidhje me përkatësinë për shkak të qëndrimeve negative të bashkëmoshatarëve jo-migrues (Ní Laoire, 2008; Ralph, 2012). Në kontekstin e kthimit, mos përputhja mes vetë-identitetit të të kthyerve dhe identitetit që u atribuohet atyre krijon një ndërgjegje të dyfishtë, e cila ka ndikim të thellë mbi ta sidomos me surprizat tronditëse.

✓ **Faktori inovativ** përsa i përket migracionit të kthimit, duke qënë se ri-integrimi i suksesshëm ka dy dimensione të ndërlidhura ngushtë me njëra –tjetrën:

1) *dimensioni i parë* që lidhet me suksesin personal, duke sjellë siguri sociale dhe ekonomike për migrantin si individ (duke përfshirë anëtarët e familjes) në bashkësinë lokale të vendit të origjinës.

2) *dimensioni i dytë* ka të bëjë me kontributin e kthimit në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit në vendin e origjinës. Migrimi i kthimit mund të jetë një stimul i vërtetë për zhvillimin e komuniteteve lokale ku të kthyerit adaptohen.

Rintegrimi përfshin 3 stade:

a) *kulturor* (duke përfshirë mënyrën e jetesës, gjuhën, parimet morale dhe traditat e vendit të origjinës),

b) *ekonomik* (duke synuar përdorimin e njohurive të fituara në migracionin për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social të vendit të origjinës) dhe

c) *social* (duke përfshirë zhvillimin e një rrjeti personal dhe strukturave të shoqërisë civile), (IOM, 2018).

Ngritja e elitave të reja ekonomike dhe politike ka sjellë dhe ri-shpërndarjen e burimeve

duke favorizuar edhe rritjen e polarizimit. Duke përfshirë këtu dhe eksperiencën e tyre në emigracion ku polarizimi nuk ishte kaq i dukshëm këta migrantë u përballën me vështirësi për t'u integruar. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të pranojmë ekzistencën e tre aspekteve bazësocio-ekonomike-politike.

2.4 Qasjet interpretative sipas migracionit të kthimit

Migracioni i kthimit është ende një fushë që ka një interes studimi. Përpyqjet më të mëdha për të teorizuar migracionin e kthimit dhe aplikimin e tyre në studime janë bërë nga Cassarino si dhe nga pasues të tjerë si Anastasia Christou dhe King. (Christou & King, 2006).

Qasjet studimore të bërë ndër vite sidomos nga vitet 1960-1980 kanë sjellë shumë debate mbi migracionit të kthimit dhe zhvillimit ekonomik, midis ri-atdhesimit dhe integritit. Cassarino i sjell një këndvështrim shumë sistematik dhe rigoroz në lidhje me tipologjitë dhe kornizat e migracionit të kthimit. Ai dallon katër qasjeve të ndryshme teorike në studimin e migracionit të kthimit:

- Qasje ekonomike
- Qasja strukturore mbi migracioni e kthimi
- Qasjet Sociologjike: *Transnacionalizmi*
- Qasjet e mbështetjes Soci –psikologjike, Ri-akulturizmi: (Cassarino, 2004)

2.4.1 Qasja ekonomike

Sipas Cassarinos ekonomia neoklasike e percepton migrimin tradicional si një i përpjekje e migrantëve për të rritur të ardhurat e tyre dhe familjarëve në vendin dërgues. Sipas tyre kjo qasje ekonomike kërkon të shpjegojë diferencat e pagave ndërmjet *vendeve dërguese* dhe

pranuese (Cassarino, 2004). Duke u nisur nga kjo perspektivë, në këtë kontekst, kthimi perceptohet si një dështim i përvojës së migrantit në migracion, qoftë nëpërmjet llogaritjes së gabimeve të kostove ose duke dështuar në mbajtjen e përfitimeve të migrimit. Përveç kësaj, migrantët shihen si individët që dëshirojnë të maksimizojnë të ardhurat e tyre, si gjatë migrimit ashtu edhe gjatë kthimit në vendin e origjinës së tyre (Todaro, 1969).

Në kundërshtim me Ekonominë Neoklasike që përcakton migrantët e kthimit si individë që dëshirojnë të maksimizojnë të ardhurat e pritshme, Ekonomia e Re e Migracionit të Punës e percepton kthimin si një rezultat të mirë menduar, të një strategjie të llogaritur për familjen si dhe pasojë e arritjes së suksesshme të migrimit të synuar (Cassarino, 2004)&(Stark, 1991).

Për këtë arsye, Ekonomia e Re e Migracionit të Punës shtrin kontekstin e analizës ekonomike, duke përfshirë individin brenda njësisë së tij/saj familjare dhe përzier maksimizimin e të ardhurave me përballjen e rrezikut (King, R.; Christou, A., 2008). Për më tepër, ndryshe nga Ekonomia Neoklasike që supozon se migrimi është i përhershëm në natyrë në mënyrë që të maksimizohet fitimi, Ekonomia e Re e Migracionit të Punës supozon që njerëzit lëvizin përkohësisht në përpjekje për të maksimizuar të ardhurat (Constant & Massey, 2002).

Po ashtu edhe sipas interpretimit të NELM rikthimi i migrantëve shpeshherë mund të jetë edhe një strategji nga ana e tyre. Ata mund të kenë bërë një llogari paraprake për t'u rikthyer. Ata kanë vlerësuar ekonominë dhe të ardhurat e fituara në periudhën e migracionit dhe janë rikthyer më shpresën e investimit. Sipas NELM kjo mund të jetë një iniciativë e marrë në mënyrë individuale por gjithashtu edhe një iniciativë e marrë bashkarisht me familjen (Constant & Massey, 2002). Gjithashtu duke vërejtur edhe studimet e tjera sipas

noeklasikëve migrantët nuk ktheheshin vetëm për arsye personale por edhe për arsye të mbajtjes së familjes. Nga vëzhgimet e bëra rezulton se migrantët që kishin bashkëshortët në vendin e origjinës ishin më të prirur të dërgonin të ardhurat në vendin e origjinës. Remitancat (burimet e ekonomisë hyrëse) luajnë një rol të rëndësishëm në migrim. Ato përbëjnë mjaft interes gjithashtu edhe mbi migracionin ndërkombëtar të punës nga Turqia në vitet 1970 dhe në fillim të viteve 1980 (Gitmez, 1984). Remitancat u perceptuan si tregues të lidhjes së migrantëve me atdheun dhe dështimin për t'u shkëputur dhe për t'u integruar në vendbanimin e tyre (Çağlar, 2006). Për këtë, kur ndryshimet e konsumit dhe kursimeve të migrantëve turq ndryshuan, ato u perceptuan si një shenjë e ndërprerjeve të lidhjeve me vendlindjen dhe dëshirën për t'u integruar në vëndin ka ata janë vendosur. Megjithëse edhe pse të dy perspektivat ekonomike ofruan një informacion të vlefshëm për arsyet pse njerëzit migrojnë dhe kthehen në vendlindje, kjo nuk do të thotë se nuk ka mangësi.

- Së pari këto korniza përqendrohen vetëm në faktorët financiar dhe ekonomik të migracionit të kthimit, duke mos prekur kështu ndikimin e faktorëve social, politik, institucional dhe psikologjik.
- Së dyti këto modele nuk japin pothuajse asnjë informacion në lidhje me proceset e vendimmarrjes që çojnë në ri-migrimin dhe bashkëveprimin ndërmjet migrantëve dhe mjediseve socio-politike, si në kontekstin e dërgimit ashtu edhe të pranimit.

Mangësia përfundimtare ka të bëjë me faktin se brezat e dytë dhe të mëvonshëm vështirë se përfaqësohen në modele; ato shihet të kenë tendencë përfshirjeje thjesht në familje ose në njësinë familjare, e cila ka rëndësi vetëm brenda qëllimit të migrimit të gjeneratës së parë.

Në tërësi, paradigma e suksesit/dështimit është shumë e thjeshtë për të shpjeguar një fenomen kaq të ndërlikuar si migrimi i kthimit.




Figura 2-2: Ri-integrimi i suksesshëm sipas Cassarion-s

2.4.2 Qasja Strukturore mbi migracionin e kthimit

Sipas kësaj qasje fenomeni i migracionit nuk studion vetëm analizën empirike të migracionit por edhe ndikim social. Kjo qasje nuk merr në konsideratë vetëm eksperiencën individuale të migrantëve por gjithë lëvizjen shoqërore.

Qasja strukturore i kushton rëndësikthimit të gjeneratës së parë të migrantëve, thekson rëndësinë e burimeve financiare dhe ekonomike të sjella në vendin e origjinës pas vendimit të kthimit të migrantëve. Megjithatë, qasja strukturore nuk e percepton kthimin si përvoja e thjeshtë individuale e migrantit, por argumenton se migrimi i kthimit duhet gjithashtu të analizohet duke iu referuar kontekstit social dhe institucional në vendin e origjinës (Cassarino, 2004).

Brenda kësaj qasjeje, Cerase na paraqet një nga tipologjitë më të përmendura të migrimit të kthimit. Ai bën një kalsifikim në katër llojeve të shkaqeve të kthimit të migrantëve të gjeneratës së parë, përkatësisht kthimit për shkak të dështimit, konservatorizmit, daljes në pension dhe inovacionit.(Cerase, 1974).

➤ ***Kthimi për shkak të dështimit***

Ky fenomen ndodh kur migrantët nuk mund të përshtaten në vendet e destinacionit për shkak të faktorëve social-politik. Vështirësitë në integrimin në kontekstin e migracionit (p.sh, diskriminimi, çështjet gjuhësore) i detyrojnë ata të kthehen. Të kthyerit paramendojnë të kenë pak ndikim zhvillimor në vendet e origjinës. Këta migrantë të kthyer “të dështuar” gjithashtu lehtë mund të rikthehen përsëri në atdhe pasi u kthyen para se të përshtateshin në kontekstin e ri, edhe pse kthimi shpesh vjen me humbje të konsiderueshme për shkak të dështimit.

➤ ***Kthimi për shkak të konservatorizmit***

Kjo lloj levizje i përket migrantëve të cilët e kanë kthimin qëllimin e tyre fillestar, pasi duke kursyer disa para gjatë periudhës së migrimit ata mendojnë të investojnë në vendin e origjinës. Ata tentojnë të qëndrojnë më gjatë në kontekstin e migrimit sesa grupi i mëparshëm, të transferojnë remitancat dhe të realizojnë planet e tyre financiare, si blerja e pronave në vendin e origjinës. Ata i përmbahen vlerave të shoqërisë në vendlindje, për këtë arsye ata në vend që të ndryshojnë strukturën sociale, përforcojnë atë të vendlindjes së tyre.

➤ ***Kthimi i daljes në pension***

Ky lloj migrimi siç pasqyrohet në emër, i referohet të kthyerve që synojnë të kalojnë periudhën e fundit të jetës në vendet e origjinës fill pas daljes së tyre në pension.

➤ ***Kthimi i inovacionit***

Kthimi i inovacionit ndodh kur migrantët janë mjaft të integruar jashtë vendit, duke fituar aftësi të reja dhe duke u përfshirë më shumë në shoqërinë e vendit pritës. Të kthyerit përbëjnë një grup dinamik që perceptohet si *“agjentët e ndryshimit”* dhe synojnë të kthehen dhe të ndryshojnë atdheun, duke sjellë ide dhe vlera të reja, si dhe duke përdorur njohuritë dhe aftësitë e fituara në vendin pritës.

Tipologjia e Cerase përbën një bazë për qasjet e mëvonshme. Gmelch riformuloi tipologjinë e Cerase, duke analizuar qëllimet e migrantëve të kthimit, motivet dhe modelet e përshtatjes. Sipas Gmelch: *“kthimi udhëhiqet nga faktorë rrethanorë dhe strukturor. Këta faktorë janë mundësit që migrantët presin të gjejnë në vendet e origjinës, si dhe mundësitë e ofruara në vendet pritëse përkatëse”* (Gmelch, 1980). Gmelchi gjen migrantët të papërgatitur për kthim sepse faktorët në vendin origjinës mund të vlerësohen vetëm pas kthimit. Për këtë, ai analizon suksesin apo dështimin e migrimit duke ndërlidhur realitetin e ekonomisë dhe shoqërisë me kapacitetet e vendit të origjinës. Nëse konteksti social, ekonomik ose politik nuk është në përputhje me pritjet e të kthyerve, ri-integrimi bëhet i vështirë.

Sipas qasjes strukturore kthimi kishte mjaft ndikim, duke treguar se kthimi nuk mund të ndodhte më gjatë, dhe ai të shihet si një fenomen i shkëputur nga faktorët kontekstuale si në vendet dërguese ashtu edhe në ato pritëse. Megjithatë, duke u fokusuar kryesisht në ndikimin e migrimit të kthimit në vendet e origjinës, qasja strukturore lë shumë pyetje pa përgjigje në lidhje me dinamikën e brendshme të migrimit të kthimit. Qasja strukturore nuk jep informacion të hollësishëm rreth mënyrës se si migrantët ndërveprojnë me mjediset dhe në kontekstin e vendit pritës dhe në vendin e tyre, dhe proceset psiko-sociale që ato kalojnë.

Në këtë kuadër ne nuk i kushtojmë pothuajse asnjë vëmendje gjeneratave të mëvonshme, ato që njihen si gjeneratat e brezit të dytë.

Së fundi, qasja dhe tipologjitë përqendrohen kryesisht tek migrantët tradicionalë që lëvizin nga zonat rurale në vendet moderne, prandaj përvojat e migrantëve me kualifikim të lartë duket se mungojnë në korniza.

2.4.3 Qasja Sociologjike: Transnacionalizmi

Që nga fillimi i viteve 1990, transnacionalizmi ka pasur një ndikim të madh në konceptualizimin dhe kuptimin e migracionit të kthimit. *Transnacionalizmi* është një term i konceptuar nga një grup shkencëtarësh social në fillim të viteve 1990. Modeli i përbashkët i përvojave të migrantëve në SHBA, përfshirë ato të Karaibeve Lindore, Haitit dhe Filipineve, të cilët mbajnë marrëdhëniet shoqërore të shumëllojshme me atë çfarë i lidh ata me vendin e origjinës (Kearney, 1995; Schiller N. G.-S., 1992). Prandaj migrantët po sipas kësaj rryme u quajtën transportues pasi zhvilluan dhe mbanin lidhje të shumta, të tilla si familjare, institucionale, fetare, ekonomike dhe politike, si me vendin e origjinës ashtu edhe me vend banimin e tyre (Schiller N. G.-S., 1992). Qasja transnacionale siguron një kornizë konceptuale që nuk e percepton domosdoshmërisht migracionin e kthimit në një pikë përfundimtare, por përshkruan se si migrantët zhvillojnë identitete të shumëllojshme jo vetëm nëpërmjet lidhjeve shoqërore dhe ekonomike të qëndrueshme në vendet e origjinës dhe të vendeve pritëse, por edhe përmes mënyrave të ndryshme që migrantët i bashkëngjiten njëri-tjetrit nga origjina e tyre etnike, fqinjësia dhe solidariteti në grup (Schiller N. G.-S., 1992). Ritmi i rritjes së zhillimit të studimeve empirike brenda qasjes transnacionaliste kontribuon në kuptimin e koncepteve dhe proceseve përkatëse

specifike për migrimin e kthimit. Megjithatë, duhet të pranohen edhe kufizimet e tij. Para së gjithash, është gjetur një fushë mjaft e fragmentuar që ka nevojë për një kornizë më të definuar, si dhe mprehtësi analitike (Portes, 1999). Për më tepër, Somervill e deklaronte se: *“hulumtimi duhet të fokusohet më shumë në proceset e formimit të identitetit dhe jo në rezultatet e identitetit”*. Ai shton se: *“shënuesit e identitetit statik kapin lidhjet emocionale në formulim dhe shprehje”* (Somerville, 2008). Së fundi, literatura tregon shumë pak për kthimin e gjeneratave të mëvonshme (King, R.; Christou, A., 2008).

Në shumicën e flukseve të zakonshme të migracionit për motive punësimi, shumica janë migrantët e gjeneratës së parë që mund të mbështesin rrjetin e tyre të mëparshëm shoqëror dhe kontaktet institucionale para-ekzistuese në vendet e tyre etnike. Megjithatë, hulumtimet e mëparshme mbi ndryshimet midis brezave zbuluan se migrantët e gjeneratës së dytë shpesh ruajnë disa njohuri të gjuhës amtare të prindërve të tyre dhe, kështu lidhjet me atdheun vazhdojnë, megjithatë akoma mbetet e paqartë se sa dimensionale ëshë kjo (Levitt, 2004; Somerville, 2008). Sidomos me zhvillimet e kohëve të fundit në mjetet moderne të telekomunikacionit dhe mediave, transportimi, thirrjet e lira telefonike ndërkombëtare, fluturimet ndërkombëtare dhe interneti, lidhjet dhe marrëdhëniet janë lehtësuar për gjeneratat e mëvonshme që kalojnë nëpër vendet dërguese dhe pranuese.

Termi *transnacionalizëm* këtu nënkupton migracionin ku migrantët kanë lidhje me komunitetet në vendet e tyre të origjinës. Megjithatë, transnacionalizmi përdoret në një kuptim më të gjerë për t'iu referuar lidhjeve dhe ndërveprimeve të shumta që lidhin njerëz ose institucione në të gjithë kufijtë e shtet-kombeve, të lidhura me globalizimin dhe jo domosdoshmërisht të lidhur me migracionin (Vertovec, 1999).

Gjithashtu, transnacionalizmi i përdorur si term në këtë studim është i ndryshëm nga integrimi, siç përcaktohet në një kuadër bi-dimensional sipas (Berry, 1997). Integrimi përfshin si ruajtjen e kulturës së trashëgimisë, ashtu edhe ndërveprimin me pjesëmarrjen në kulturën ose kulturat e shoqërisë së zgjidhjes. Krahësuar me transnacionalizmin, integrimi është më pak i fokusuar në përfshirjen aktuale me vendin e origjinës.

2.4.4 Qasja socio-psikologjike: procesi i ri-akulturimit

Brenda teorive të ri-migrimit dhe perspektivave psikologjike, tranzicioni kulturor perceptohet si një fenomen i shumëfishtë që përfshin aspekte të emocioneve, sjelljes dhe njohjes (Ward, Bochner, & Furnham, 2001). Perspektivat socio-psikologjike përqendrohen më shumë në efektet politike, sociale dhe ekonomike të të kthyerve nga migrimi. Vëzhgimet psikologjike përqendrohen më shumë në ndryshimet individuale të qëndrimeve, besimeve dhe sjelljeve (Sussman, 2010).

Studimet e *akulturimit* dhe *rekrutimit* kryesisht përpiqen të shpjegojnë aspektet psikologjike të tranzicionit kulturor dhe të perceptojnë stresin dhe përballjen me aspekte të qenësishme dhe të pashmangshme të përvojave të tranzicionit të migrantëve. Njerëzit të cilët largohen nga vendi i tyre i origjinës për ndonjë arsye, si përmirësimi i standardit të tyre të jetesës, ose për të tjera arsye, kalojnë nëpër një proces akulturimi në kontekstin e migracionit, i cili mund të përkufizohet si “*proces i ndryshimit të kulturës që ndodh kur individët me prejardhje të ndryshme kulturore bien në kontakt të parë të vazhdueshëm me njëri-tjetrin*” (Redfield, Linton, & Herskovits, 1936, p. 146). Edhe pse ndryshimi është përjetuar nga të dy grupet, grupi minoritar është më i prekur. Kur migrantët vendosin të kthehen për çfarëdo arsye, fillon një *proces i riakulturës* (Donà & Ackermann, 2006).

Reakulturimi i referohet përshtatjes në kulturën e vet të personit (ose kulturës së trashëgimisë) pasi ka jetuar në një kulturë tjetër për një periudhë të zgjatur kohore. Sidoqoftë, migrantët kanë zhvilluar identitete pjesërisht ose tërësisht të reja në periudhën e migrimit e cila e përvetëson përvojën e tyre të riakulturës ndryshe dhe nganjëherë më e komplikuar sesa përvoja e tyre origjinale e akulturimit në vendin pritës (Kim, 2001; Sussman, 2010). Për këtë, studiuesit theksuan rëndësinë e studimit të përvojave të akulturimit të migrantëve për të kuptuar proceset e riakulturimit (Kim, 2001; Sussman, 2010).

Hulumtimi fillestar në literaturën e *akulturimit* dhe *riakulturimit* kryesisht u përqendrua në bashkëpunim dhe përshtatje kulturore, ndërsa literatura e kohëve të fundit e zhvendosi vëmendjen ndaj identitetit kulturor. Disa nga modelet që kanë të bëjnë me aspektet kohore të akulturimit të tilla si tronditja e kulturës është teoria W-curve e Gullahorn (Gullahorn, 1963), e cila shpjegohet si më poshtë:

- ✓ **Teoria e W-curve e Gullahorne** cila gjithashtu quhet modeli i kundërt i kulturës, ishte një nga kornizat më me influencë teorike që u studiua gjerësisht në kohët e hershme (Gullahorn, 1963). Kurba W ishte një shtrirje teorike e teorisë së U-Curve nga Lysgaard, e cila përshkruan përvojat e njerëzve që filluan të jetojnë në një mjedis të ri si ‘tronditje kulturore’ (Lysgaard, 1955).

Autorët pohuan se proceset e rregullimit përsëriten kur të huajt kthehen në shtëpi dhe mirëqenia e të kthyerve është prirur të ndryshojë me kalimin e kohës. Sipas teorisë, i kthyeri ndjen lehtësim dhe ngushëllim fill pas kthimit, i cili pasohet nga një goditje kulturore që rezulton nga mos gjetja e përvojës siç pritej. Më pas, fillon procesi gradual i riatdhesimit.

Teoria W-curve u vu në pikëpyetje shumë herë dhe nuk dha rezultate përse i përket procesit të kthimit (Adler, 1981, Sussman, 2001). Të metat e modelit janë të dokumentuara në një studim në të cilin ata pohojnë se modeli *W-curve* duhet të vazhdojë (Onwumechili, Nwosu, Jackson, & James-Hughes, 2003).

W-curve nuk mund të diferencojë proceset e akulturimit dhe riakulturimit. Për më tepër, studimet empirike të proceseve të akulturimit dhe riaktivizimit nuk kanë treguar kurrë luhatjet siç janë përshkruar në teori. Teoria u gjet jo përfundimtare, domethënë, as përshkruese e as përcaktuese. Më tej, në literaturë, modeli merr një nivel të lartë të ngjashmërisë së modelit të akulturimit për migrantët, gjë që nuk është në përputhje me shkallën e lartë të variacionit të vëzhguar (Ward, Bochner, & Furnham, 2001). Një model kyç që shpjegon procesin e imigracionit dhe akulturimit është korniza e Berry-it (Berry, 1997) e akulturimit e cila shpjegohet si më poshtë:

- ✓ **Modeli i Berry-it** i akulturimit është një model i cili përshkruan procesin e imigracionit, duke sugjeruar që migrantët përballen me dy çështje pas migrimit: ruajtjen e kulturës së atdheut dhe kontaktin me atdhetarët e tyre si dhe përfshirjen me shoqërinë e vendit emigrues (Berry, 1997). Ekzistojnë gjithashtu pikëpamje të ndryshme mbi konceptimin e dimensionit të dytë. Ndërsa disa studiues e përkufizojnë atë si adoptimin e kulturës ose identifikimit me shoqërinë kryesore p.sh., (Arends-Tóth & Van de Vijver, 2006), Berry përdor konceptin '*kontakt me grupet e tjera*' dhe jo fjalën '*miratimin e zakonshëm*'.

Sipas modelit të Berry-t, ruajtja kulturore nga njëra anë dhe kontakti me grupet e tjera në anën tjetër përbën katër strategji të akulturimit: integrimi, asimilimi, ndarja dhe margjinalizmi.

- Në strategjinë e integritit, migranti ruan disa karakteristika të kulturës së atdheut dhe gjithashtu merr pjesë në kulturën e re.
- Në asimilim, migranti përfshihet më shumë në rrethin shoqëror dhe nuk dëshiron më ruajtjen e kulturës së trashëgimisë, gjë që çon në humbjen e kulturës së origjinës.
- Në ndarje, migrantët e refuzojnë kulturën e re duke ruajtur karakteristikat e kulturës së trashëgimisë.
- Së fundi, marginalizimi pasqyron refuzimin e plotë të dy kulturave. Sipas modelit, vërehet niveli më i lartë i stresit akulturativ ku ekziston një rrjet i kufizuar mbështetës (p.sh.margjinalizimi) dhe niveli më i ulët i stresit është përjetuar kur migranti arrin të kombinojë aspektet kyçe të të dy kulturave (p.sh. integrimi).

Modeli i Berry-t i cili kryesisht thekson rëndësinë e orientimeve të akulturimit, u përdor gjerësisht për të përshkruar proceset pas migracionit që kalojnë migrantët. Megjithatë, duke qënë se modeli u ndërtua për t'iu përgjigjur pyetjes se: *“Çfarë ndodh me njerëzit në ‘një’ kulturë dhe përshtatjes me kulturën e ‘re’?”*, nuk qe e përshtatshme për të parashikuar përvojat e migrantëve të kthyer. Modeli i tij bazohet ekskluzivisht në përvojat që migrantët kanë në një grup të ri etnik, gjuhësor dhe fetar, ku orientimi i personave drejt identifikimit të kulturës së atdheut dhe asaj pritëse parashikon përshtatjen socio-kulturore ose *‘përshtatjen’* në kulturën pritëse. Rrjedhimisht, modeli është i pamjaftueshëm për të sqaruar përvojat e migracionit të kthimit të migrantëve që kanë zhvilluar identitete të reja në kontekstin e imigracionit, dhe gjeneratat e mëvonshme që tentojnë të kenë identitete edhe më të komplikua dhe të shumëllojshme. Ndërsa orientimet e kthimit të të kthyerve

ndryshojnë shumë nga ato që emigrantët kanë në kontekstin e migracionit, modeli siguron më pak njohuri në variacionet në rezultatet e riakulturës.

Sipas studimeve gjetjet e përvojës së migrimit ishin shumë të ndryshme nga përvoja e migrimit fillestar (Sussman, 2000) zhvilloi modelin e identitetit të saj kulturor, duke u fokusuar në ri-emigrimin, i cili shpjegohet si më poshtë:




Figura 2-3: Burimi i marrë nga John.W Berry (Berry, 1997)

Sussman bazoi modelin e saj kulturor mbi argumentin se: *“ndjeshmëria e identitetit kulturor të imigrantëve, si dhe fleksibiliteti i tyre kulturor parashikon përshtatjen e tyre socio-kulturore në vendin pritës”* (Sussman, 2000). Më pas, emigrantët që janë përshtatur me kulturën e re, duke përdorur vlerat, modelet e mendimit dhe sjelljet e kulturës pritëse deri në një farë mase, kanë pësuar ndryshime në identitetin e tyre kulturor, gjë që u bë e qartë vetëm pas migrimit të kthimit. Kjo tregon se, rregullimi në vendin pritës parashikon rikthimin përsëri në atdhe. Sussman testoi teorinë e saj mbi të kthyerit e korporatave amerikane (Sussman, 2001) dhe mësuesit amerikanë që ktheheshin nga Japonia (Sussman, 2002) dhe konfirmoi se migrantët më pak të identifikuar në Shtetet e Bashkuara, përjetuan

stres më të madh sa herë që ndryshonin identitetin e tyre. Sussman përcakton katër strategji të ndryshme të migracionit të kthimit, si

- 1) *subtraktive*,
- 2) *shtuese*,
- 3) *afirmative*
- 4) *ndërkulturore*;

Secili është i lidhur me ndryshime të ndryshme të identitetit dhe niveleve të stresit gjatë përvojës së ri-migrimit. Ndërrimet e identitetit që ndodhin si rezultat i adaptimeve të sjelljes dhe shoqërisë në vendin pritës spikaten dhe gjatë kthimit në atdhe.

- a) Përvojat e ndërhyrjeve *subtraktive* dhe *shtuese* janë shkaktuar nga identitetet kulturore të paramigrimit që janë bërë të dukshme vetëm pas migrimit. Sussman deklaron se këto shkëmbime janë duke u shkaktuar nga njohja e mospërputhjeve mes atdheut dhe kulturave pritëse. Të dy ndryshimet e identitetit karakterizohen nga nivele relativisht të larta të stresit pas kthimit; megjithatë, ndërkohë që ndryshuesit e ndjeshëm të identitetit tentojnë të kërkojnë mundësi për të bashkëvepruar me migrantët e tjerë të kthimit pas riatdhesimit, kërkojnë mundësi për të bashkëvepruar me anëtarët e kulturës së mëparshme pritëse pas kthimit.
- b) Për ndryshuesit *afirmativë* të identitetit, identiteti i kulturës në atdhe mbahet dhe forcohet gjatë përvojës së migrimit pasi mospërputhjet në mes të kulturës në atdhe dhe në atë pritëse janë injoruar në masë të madhe dhe për këtë arsye më pak stres është përjetuar pas rikthimit pasi identiteti kulturor në atdhe është më pak problematik.
- c) Së fundi, ndryshuesit e identitetit *ndërkulturore* mbajnë dhe menaxhojnë shumë

identitete kulturore në të njëjtën kohë dhe për këtë përjetojnë një proces shumë të qetë kthimi. Ata kërkojnë ndërveprime dhe zhvillojnë miqësi me anëtarët që përfaqësojnë kultura të ndryshme dhe mund të marrin pjesë në një gamë të gjerë të argëtimeve ndërkombëtare pas kthimit.

Tannenbaun analizoi përvojat e migracionit të kthimit të migrantëve izraelit duke përdorur modelin e akulturimit të Berry-t dhe modelin e identitetit kulturor Sussman. Ai pohonte se përvojat e rikthimit të grupit studimor ishin mjaft të ngjashme me tiparet emigracionit, dhe ai gjeti modelin e Berry-t më të rëndësishëm sesa të Sussman (Tannenbaum, 2007). Rrëfimet e migrantëve izraelitë të kthyer treguan dëshmi të identitetit kulturor edhe para tranzicionit edhe pse Sussman theksoi shfaqjen emergjente të identiteteve kulturore mbi tranzicionet fillestare.

Brenda hulumtimit të akulturimit, ka shumë studime që shqyrtojnë disa qasje të ndryshme (Cox, 2004; Gullahorn, 1963), distanca kulturore në mes atdheut dhe vendit migrues (Adler, 1981; Şahin, 1990), ndikimi i disa variablave në përvojën e rikthimit, kontakt me individët e vendit pritës (Kim, 2001), diferencat midis kulturave, përqafimi i kulturës vëndase. (Uehara, A. & Sussman, M. Nan, 1986)

Megjithatë, për shkak të natyrës së përkohshme të qëndrimit të tyre, përvojat e tyre mund të mos jenë të krahasueshme me përvojat e kthimit të migrantëve tradicionalë. Në ngjashmëri me studimet brenda fushës së transnacionalizmit, studimet e riakulturës tregojnë për stresin dhe emocionet negative të përjetuara nga të kthyerit në periudhën pas kthimit (Tannenbaum, 2007). Neto thotë se: “*ndryshimet e kushteve në vendin e origjinës krijojnë një mospërputhje midis kujtimeve të idealizuara të migruesve dhe realitetit që i pret ata në atdhe. Për më tepër, një arsye tjetër e dukshme e vështirësive pas kthimit janë qëndrimet e*

anëtarëve të grupit të shumicës ndaj të shpërngulurëve në atdheun etnik''(Neto, 2012).

Neto hetoi shkallën e adaptimit psikologjik dhe sociokulturor midis adoleshentëve që u kthyen në Portugali dhe sugjeroi se: *“diskriminimi i përjetuar nga adoleshentët portugezë pas kthimit luajti një rol thelbësor në rezultatet e tyre të riakulturimit*”(Neto, 2012).

Sussman thekson në punën e saj për migracionin e kthimit në Hong Kong se: *“në shumicën e rasteve ata që kthehen janë më mirë se sa kur e lanë vendin e tyre dhe mund të përballojnë ndërtimin e apartamenteve më të mëdha, biznese, ose blerjen e tokës*”. (Sussman, 2010) Ajo pohon se: *“bashkatdhetarët nuk i mirëpresin gjithmonë filozofitë e reja, produktet ose gjuhën e theksuar të të kthyerve dhe mund t'i perceptojnë ata si një kërcënim për rendin mbizotërues social dhe shpirtëror*”(Sussman, 2010). Nga ana tjetër, konteksti i Hong Kongut, me historinë e tij unike dhe qëndrimin fleksibël dhe të hapur ndaj të rikthyerve tregon se si mjedisi kulturor dhe qëndrimet e vendit amë mund të ndryshojnë përgjigjen emocionale. Sussman pohonte se: *“njerëzit nga Hong Kongu ishin më pozitiv, të hapur dhe fleksibël ndaj të kthyerve, duke u lejuar atyre të ruanin një identitet shtesë/bikulturor me pak stres. Për këtë*”, ajo shtoi se: *“të kthyerit në Hong Kong kanë raportuar më shumë emocione pozitive për të qenë në shtëpi*” (Sussman, 2010). Dallimet në gjetjet në studimet e mësipërme tregojnë rëndësinë e kontekstit historik dhe shoqëror të vendeve të origjinës në përvojat psikologjike të të kthyerve gjatë tranzicionit kulturor.

2.5 Këndvështrim mbi lëvizjet migratore në Shqipëri

Marrëdhënia midis migracionit shqiptar dhe pabarazive shoqërore në Shqipëri është kompleks dhe ka nxitur shpeshherë debate mbi migrimin. Dukuria e emigracionit nuk është një dukuri aspake re si njëfenomen social. Përsa i përket realitetit shqiptar mund të themi se

ne e kemi parë këtë fenomen si shumë të hershëm dhe gati të përhershëm në shoqërinë tonë. Nqs kthehemi prapa në histori ne do të gjejmë shembuj të shumtë të emigrimit të shqiptarëve. Arsyet kanë qënë të shumëllojshme. Gjatë mesjetës për shkak të luftrave anti-osmane shumë shqiptarë u detyruan të largohen drejt brigjeve italiane (Doka, 2005).

Sipas Ballanit Shqipëria vazhdimisht ka qënë një vend betejash dhe shqiptarët janë përfshirë në lufta mizore. Duke marrë shkas nga faktorët e luftrave shqiptarët janë detyrar për shkaqe të luftrave të lëvizin nga vëndi i tyre. Emigrimet e hershme janë drejt vendeve fqinje si Italia dhe Greqia. Sipas autorit emigrimet e shek XIV dhe shek XV ishin dyndje nga osmanët drejt jugut të Italisë. Këto migrame janë nga të parat që ruhen në memorjen historike, vala e parë nisi mbas vdekjes së Skenderbeut. Sipas Tirta në librin e titulluar “*Mërgimet shqiptare*” i biri i prijësit antiosman së bashku me bashkëshorten u zhvendosën në Napoli së bashku me disa nga familjet më të mëdha aristorate shqiptare (Tirta, 1999). Sipas llogaritjeve të bëra në atë kohë rreth 200 000 shqiptarë u larguan. Sipas sociologut Kosta Bajaraba kjo shifër përbënte $\frac{1}{4}$ e popullsisë së asaj kohe çka tregonte që Shqipërisë së asaj kohe i kishte humbur pjesa më e rëndësishme dhe pjesa më elitare e popullatës. (Barjaba, K., Dervishi, Z. dhe Perrone, L., 1992).

Edhe në periudhën e gjatë të pushtimit osman procesi i emigrimit të shqiptarëve është një fenomen i vazhdueshëm dhe komunitete të mëdha shqiptarësh i gjejmë anekënd Perandorisë Osmane. Titra thekson se: “ *migracioni i shqiptarëve ka si fillesë problemet sociale, ekonomike, politike, për shkak të kushteve që iu ofrohen në vëndin tonë*”. Në këtë vëllim autori na jep shifra interesante në numrin e emigrantëve shqiptar. Sipas studiuesit që nga vitet (1845-1912) numri i migrantëve ka qënë i madh dhe kryesisht në vendet perëndimore (Tirta, 1999). Një numër njerëzish vazhduan të lëvizin në periudhën

osmaneedhe për shkaqe të luftës së mëvonshme antiosmane. Si pasojë e kundërshtimit të autoriteteve osmane ndodhën shumë shpërnguljet të cilat detyruan shumë fshatra me popullsi tërësisht shqiptare të çoheshin në Azi. Sipas Bajraba theksohet se: *“fshatra të tërë shqiptarësh u dërguan në Turqi në mënyrë që të mposhteshin revoltat ngritëse kundër perandorisë osmane.”*(Barjaba, K., Dervishi, Z. dhe Perrone, L., 1992). Në kontestin historik nuk duhet të lëmë pa harruar edhe *Traktatin e Shën Stefanit të vitit 1887* e cila bëri që shumë toka shqiptare ti dhuroheshin vendeve fqinje si Mali i Zi, Bullgari dhe Greqia etj. Pikërisht ky faktor historik bëri që shumë shqiptarë të shpërnguleshin në territoret jugore, por edhe në drejtim të Turqisë. Autorë të ndryshëm kanë folur rreth migracionit shqiptar. Edith Durham shkrimtarja e famshme britanike ka shkruar në shkrimet antropologjike për shqiptarët, për kulturën e tyre dhe lëvizjen e shqiptave. Sipas saj shqiptarët vazhdimisht janë detyruar të lëvizin ndonëse ajo nuk na jep shifra. (Durham, 1909).

Fillimi i shek të XIX i gjeti shqiptarët në një lloj të ri emigrimi. Ky ishte emigrimi ekonomik drejt SHBA por edhe në drejtim të disa shteteve fqinje si Rumani, Bullgari ku u krijuan komunitete të rëndësishme me shqiptarë. Shpallja e pavarësisë dhe copëtimi i Shqipërisë ishte një faktor i ri që ndikoi dhe kushtëzoi në emigrimin e shqiptarëve. Shumë shqiptarë që mbetën në Mbretërinë e Greqisë u kushtëzuan që të largohen drejt Turqisë ose drejt Shqipërisë. Qënia pjesë në Mbretërinë e Serbisë ndikoi që shumë shqiptarë të largohen nga Kosova dhe territore të tjera nën Serbi (Doka, 2005). Kujtojmë marrëveshjen që bëri Turqia me Greqinë në Traktatin e Lozanës ku mbetën jashtë kufijëve shumë shqiptarë myslimanë për shkak të dëmbimeve masive nga Greqia, pjesa më e madhe e tyre u vendos në Turqi. Pjesa më e madhe e komunitetit çam u presekutua dhe u dëbua nga vendi i tyre. (De Rapper, 2000). Sic u përmend informacionet rreth emigracionit shqiptar nuk janë shumë

të sakta. Për periudhën e para dhe pas pushtimit osman dokumenta nuk të lejojnë të japësh shifra të sakta, pasi në ato kohë nuk ka patur mundësi për të regjistruar të gjithë ata që migronin.

Ndërsa emigracionin ekonomik më të hershëm drejt SHBA por edhe në drejtim të disa shteteve fqinje si Rumani, Bullgarinë fillim të shekulli XX e kanë bërë shqiptarët nga krahinat jugore dhe juglindore si Korça, Devolli, Kolonja, etj. Nga të dhënat rezulton se personat të cilët migronin ishin kryesisht meshkujt të moshës 16-60 vjeç. Ata migronin për shkaqe ekonomike. Nga studimet e bëra një pjesë e tyre nuk u kthyen në Shqipëri duke krijuar atje familje me shtetase të huaja dhe duke lënë familjet këtu. Duhet theksuar se mungesa e kontaktit me familjet në vendin e origjinës bënte që shpesh here familjet ti vajtonin ata si të vdekur dhe shumë gra mbeten në kushte të vështira, duke vajtuar fatin e migrantit. Ata shpesh herë janë etiketuar si “*Kurbetllinj*” fjala “*kurbet*” vjen nga turqishtja që do të thotë “*Jashtë bote*” e cila në vetvete nënkupton vuajtje dëshpërim, sakrifica (Tirta, 1999).

Në kujtimet e tij Fan.S.Noli shkruan se rreth 30'000 shqiptarë jetonin në Amerikë dhe ata dërgonin familjeve të tyre rreth 3 milion dollarë në vit “*pothuajse e gjithë Toskëria jetonte me paratë e dërgura nga Amerika*”. Megjithatë ajo që duhet patur parasysh që kishte edhe nga ta migrantë të cilët u kthyen në vendlindjen pas periudhës së mbretit Zog të cilët sollën me vete, arsimin, ekonominë, higjenën dhe një pjesë të kulturës perëndimore (Tirta, 1999).

Pas Luftës së Dytë Botërore shumë shqiptarë u larguan si kundërshtarë politikë të komunistëve pa mundur të ktheheshin më në atdhe. Në vitet 1945-1950 me vendosjen e regjimit komunist në vend popullsia filloj të rritej në vend dhe harta demografike u zgjerua. Sipas të dhënave në vend rezultonte se shtimi erdhi vetëm nga ndryshimi i disa faktorëve.

Kushtet më të mira jetese, kujdes me i madh shëndetësor, por edhe për shkak të stimulimit të lindjeve nga ana e regjimit. Migracioni u konsiderua me ligj i jashtëligjshëm dhe dënohej ashpër prandaj erdhi duke u tkurur (Sjöberg, 1992). Sipas censusit të vitit 1960 lëvizjet migratore u bënë brënda vendit nga zonat rurale drejt atyre urbane kurse mundësia këto për të lëvizur jashtë ishte e pamundur (UNDP-Albania, 2000).

Gjithësesi emigracioni shqiptar në këto vite vazhdonte në territoret e banuara me shqiptarë jashtë Shqipërisë. Profesor Kosta Bajraba tek libri *“Shqiptarët këta ikës të mëdhenj”* shkruan, për kujtimet e një emigranti se: *“Unë erdha në Amerikë në vitin 1969. Dhe a e dini pse?. Vetëm për të nxjerrë tremijë dollarë, të cilat më duheshin për të riparuar shtëpinë. Me punën time këtë shumë nuk e pata të vështirë për ta bërë. Pastaj oreksi mu shtua. Pse të mos rri më dhe disa kohë, pyeta veten deri sa të nxjerrë paratë për të bërë një shtëpi të re. Edhe këtë synim e realizova. Dhe u bëra gati për tu kthyer, ndërkohë vëllai më dërgoi lajm se kishte dëshirë për të ardhur në Amerikë për të njëjtin qëllim. Nuk mund të mos e prisja. Kthehem bashkë mendova. Por edhe me vëllanë ndodhi e njëjta gjë. Pastaj njëri pas tjetrit erdhën në Amerikë vëllezërit dhe motrat. Ne u bëmë streha e tyre. Dhe nuk pyetëm dot më për Prespën tonë të dashur. Tani jetojmë të gjithë në Dearborn. Vetëm nga fisi im, me vëllezër e motra dhe nipër e mbesa bëhem rreth 70 familje. Kemi ngritur nga e para një Prespë të vogël. Por mendjendhe shpirtin e kemi, megjithatë atje. “Dearborn, Michigan, gusht 1998”* (Bajraba, 2003, p. 236).

Për sociologun Bajraba dhe për shumë sociologë të tjerë emigracioni është një lëvizje zinxhir midis individëve dhe familjarëve të tyre. Emigracioni interpretohet si një hallkë që lidh familjet nga vendi i origjinës drejt atij pritës. Sipas tyre emigrantët krahas emigracionit

vetjak tërheqin edhe familjen e tyre duke e rritur edhe me tepër numrin e atyre që emigrojnë.

Arshi Pipa thekson se: *“popullsisë shqiptare shpesh herë nuk i dhënë e drejta për lëvizjen e lirë. Emigrantëve ju është mohuar nga vetë vendi i origjinës e drejta e rikthimit”* (Pipa, 1984, pp. 435-464). Sjellim në memorje incidentin e familjes Popa në ambasadën italiane e cila mbështeti këtë familje, drejt rrugës për liri. Ish funksionari i Ministrisë së Punëve të Jashtme të asaj kohe e kujton në detaje në librin e tij *“Në kërkim të parajsës”*, shkruan se: *“pjestarët e familjes Popa ju prezantuan rojes së ambasadës italiane si shtetas italiane, dhe pse roja arriti ta kuptonte nuk arriti ti nxirrte me dhunë jashtë ambasadës. Popajt mundën me ndihmën e ambasadorit italian të hynin në godinën e ambasadës dhe të qëndronin aty. Është e kuptueshme se familja Popa nuk ka vepruar e vetme, sigurisht kjo familje ka pasur mbështetjen e ambasadës italiane dhe kjo ka qënë një veprim shumëi rrezikshëm për vet kohën”*(Muçostepa, 1993)

Ndalimi i largimit nga Shqipëria vazhdoi deri në vitet 90 të shek XX. Pas shembjes së komunizmit në Europën Lindore edhe shqiptarët filluan të reagonin kundër regjimit komunist. Nga nga format e reagimit ishte edhe largimi nga vendi. Nga ana e tij regjimi duke i'u trembur këtij fenomeni reagoi me ashpërsi. Gjithë postave kufitare shqiptare iu dha urdhër që të qëllonin me armë kundër të gjithë individëve që tentonin të largoheshin nga vendi. Pavarësisht nga ky reagim i ashpër, largimi i shqiptarëve vazhdoi me përmasa të mëdha.

Gjatë verës së vitit 1990 një numër i konsiderueshëm njerëzish u dyndën drejt ambasadave të huaja. Daliver Bengasi theksonte se *“policia shqiptare u gjend krejt e pa përgatitur për një lëvizje të tillë. Policia në ato ditë ishte përballë një dileme, të ruante rendin dhe*

qetësinë me kompetencat që i jepte ligji, apo të shmangte gjakëderdhjen, duke lejuar qytetarët të kalonin lirshëm në ambasadë dhe për tu futur lirshëm, për fatin e mirë të të gjithë palëve që merrnin pjesë në këtë situatë mjaft të tensionuar nuk pati incidente të rënda. Në ato ditë në Tiranë erdhën përfaqësues të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të cilë bënë negociata me qeverinë shqiptare, në mënyrë që të shmangej ndonjë incident, i cili mund ta gjeneronte situatën në drejtim të padëshiruar”(Bengasi, 2003).

Corriere Della Sera në raportin e javë shkruante se: *“Në datën 9 korrik në aeroportin e Tiranës u ul avioni Jet Tupolev 154, i cili përdorej nga presidenti çekoslovak. Në këtë avion u transportuan në Pragë 51 qytetarë shqiptarë të cilët kishin hyrë në ambasadën Çekosllovake”* (Sera, 1990). Po dy ditë më vonë nga shtypi italian shkruante se: *“nga ndërhyrjet që bënë kancelaritë europiane në datën 13 korrik të vitit 1990 u bë e mundur që të largoheshin nga Shqipëria 4803 refugjatë ndër të cilët 2000 të strehuar në ambasadën franceze, 2000 në atë gjermane dhe 803 në atë italiane. Ata u nisën drejt Durrësit për të zbarkuar në portin e Brindizit e për të vazhduar më tej në vendet që u kishin ofruar strehim”(Corriere, 1990).*

Sociologu Bajraba në librin e tij *“Shqiptarët këta ikës të mëdhenj”* shkruan ndër të tjera për atë se çfarë i priste migrantët në vendet ku ata po shkonin. Ai theksonte se *“mund të themi se valët e fundit të eksodit janë bërë kryesisht në nxitjen e këtij imazhi, pa dallim. Ajo ndriçoi dhe zgjoi shpresat e shqiptarëve pa dallim për një jetë më të mirë. Shqiptarët thoshin “Europa” pa marrë parasysh shtetet e ndara të saj”(Bajraba, 2003, p. 70).*

Orientimi i emigrantëve sipas Kosta Bajrabës u bë në bazë të motiveve gjeografike që ishin më veprues në flukset emigratore drejt Greqinë, ndërsa në rastin e Italisë motivet gjuhësore janë më tepër vepruese. Në atë kohë një pjesë të mirë të popullsisë shqiptare e kishin të

njohur gjuhën italiane (Bajraba, 2003, p. 70). Paraqitja e berë në lidhje me emigracionin është bërë për të shpjeguar së pari formën më të zakonshme që ka pasur Shqipëria dhe së dyti për të zbuluar efektin e migracionit. Ish presidenti i asaj kohe Ramiz Alia theksonte se: *"Eksodi i 2 korrikut për mendimin tim qe tentimi i parë drejt Europës, një tentim dramatik dhe i dhimbshëm, vëshimi nëpër ambasada u duk si një zgjidhje më e realizueshme, për daljen në botë, sidomos pas rënies së murit të Berlinit"*(Alia, 1993). Sipas shumë shkrimeve të asaj kohe qarkullonin fjalë se ishte vetë politika e asaj kohe e cila kishte dhënë lirinë të hyrë lirshëm pranë ambasadave.

Profesor Zyhdi Dervishi flet për një mosnjohje të shqiptarëve për vendet europiane dhe aq më pak për ekonominë dhe mundësitë që Europa do t'ju ofronte emigrantëve shqiptarë (Dervishi, 2003). Për ta zgjedhja ishte thjesht gjeografike por atyre më vonë do t'ju kushtonte një rikthim të mundshëm. Po me të njëjtin shqetësim sociologu Zyhdi Dervishi shkruan: *"Emigrimi është një dukuri me rrjedhoja të shumëanshme, zhvilluese, frenuese e shpesh kontradiktore në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, ekonomike, politike e psikokulturore në rrafsh botëror, veçanërisht në vendet që janë më të ekspozuara ndaj "flukseve" më intensive të "eksportimit" dhe të pritjes së emigrantëve"* (Dervishi, 2003, pp. 1-2).

Si pasojë e këtyre ngjarjeve qeveria shqiptare e asaj kohe ndërmori një hap të rëndësishëm për lëvizjen e lirë. Ajo rishikoi Ligjin Nr.5506, datë 28.12.1976 i cili hyri në fuqi me anë të një dekreti të posaçëm të Kuvendit Popullor më datë 12 qershor të vitit 1990 duke riparë përkatësisht, nenin 11, nenin 12 dhe nenin 23. Neni 23 vendoste: *"Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënien e vizave për shtetasit shqiptarë"*. Tek neni 11 dhe tek neni 12 parashikohej pajisja me pasaportë e qytetarëve brenda një muaji nga

aplikim i tij¹. King bën një ndarje në katër stade për migrantët shqiptarë të periudhës së pas vitit 1990.

- a) “*Emigrantët e Ambasadave*” në vitin 1990,
- b) “*Eksodi Masiv*” në vitin 1991,
- c) *Kriza e Piramidave*” 1997,
- d) “*Kriza e Kosovës*” e vitit 1999 (King R. & Vullnetari J., 2003)

2.6 Efektet e migrimit pas viteve '90 në Shqipëri

Për shkak të situatës së vështirë ekonomike pas viteve 90 shqiptarët u larguan në masë jashtë Shqipërisë. Një aspekt i dytë i migracionit shqiptar ishte edhe migracioni i brendshëm. Nga zonat malore dhe qytetet e vogla nisi një migracion drejt zonave fushore dhe qyteteve të mëdha të vendit.

Pothuajse e gjithë Shqipëria u përfshi në migrim. Në rajonin Jugor, ku performanca relativisht më e mirë ekonomike dhe afërsia me Greqinë bëri që shumë shqiptarë të largohen drejt Greqisë, ndërsa migrimi i brendshëm është më i butë. Qendra që është zona më e pasur e vendit mori migrimin e brendshëm, por edhe ajo u përfshi në një emigrim të jashtëm kryesisht drejt Italisë dhe vendeve të tjera të Europës Perëndimore. Fenomeni i largimit të shqiptarëve mori përmasa të mëdha.

Duke patur parasysh që eksodi i madh i viteve 90 u bë në vendet fqinje si Italia dhe Greqia për shkak të përmasave të mëdha që mori eksodi edhe vendet pritëse patën pakënaqësitë e tyre. Ish ministria italiane e emigracionit të asaj kohe Margherita Boniverniu mundua të jepte zgjidhje dhe rrugëdalje politike pakënaqësive që vinin nga popullsia vendase italiane për grupin e emigrantëve. Duke parë që mbas hyrjes së regjimit demokratik në vendin tonë

¹Kuvendi Popullor i RPSSH, 12.06.1990

Italia ishte vendi i parë i cili kërkoi riatdhesimin e tyre pasi Shqipëria nuk cilësohej më si një vend i pasigurt. Shteti italian filloi të punojë për riatdhesimin e shqiptarëve në vendin e origjinës. Pikërisht kjo ishte politika e parë rikthyese dhe përballja e parë me fluksin e migrantëve në vend. Duke qënë se ky kontigjent ishte larguar drejt vendeve si kontigjenti me statusin e refugjatit politik dhe qënë se Shqipëria tashmë ishte demokratike atyre ju binte e drejta që të përfitonin nga statusi i tyre politik (Canti.G, 2000).

Arsyet e migrimit ishin zakonisht arsye ekonomike çka solli edhe refuzimin në bërjen e dokumentave nga ana e shtetit italian. Duhet theksuar se fillimisht shteti italian u përpoq të përdorte rrugën e mirëkuptimit duke marrë reforma bindëse, në mënyrë që ata të ktheheshin në vendin e origjinës. Ata madje ofruan 50'000 lira dhe veshmbathje për migrantët të cilët ktheheshin vullnetarisht në vend. Duke parë se kjo ishte një mënyrë që nuk po funksiononte për t'i kthyer shqiptarët në vendin e origjinës ata përdorën edhe forcën (Canti.G, 2000)

Kontigjenti i stadiumit “*Vittoria* “ u riatdhesua në një kohë të shkurtër. Gjithashtu edhe vetë Komuniteti European hartoi një fond me 3 milion dollarë për t'i ardhur në ndihmë gjëndjes emergjente në të cilën ishte Shqipëria. I gjithë ky qëllim ishte pikërisht mundësia për të bashkëpunuar me vendin tonë mbi rregullimin migracionit në mënyrë vullnetare. Organizatat ndërkombëtare si IOM dhe UNCHR së bashku me Komunitetin European u munduan të vendosin rregull në migracionin vullnetar të kthimit dhe në rregullimi e një emigracioni të rregullt (IOM, 2000).

Sipas të dhënave nga IOM rezultuan se në gusht të vitit 1991 u riatdhesuan në mënyrë vullnetare rreth 1130 shqiptarë. Sipas të dhënave të dokumentara në atë kohë kjo iniciativë u mor nga qeveria italiane së bashku me IOM, UNCHR, UNDP dhe Fondi Nërkombëtar Monetar.

Operacioni i titulluar “*L’operazione Pellicano*” ishte një nga marrëveshjet më të rëndësishme të asaj kohe pasi u ndërmor me trajnimin dhe marrëveshjet midis dy shteteve mbi lëvizjen e qytetarëve, si edhe me trajnimin e policisë së shtetit. Italia kontribuoi jo vetëm në sigurinë e vendit por edhe në ndihma për periudhën në të cilën ne ishim. Nëperiudhën kohore 1995-1996 sipas të dhënave nga Banka Botërore rezultoi se jashtë kufijve shqiptarë ndodheshin rreth 350’000 mijë shqiptare rezidentë me dokumenta të rregullta (UNDP, 1996).

Duke patur parasysh krizën ekonomike të shkaktuar nga firmat piramidale Shqipëria do të pësonte një eksod të dytë. Këtë ikje masive King e kishte quajtur me termin “*Eksodi i Piramidave*”(King R. & Vullnetari J., 2003). Në prill të vitit 1997 në Itali kishin zbarkuar 30’000 emigrantë, në Greqi 40’000 emigrantë (DILMA, 2007).

Qeveria Nano e asaj kohe ju kërkoi vendeve fqinje në Itali dhe Greqi mundësinë e dhënies së statusit të emigrantit. Këtë ajo e kërkoi edhe në vende të tjera, ku kishte shqiptarë. Kontigjenti i migrantëve do të vazhdonte deri në vitet 2000 gjithnjë e më shumë në mënyrë të heshtur. Migracioni viteve 90 deri në fillimet e viteve 2000 ka qënë pothuajse një migracion tërësisht me karakter ekonomik për shkak të vështirësisë të madhe për punësim që kishte përfshirë Shqipërinë e atyre viteve.

Pas viteve 2000 ndryshojnë edhe arsyet e largimit të shqiptarëve. Shumë tanimë emigrojnë jo vetëm për arsye ekonomike. Bazuar në raportin “*Ri-integrimi i të rinjve të kthyer nga emigracioni dhe ri-integrimi në sistemin arsimor shqiptar*” diskutimet e kryera nga studentë tregojnë se arsyet për ikjen përfshijnë, ndër të tjera, kushtet shëndetësore të anëtarëve të familjes me qëllim të marrjes së shërbimit shëndetësor në vendin pritës, ose kërkimi i mundësive për arsimim më të mirë për fëmijët / të rinjtë e tyre në vendin pritës.

Në vitet 2000 u vërejt edhe një fenomen i ri në migracionin shqiptar. Ishte momenti kur emigrantët shqiptarë filluan të tërhiqnin edhe familjet e tyre në vendin ku ata kishin emigruar. Sipas sociologut italian A. Portera: *“Imigrimi (emigrimi) në Itali është një çështje e familjes dhe kjo gjë dëshmohet nga numër i lartë i kërkesave për bashkim familjar dhe një numër akoma më i lartë i fëmijëve të huaj të lindur në Itali. Për rrjedhojë, prania gjithnjë e më e madhe e familjeve emigrante në shoqërinë italiane ka çuar në një raport më të drejtpërdrejtë të këtij grupi me shoqërinë italiane, grup ky që paraqet nevoja për shërbime sociale, edukuese, kulturore etj”* (Portera, 2003).

Pas vitit 2000 vihet re një rritje e numrit të të kthyerve. Nga rezultatet e të dhënave të Instatit në vitet 2000-2009 kemi këtë trend i cili tregon që më rritjen e remitancave po ulët edhe numri i migrantëve të kthyer. Ndërsa ata që u zhvendosën jashtë, vendit migruan veçanërisht në Itali dhe Mbretërinë e Bashkuar (IOM, 2010).

Bashkë me masën e madhe të njerëzve të thjeshtë drejt Greqisë dhe Italisë u detyrua të largohej dhe pjesa më e madhe e elitës shqiptare. Ata së bashku me familjet e tyre u detyruan të emigronin, më tepër për shkaqe ekonomike sesa për kualifikime të mëtejshme. Po sipas të dhënave nga Instat raporti midis atyre që ikin dhe që kthen që nga viti 2001-2016 është diku 15 mijë deri në 20 mijë individë që dalin dhe hyjnë në vendin tonë.

Megjithatë të ardhurat që sjellin migrantët në vendin tonë tregojnë se janë rritur më tepër në vitet 2006-2012 me 5.3 % çka tregon se ata kanë shpresën për të investuar diçka këtu. Fill mbas vitit 2016 vërehet se numri i remitancave fillon të bjerë dhe sipas statistikave dhe verifikimeve të bëra nga Banka e Shqipërisë transfertat e parave të bëra nga UesterUnion bëhen për interes të familjarëve për rregullim e dokumentave (express, 2019). Trendi i migracionit shqiptar është disa herë më i lartë se ai i mesatares së vendeve në zhvillim.

Shpjegimi që autorë të ndryshëm japin këtij procesi lidhet drejtpërdrejt me integrimin. Ai e shpjegon qartë integrimin si një proces i rëndësishëm të migrantëve në vendin pritës. Problemi nuk qëndron tek migracioni si proces lëvizës nga një vend tek tjetri por tek vetë pasojat që do të shfaqen më vonë mbi politikën menaxhuese të migracionit.

Sipas parashikimeve që studiues të ndryshëm japin lidhen me problemin e ri-migrimit për shkak se migranti nuk i përshtatet dot kulturës, gjuhës së vendit pritës ose politikën e vendit pritës nuk janë favorizuese.

Shkaqet e rikthimit janë shkaqe kryesisht ekonomike pasi në vendin pritës ata nuk ishin në gjendje të integroheshin ose nuk ishin në gjendje të përballonin jetesën. Ky kontigjent njerëzish e panë rikthimin si mundësinë e vetme. Për sociologun Bajraba: *“një migrant pushon së qeni i tillë deri në momentin që ai fillon një punë dhe vazhdon të krijojë jetën në vendin e origjinës. Migracioni i kthimit është parë si një marrëdhënie shkak–pasojë midis migracionit dalës dhe atij hyrës”* (Bajraba, 2003).

Përsa i përket migracionit të kthimit përkufizimet ndryshojnë sipas qasjeve teorike. Një formë tjetër migracioni parë në këndvështrimin të ri social shihet të jetë ri-migrimi.

Vetëm nga viti 2003 problemi i migracionit në Shqipëri filloi që të shihej me shqetësim. Në shtypin e kohës hasim togfjalësja si *“largimi i trurit”* dhe *“rikthimi i trurit”*. Ka qenë prej kohësh një argument global se migrimi i njerëzve të kualifikuar është një *“largim i trurit”* nga vendi i origjinës. Në vitet 1960 dhe 1970 termi *“largim i trurit”* u përdor për të përshkruar migrimin e individëve të arsimuar dhe të aftë shumë të kualifikuar nga vendet e zhvilluara (Bartram, 2014).

Pas shqyrtimit të literaturës mbi të kthyerit, mund të shqyrtojmë se mundësia e ri-emigrimit ose kthimit në vendin e origjinës ka dy efekte pozitive.

- Këto efekte janë shtimi i kapitalit njerëzor në vendin e origjinës. Njerëzit që ri-emigruan janë kapital njerëzor dhe ka shumë mundësi të jenë migrantë të kualifikuar, duke përfshirë këtu dhe studentë dhe të kualifikuarit e tjerë nga ana profesionale.
- Të ardhurat që ata sjellin në vendin e origjinës.

Vendet pritëse konsiderohen gjithmonë si përfituese të këtij procesi pasi individë të aftë kontribuojnë në zhvillimin e vendit duke përdorur kapitalin dhe njohuritë e tyre. Studentët (migrantët potencialish të kualifikuar) që u larguan nga vendi për të ndjekur studime të larta dhe për të qëndruar atje për të fituar dije në fushën e ekspertizës, janë konsideruar si grupi kryesor i procesit të *“largimit të trurit”*.

Departamenti i Administratës Publike është përpjekur të favorizojë punësimin e shqiptarëve të trajnuar jashtë vendit. Në vitin 2004, kërkesat për punësim ishin të shumta. Viti 2005 sipas raporteve të IOM dhe INSTAT solli edhe migrantët e parë në vend. Sipas IOM: *“Migrant hyrës është ai i cili rikthehet në vendin e origjinës pasi ka kaluar të paktën një vit jashtë”* (IOM, 2018).

Qeveria shqiptare e ardhur në pushtet pas vitit 2005 mori një iniciativë duke lënë mënjane pozicione vakante në Administratën Publike për migrantët e kthyer. Genc Pollo, Ministri i Arsimit, udhëhoqi një delegacion në shkurt të vitit 2006 në Romë dhe Firence. Mendohej se 3,000 studentë shqiptarë ndodheshin në Itali. Qëllimi i vizitës ishte promovimi i këtij projekte qëllim për të rikthyer studentët shqiptarë. Kjo iniciativë nga njëra anë u përshëndet kurse nga ana tjetër u kritikua sepse e zhvlerësonte sistemin e universitar shqiptar duke i dhënë përparësi atyre që kanë studiuar jashtë vendit, pavarësisht nga treguesit e meritës. Disa dyshime mbeten për llojin e punës që mund të bindë në mënyrë

efektive migrantët e kualifikuar për t'u kthyer. *“Vetëm karrierat politike mund të tërheqin migrantë të aftë”*.²

Ri-migrimi dhe ri-integrimi kanë një kuptim gati të njëjtë por që nga ana funksionale ndryshojnë. Ri-migrimi është procesi i zhvendosjes gjeografike ose kthimi nga vendi që ka emigruar drejt vendit të origjinës. Ndërsa ri-integrimi ka një kontekst më të gjerë ai përbën një thelb akoma më të madh që lidhet me kulturën dhe kryesisht me të gjitha aspektet e jetës. Ri-integrimi përfaqëson të gjitha elementet e jetës si ri-integrim shoqëror, arsimor, ekonomik, kulturor, social etj. Sipas IOM ri-integrimi është: *“proçesi i ripërfshirjes apo trupëzimi i një personi në një grup njerëzish. Psh një migrant i rikthyer në vendin e tij të origjinës për një qëndrim të përhershëm”* (IOM, 2010).

Bazuar në të dhënat e dhjetëvjeçarit të fundit shumica e migrantëve janë kthyer në vendbanimin e tyre të zakonshëm kryesisht para migracionit, megjithatë vihet re një tendencë e të kthyerve për t'u vendosur në qarqe me zhvillim të madh socio-ekonomik p.sh. Tirana. Tirana është një ndër destinacionet më të preferuara, duke u pasuar nga Vlora, Elbasani, Fieri dhe Korça (në rastin e të kthyerve nga Greqia) dhe Shkodra, Lezha, Durrësi dhe Dibra (për të kthyerit nga Italia).

Në pesë vite 2009-2015 migracioni shqiptar është karakterizuar nga kthimi i migrantëve në vendin e tyre të origjinës. Migrantët e kthyer investojnë paratë e tyre në projekte, rezultatet e të cilave i prekin ata personalisht, duke u përfshirë drejtpërdrejtë në atë që po bëjnë. Ata janë të përgatitur për të ngritur bizneset dhe për të krijuar vende pune në vendet ku investitorët e mëdhenj nuk do ta konsideronin si mundësi. Ekonomia shqiptare është në

²Intervistë me Drejtoreshën e Drejtorisë Qendrore të Zyrës së Shërbimit turistik Znj. Majlinda Hafizi

gjendje të absorbojë më mirë një investim të vogël tani, sesa investimet e huaja në sasi të mëdha parash (Hana & Telo, 2004).

Sipas një kërkimi të kryer nga INSTAT shihet se arsyet kryesore të kthimit të migrantëve në atdhe sipas deklarimeve të të anketuarve kanë qënë 3:

a) humbja e vendit të punës në vendin pritës,

b) problemet familjare dhe ndjenja e nostalgjisë ndryshe nga vite më parë ku si probleme kryesore ishin hasur ato ekonomike dhe çështje sociale,

c) mungesa dokumentacioni, probleme me çështjet ligjore të vendit, etj.

Sipas të dhënave të INSTAT dhe IOM numri i migrantëve të rikthyer përgjatë viteve 2009-2013 ka qënë 133.544 migrantë shqiptarë të moshës 18 vjeç e sipër. Të kthyerit në Shqipëri në periudhën 2009-2013 janë 98.414 meshkuj dhe 35.130 femra (INSTAT 2013). Kjo është një diferencë e madhe në raportin meshkuj -femra ku numri më i madh i të rikthyerve janë meshkuj me 73.7% dhe 26.3% femra. Ky numër ndikon edhe në numrin e të intervistuarve.

Në të dhënat që na jep INSTAT përperiudhën e viteve 2009-2013 rezulton se numri më i madh i të kthyerve janë nga vendet fqinje Greqi dhe Itali. Studimet e IOM dhe INSTAT për periudhën 2013-2016 tregojnë se 70.3% e të kthyerve kanë ardhur nga Greqia dhe më i vogël është numri i qytetarëve të kthyer nga Italia, përkatësisht 14% e të kthyerve (Eurostat, 2016). Të dhënat e fundit të nxjerra nga INSTAT janë të dhëna që tregojnë 53.4% e njerzëve janë rikthyer vullnetarisht (INSTAT, 2016).

Një pjesë shumë e vogël e migrantëve të kthyer (7%) investuan burimet e tyre financiare. Këto investime u kapitalizuan kryesisht në tregti të vogël, në sektorin e hoteleve, bar-restorantet dhe bujqësinë. Mbi gjysma e migrantëve të kthyer raportojnë një mungesë të shërbimeve cilësore dhe një sistem shëndetësor të papërshtatshëm. Më pas, për shkak të

papunësisë, të ardhurat e pamjaftueshme dhe mungesa e shërbimeve cilësore, gati 1/3 e migrantëve të kthyer dëshironin të ri-emigronin.³ Studime të tjera të bazuara në teknikat cilësore tregojnë se shumica e migrantëve të kthyer nuk shohin ndonjë perspektivë në Greqi apo Shqipëri por më tepër dëshirojnë për të ri-emigruar në vende të tilla si SHBA, Belgjikë dhe Gjermani. Procesi i kthimit të migrantëve ka vazhduar edhe gjatë viteve 2014-2015 por me ritme më të ulëta.

Duhet të bëhet një dallim midis dy grupeve të migrantëve në këtë periudhë.

A) Grupi i parë përbëhet nga *migrantë ekonomik* që kthehen nga Greqia, Italia dhe vende të tjera.

B) Grupi i dytë *migrantët inovativ* të cilët besojnë në ndryshimet e vendit të origjinës.

Të dhënat e pjesshme sugjerojnë se intensiteti i kthimit të këtij grupi është ulur.

Rrjedhimisht, numri i migrantëve të kthyer të regjistruar në Zyrat e Migracionit nga 1.536 persona në vitin 2012 ka rënë në 520 në vitin 2015. Nga ana tjetër, pas janarit të vitit 2015 shpëthen një valë e re emigracioni në Shqipëri. Në këtë periudhë u vu re një rritje e numrit të shqiptarëve që aplikuan për azil në vendet e BE.

Përveç kësaj, këto diskutime treguan se të rinjtë e rritur (mbi 18 vjeç) duket se janë të shtyrë nga fluksi i shumë të larguarve më parë. Shpesh herë ata e kanë konsideruar migrimin si një mundësi ose përvojë tjetër për një jetë dhe shkollim më cilësor. Sipas raportit një nga të rinjtë u shpreh: “Unë prita deri sa u bëra 18 vjeç. Nuk u largova për arsye ekonomike, por pashë miqtë e mi të largoheshin dhe mendova se edhe unë mund ta provoja sesi shkonin gjërat në një vend të zhvilluar si Gjermania” (Dibra, Semini, &

³INSTAT, IOM, Migrimi i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri, 2014.


Allmuca, 2016). Edhe në raste të tjera, mund të vërehet se ndikimi i shokëve ka çuar në vendimin për t'u larguar. *“Ne ishim katër shokë të klasës dhe u larguam nga vendi gjatë 14 qershorit 2015-18 Dhjetor 2015. Çdokush po largohej, prandaj edhe ne morëm vendimin për veten”*. Gjithashtu, shumë njerëzit deklaruan se nuk kishin asnjë informacion për atë që i priste atje dhe shanset për të qëndruar në një vend europian ishin të pakëta *“Unë nuk e dija se çfarë ishte atje për mua. Thjesht dëshiroja të shihja se si ishte jeta në një vend tjetër. Unë nuk i njihja procedurat ose nuk mendova fare, sepse të gjithë po iknin”* (Dibra, Semini, & Allmuca, 2016). Nga ky raport gjithashtu u vu re se, pavarësisht nga arsyet e deklaruara ekonomike, shumë njerëz emigrojnë për shërbime më të mira sociale dhe shëndetësore. Ata vihet re të kenë pranuar se ky fluks i migrantëve duhet të shihet si një vazhdim i tendencës migratore të të gjithë shoqërisë shqiptare.

Pas kësaj vale aplikimesh për azil dhe pamundësisë për ta fituar azilin një numër i madh filloi të rikthehej. Statistikat zyrtare nga Gjermania zbulojnë se në vitin 2015 u kthyen 3.622 azilkërkues dhe në gjysmën e parë të vitit 2016 u kthyen 3.717 të tjerë. Këto shifra tregojnë një tendencë në rritje të procesit të kthimit të azilkërkuesve shqiptarë (INSTAT, 2016).

Sipas Eurostat (Eurostat, 2016), 65,935 shqiptarë aplikuan si emigrantët në vendet europiane gjatë janarit dhe dhjetorit të vitit 2015. Megjithatë të dhënat për emigrantët shqiptarë ende nuk janë të sakta studimet të cilat tregojnë se faktori shtytës për shumicën e rasteve të emigracionit është situata e vështirë ekonomike (EASO, 2013).

Kategoritë dominuese përfshijnë të rinjtë e moshës 18-34 vjeçare, që përbëjnë 79 përqind të rasteve të regjistruar (Eurostat, 2016). Sipas Institutit të Statistikave të Shqipërisë 34.5% përqind e të rinjve (15-29 vjeç) në Shqipëri janë të papunë, të paarsimuar ose të pa trajnuar,

supozohet se një pjesë e migrantëve mund t'i përkasin kësaj pikërisht kësaj kategorie. Në këtë drejtim, rreth 36% e refugjatëve janë fëmijë dhe të rinj deri në moshën 17 vjeç.



Grafiku 2-1: Numri i të kthyerve (në mijë) (INSTAT, 2017)

KAPITULLI III

RI-INTEGRIMI STUDENTËVE TË KTHYER NË UNIVERISITETET SHQIPTARE

3.1 Dimensioni dhe fuqia e Kartës së Bolonjës në ndërkombëtarizmin e diplomave

E drejta për t'u arsimuar sipas Deklaratës së të Drejtave dhe Lirive Themelore, shihet si një e drejtë parësore tek të gjitha shoqëritë moderne. Shkolla është një nga institucionet sociale kryesore.

Shkolla është institucion shoqëror i organizuar me një strukturë të identifikueshme dhe me shumë funksione që kanë si qëllim ruajtjen dhe zgjerimin e rendit shoqëror. Shkolla fokusohet në përcjelljen e njohurive sipas fushave të caktuara, njohuri të cilat u lejojnë shoqërive moderne të përballojnë sfidat e të tashmes dhe të ardhmes.

Studiuesit Hans de Vite dhe Gilbet Merks theksonin se: *“ndërkohë që SHBA dhe Japonia kishin filluar të fuqizoheshin që prej vitit 1960 Europës i duhet të ndërmerre politika të tilla sa më shpejt të ishte e mundur për të mposhtur konkurrencën e këtyre vendeve ku një ndër to ishte edhe arsimit”*(Wit, 2013).

Në lidhje me Arsimin e Lartë dhe me konceptin e Europianizimit të arsimit nismat e para datojnë të paktën në vitin 1988 ku rektorët e të gjithë universiteteve europiane u mbodhën në Bolonjë me rastin e 900 vjetorit të këtij universiteti. Në përfundim duke u nisur gjithmonë nga këndvështrimi se: *“E ardhmja e njerëzimit më së shumti varet nga zhvillimi kulturor, shkencor dhe teorik, dhe se kjo e ardhme ndërtohet nga qendra të kulturës, të dijes dhe të hulumtimit të përfaqësuar nga universitetet e vërteta”* ata nënshkruan “Kartën

e Madhe të Universiteteve” të njohur si “*Magna Carta Universitatum*”, (Magna Carta Universitatum observatory, 1988).

Koncepti i Europeanizimit të sistemit arsimor vazhdoi të ishte pjesë e planeve për bashkëpunim ndër-universitar. Për politikanët e asaj kohe Europa nuk ishte vetëm një bashkësi e një fuqie monetare, por duhet të ndërtonte edhe një politikë të mirë arsimore, prandaj “*Magna Carta*” theksonte se: *“askush të mos mendojë se Europa është vetëm e Euros, e ekonomisë apo e bankave. Ajo duhet të jetë gjithashtu edhe Europa e dijes”*(Committee on Prague, 1998).

Të gjitha këto inisiativa do të finalizoheshin një vit më vonë me Kartën e Bolonjës. Proçesi i Bolonjës është një bashkim vullnetar i vendeve antare të Europës për politikat arsimore. Duke ditur se fuqia e Kartës së Bolonjës ka ndikim dhe në ndërkombëtarizimin e diplomave, Deklarata e Bolonjës ndër të tjera deklaroi se: *“objekti kryesor i kësaj marrëveshje është rritja e konkurrencës së sistemit arsimor European me të gjithë strukturat e arsimit në botë”*. Sipas Kartës së Bolonjës: *“sistemi european kërkon të jetë sa me tërheqës në rang botëror”* (Bologna Process, 2006).

Një nga përparësitë e sistemit të Bolonjës ka qënë edhe mundësia e shkëmbimeve kulturore. Një tjetër përparësi ishte mundësia për unifikimin e diplomave pa as edhe një problem nga njeri vend i Europës tek një vend tjetër. Qëllimi i Kartës së Bolonjës është njohja e diplomave dhe njehësimi i krediteve jo vetëm me vendet që e kanë nënshkruar kartën por të arrihen edhe marrëveshje me vendet të cilat nuk janë pjesë e saj.

Në Kartën e Bolonjës dhe në Konventën e Lisbonës, dalin në pah dy kahe të arsimit:

a) *ndërkombëtarizmi* dhe

b) *konkurenca*

Megjithatë koncepti i europeanizimit të Arsimit të Lartë erdhi duke u përpunuar më thellësisht bashkë me idenë e krijimit të Bashkimit European pas viteve 90. Studiuesit të cilët u morën me çështjet e integritit european si Neave theksonin se: "*studimi më vete i çdo procesi european është i vështirë, ashtu siç edhe e tregojnë në disa rrethana Deklarata e Bolonjës*(1999) *dhe ajo e Lisbonës*(1997). *Proceset e integritit ndërthuren me njëra-tjetrën edhe pse nuk integrojnë njëra-tjetrën*"(Neave, 2000). I tillë është edhe procesi i Bolonjës i cili edhe pse nuk përfshin një inisiativë të BE, financohet nga politikat e saj. Duke patur parasysh politikat që ka BE në zgjerimin e saj edhe procesi i Bolonjës synon që të zgjerojë shtrirjen e tij në vendet të cilat akoma nuk janë pjesë e Bashkimit European. Përfshirja e këtyre vendeve të cilat nuk janë akoma pjesë e BE mund të jetë një ogur i mbarë për përfshirjen e tyre edhe në politikat e tjera për antarësim. Nëpërmjet procesit të Bolonjës vendet jo antare në BE si vendi ynë do krijojnë ura lidhëse. Vendet të cilat nuk janë anëtare të por që janë pjesë e procesit të Bolonjës kanë të drejta të plota nënshkruese të Deklaratës të Bolonjës dhe janë anëtarë me të drejta të plota në vendimarrje. Ato kanë mundësinë që të kontribojnë njëloj sikurse vendet e tjera të cilat janë anëtare të Bashkimit European.

Duke patur parasysh sa theksuam më sipër edhe vendi ynë po përpiqet që të aplikojë të gjitha kërkesat e procesit të Bolonjës. Ne vazhdimisht kemi punuar me dokumentet që propozohen nga vendet të cilat janë pjesë e Kartës së Bolonjës. Megjithatë duket të nënvizojmë se të gjitha vendet janë mbështetur mbi bazën e *Magna Carta Universitatum* (1988) e cila qëndron edhe sot në themel të Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Duke marrë shkas nga *Magna Carta Universitatum* dhjetë vjet më vonë do t'i hapej rruga mundësisë edhe vendeve të për tu bërë pjesë e procesit të Bolonjës. Procesi i Bolonjës me

hapjen dhe ndërkombëtarizimin e arsimit ofon mundësitë më të mira për të konkuruar jo vetëm në arsim, por edhe në ekonomi dhe më gjerë. Këto hapa kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të dijeve, sepse konkurrenca vendeve të tjera të fuqishme si SHBA, Japoni, Kina është e madhe(UNESCO, 1997).

Termin “*ndërkombëtarizim*” e kemi hasur në shumë fusha, por një përdorim më të madh e shohim në sferën arsimore. Përpyqjet për njohje ndërkombëtare sistemeve arsimore fillojnë më së shumti në vitet 1980. Deri në fund të këtyre viteve termat më të zakonshëm të përdoruar rreth sistemeve arsimore kanë qënë “*edukim kombëtar*” dhe “*bashkëpunim ndërkombëtar*”.

Zhan Kaint thekson ndër të tjera se: “*Ndërkombëtarizimi është një nga forcat madhështore që ndikon në formësimin e Arsimit të Lartë. Arsimi i Lartë është në ndryshim të vazhdueshëm për të përballur sfidat e shek të XXI. Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë është një proces në të cilin janë përfshirë aktorë dhe faktorë të realiteteve të ndryshme*” (Kaint, 2014). Në komunikatën e Londrës të vitit 2007 ndër të tjera theksohet se: “*Ne ndajmë aspiratën tonë studentore që trupi studentor që hyn, merr pjesë dhe përfundon Arsimin e Lartë në të gjitha nivelet, duhet të pasqyrojë diversitetet e universiteteve tona. Ne riafirmojmë përpjekjet e studentëve që pavarësisht prejardhjes së tyre sociale dhe ekonomike të arrijnë të përfundojnë studimet e tyre pa pengesa. Prandaj ne duhet të vazhdojmë përpjekjet tona për të ofruar shërbime të duhura për studentët, për të krijuar rrugë më fleksibile për Arsimin e Lartë mbi bazën e mundësive të barabarta*” (Panos London Illuminating, 2007).

Proçesi i Bolonjës përkufizohet si aftësia për të punuar nëpërmjet arsimit dhe kualifikimeve. Nëse përmendim Yorke, ai na parashtron një përkufizim të punësimit si një

“set arritjesh dhe aftësish të të kuptuarit dhe të qëllimeve personale që i bën të punësuarit të suksesshëm në fushën që ata kanë zgjedhur të arsimohen dhe të punësohen” (Yorke, 2018).

Studiues të tjerë theksojnë problemet e ashtuquajtura *“kompetenca”* të cilat edhe i zhvilluan më tej. Benjamin Bloom njohës shumë i mirë i sistemit arsimor u përpoq për të dhënë një përkufizim të Arsimit të Lartë. Ai u përpoq të jepte korniza të forta mbi *“aftësitë”* dhe *“kompetencat”* duke bërë një lloj klasifikimi të kompetencave, përti lidhur ato me një kontekst specifik. Me këto ai kishte parasysh kompetecat e një vendi të caktuar deri në një kontekst që ai e quante një konteksti neutral (Bloom, 2009). Ai jepte modele dhe specifika të përgjithshme, por zbatonte dhe kompetencat më të veçanta. Ai e bënte këtë duke bashkuar nevojat konjektive sociale dhe emotive të të nxënit për studentët e sukseshëm (Musai, 2014).

Një nga studiuesit më të njohur Naom Çomski në strategjitë e tij mbi Arsimin e Lartë thekson se: *‘Në fushën e Arsimit të Lartë në shek XX është e rëndësishme’* **“Kompetenca”** (Klieme, Hartig, & Rauch, 2008). Në këtë kontekst ai jep edhe ide të tjera si **“Arsimi”**, **“Kompetence”**, **“Shkathtësi dhe dije”** të cilat do të ndihmonin edhe më tepër studiuesit të ecnin në rrugën e progresit. Sipas iniciativës së Çomskit mund të themi se edhe iniciativa e Europës të vitit 2020 do të jetë një kërkesë e Arsimit të Lartë European për të rritur kompetencat me qëllim për të ecur më mirë drejt tregut të punës.

Sidoqoftë nuk mund të themi se janë përdorur të gjitha teknikat për një arsim të mirë jo vetëm në realitetin tonë arsimor por edhe në kontekstin e Europës e cila është në vështirësi të madhe si pasojë e krizës ekonomike. Asaj i duhet vazhdimisht të ndërtojë raporte të reja si dhe të rishikojë të dhënat dhe marrëveshjet për arsimin. Sipas Komisionit European

pranohet se: “*aftësia e punëtorit nuk varet shpesh herë nga universiteti apo kualifikimi që ai ka marrë, por nga inisiativa dhe aftësitë që ka pasur ai në dijet e të nxënit. Vëmendja tek zhvillimi dhe aftësimi i kompetencave është përgjithësisht një kontekst i ri dhe ende në proces eksperimentimi*”(European Commission, 2009). Arsimi dhe kualifikimi mbeten si për Europën dhe Shqipërinë një nga pikat më kyçe të zhvillimit të mëtejshëm. Qeveritë dhe komunitetet arsimore duhet të përballen me sfidat për të përgatitur njerëz të gatshëm për t’iu përshtatur më mirë tregut dhe interesave të punës.

Ne deri më tani kemi folur për parashikimet që jep Komisioni European në tërësi, si për shkëmbimet e eksperiencave ashtu edhe për efektet që kanë politikat arsimore dhe akt-marrëveshjet e brendshme midis institucioneve në Arsimin e Lartë.

Sipas raportit të vitit 2012 të Komisionit European (KE) mbi mundësinë për punësim u parashikua ndër të tjera se punësimi duhet parë si një: “*kombinim i faktorëve që u mundësojnë individëve progresin drejt punësimit ose drejt futjes në punë, si dhe ruajnë vendin e punës dhe u lejon atyre të përparojnë gjatë karrierës së tyre*” (European Commission, 2009).

Në komunikatën e Pragës për herë të parë është shtruar *problemi i konceptimit shumë dimensional* të Arsimit të Lartë (Barroso, Topolanek, & Solana, 2009). Kjo komunikatë trajton probleme që lidhen me pabarazinë në Arsimin e Lartë. Komunikata e Pragës ka si që krijimin e kushteve më të favorshme për studentët. Këto kushte lidhen kryesisht me mundësinë për forcimin e kohezionit shoqëror, si edhe zbutjen e pabarazive gjinore të migrantëve dhe shtresës së varfër. Në komunikatën e Bergenit të vitit 2005 u trajtua e njëjta tematikë. Komunikata e Bergenit përfshin trajtimin e barabartë të individëve të gjitha

kategorive të shoqërisë duke theksuar edhe rëndësinë e integritetit të studentëve migrantë që vendosën të riktheheshin. Kjo është edhe një nga sfidat e Europës në fushën miratimit të rregullave të përbashkëta të BE.

Sipas raportit të Komisionit European të vitit 2009 çdo vit autoritetet e kontrolleve të migracionit të paligjshëm kapin më shumë se 500'000 migrantë të parregullt në Europë. Sipas këtij raporti të gjithë këta migrantë dërgohen në vendin e tyre të origjinës pra riatdhesohen pa të drejtën për t'u rikthyer në vendin nga ku deportohen (European Commission, 2009). Sipas Fondit European të rikthimit për këta migrantë të rikthyer përgjatë periudhës 2008-2013, ky fond ka shpenzuar më shumë se 600 milion euro për të mbështetur vendet anëtare në mënyrë që të menaxhojnë situatën e migrantëve të kthyer. (United Nations, 2013).

3.2 Funkzioni i Kartës së Bolonjës

Deklarata e Bolonjës vlerësohet tashmë si një nga faktorët më të rëndësishëm të arsimit në Europës. Ajo përfaqëson një nga elementët më të rëndësishëm të jetës sociale dhe ekonomike dhe është një nga garancitë më të mira për studentët dhe për shkembimet midis tyre. Në brendësi të Deklaratës së Bolonjës ndër të tjera theksohet se: *“ajo konsolidon marrëdhëniet midis qytetarëve dhe garanton një zhvillim më të mirë për mijëvjeçarin e ri”*. Rëndësia që Karta e Bolonjës i jep zhvillimit arsimor dhe kulturor, garanton edhe zhvillimin e një shoqërie më demokratike dhe të lirë. Europa e Njohurive (Europe of Knowledge) vlerësohet tashmë si një nga përparësitë që ofron procesi i Kartë së Bolonjës (Bologna Process, 2006).

Deklarata e Sorbonës e cila u shpall në 25 maj 1998 u fokusua ndër të tjera në rolin qëndror të universiteteve në zhvillimin e dimensioneve kulturore. Megjithatë, zhvillimet

ndërkulturore ndërmjet universiteteve përbëjnë parimet e përgjithshme të kësaj deklarate të rëndësishme. Në Konferencën e Londrës të mbajtur në vitin 2007 u vendosën një sërë përparësish për mobilitetin dhe njohjen e shkollës së lartë nga një vend në një vend tjetër europian, për të ndihmuar në njohjen e diplomave universitare.

Sipas këtyre studiueseve mobiliteti i studentëve arrihej në të paktën dy forma:

- a) *mobiliteti i studentëve në universitete*
- b) *mobiliteti i vetë kredibiliteteve të diplomave*

Mobiliteti në vete-vete synonte një rritje të cilësisë së Arsimit të Lartë në këtë drejtim. Sipas të dhënave të OECD në vitin 2012 në shkallë globale mobiliteti i diplomave është rritur në 41% në raport me vitin 2010. Raporti “*Proçesi i Bolonjës*” në vitin 2015 tregon se vështirësia që hasin studentët për njehsimin e diplomave dhe njohjen e krediteve për transferim studimesh ishte i madhe. Arsye të tjera për vështirësitë që hasin studentët në njehsimin e diplomave dhe njohjen e krediteve sipas të dhënave nga ESU, janë mungesa e informacionit, mangësitë që kanë institucioneve arsimore si edhe paftësia e shtetit për ti mbështetur.

Shumë aktorë të politikës së atëherëshme nuk ishin dakord për një sistem arsimor të tillë, sepse njehsimi arsimor do të ishte tejet i vështirë. Kjo ishte një marrëveshje e përbashkët por që në thelb u interpretua në mënyra të ndryshme solli edhe shumë pasoja në konvertimin e diplomave. Ajo e vështirësoi më tej proçesin e njohjes dhe të edukimit dhe krijoi pengesa në rastet kur studentët transferonin studimet nga një universitet tek një universitet tjetër. Të gjitha këto politika në thelb integruese janë sfidave proçesit akademik. Në strategjinë e Komisionit Europian të vitit 2013 mbi ndërkombëtarizimin e Hapësirës Europiane e Arsimit të Lartë (HEAL) theksohet se: “*mobiliteti gjithmonë ka për të qënë i*

cunguar. Vetem një pjesë e stafit të studentëve dhe akademikëve kishin mundësi të përfitonin nga sistemi Universitar European. Politikat e Arsimit të Lartë duhet të diskutohen në një rrafsh më global. Diskutimet duhet të fokusohen në proceset e mësimdhënies së të nxënit. “Ndërkombëtarizim” do të thotë garanci për pjesën e madhe të studentëve të cilët nuk janë pjesë e mobilitetit të diplomave apo krediteve të zotërojnë” (Report D. , 2000).

Mobiliteti që ju bë diplomave, pati një rol të rëndësishëm në mundësinë e punësimit dhe integritarsimor midis shteteve. Në vitin 2012 Bashkimi European shënoi 27 vjetorin e krijimit të programit Eruasmus. Në vitin 1987 në këtë program u angazhuan 3224 studentë. Sot në këtë program kanë marrë pjesë më shumë se 3 milionë studentë nga të gjithë vendet (library, 2012). Sipas të dhënave vendet që janë anëtarësuar në programin Erasmus janë rritur nga 11 vende në 33 vende. Sfidat që paraqet programi Erasmus ka në themel së paku dy qëllime:

- a) mobilitetin e diplomave dhe
- b) njohjen e krediteve.

Sipas këtij programi arritja e këtyre dy cilësive do të zhvillonte arsimin në rang global. Sipas të dhënave të nxjerra nga OECD të vitit 2012, në shkallë globale mobiliteti i diplomave ka ardhur duke u rritur. Nga viti 2000 deri në vitin 2010 kjo shifër është rritur nga 2.1 milionë diploma në 4.1 milionë diploma të njohura ndërkombëtarisht. Sipas parashikimeve të OECD ky numër do të vazhdojë të rritet akoma (OECD, 2014). Mobiliteti i diplomave cilësohet si një nga nyjet më të rëndësishme për komunikimin midis shteteve dhe shkëmbimin e ndërsjelltë.

Ndërkombëtarizmi i diplomave, solli ndryshime edhe në marrëdhëniet midis shteteve antare të BE dhe më gjerë duke përmirësuar marrëdhëniet midis tyre. Sipas të dhënave vendet e

mëdha të Bashkimit Europian, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Franca tërheqin gati 63% të studentëve nga vendet jashtë BE. Kjo falë Kartës së Bolonjës dhe programit Erasmus.

Programi Erasmus në thelbin e tij ka procesin e shkëmbimit të diplomave. Euro-komisioneria në marrëdhëniet me jashtë Androulla Vassilio theksonte se: *“për 27 vite studentëve iu është dhënë mundësia të studiojnë jashtë, me qëllim zgjerimin e horizonteve. Të dhënat tregojnë që programi Erasmus është më i populluar se kurrë. Si një kontribues i familjes europiane, aftësitë e marra nga Erasmus ndihmojnë studentët për t’u punësuar dhe për të planifikuar karrierën e tyre”* (Erasmus, 2013).

Në raportin e Konferencës Ndërkombëtare Botërore mbi Arsimin e Lartë u theksua se: *“Universitetet gjithmonë kanë qënë të ndikuara nga tendencat ndërkombëtare dhe deri në një farë mase, kanë zhvilluar aktivitetin e tyre brenda një komuniteti të gjerë ndërkombëtar si institucionet akademike, studiuesit dhe kërkuesit. Sot, në shekullin XXI, realitetet kanë treguar rëndësinë e kontekstit global. Gjuha angleze, si gjuha mbizotëruese e komunikimit shkencor është rast i ngjashëm me kohën kur gjuha latine dominonte akademinë në Evropën mesjetare. Informacioni dhe teknologjitë e komunikimit kanë krijuar mjete universale të komunikimit të menjëhershëm dhe kanë thjeshtëzuar komunikimin shkencor”* (Altbach, P.G.; Reisberg, L.; Rumbley, L.E., 2009).

Karta e Bolonjës është një projekt vullnetar i më shumë se 45 shteteve. Vende të cilat me inisiativën e tyre të lirë vendosën të shkëmbejnë eksperiencë dhe kualifikime mes njeri-tjetrit si edhe të njohje të ndërsjellta të diplomave. Euro-komisioneria për arsimin dhe kulturën Vivian Reding shprehet se: *“Bolonja nuk mund të zbatohet, sipas kartës, sipas mënyrës, domethënë në mënyrë të kufizuar a të detyruar, ajo duhet të realizohet*

përzemërsisht ndërmjet anëtarëve. Në të kundërt, ky proces do ta bëjë Arsimin e Lartë në Europë do ta bëjë më të dobët sesa kurrë”(Reding, 2003).

Sipas studiuesve ndërkombëtarizimi do të sjellë njohjen e diplomave dhe unifikimin e Arsimit të Lartë. Cikli i parë zgjat tre vite akademike, ndërsa cikli i dytë, dy vite akademike. Në përfundim të ciklit të dytë lëshohet diploma “*Master*”. Në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve për çdo vit akademik merren 60 kredite. Diploma shoqërohet me listën e notave, e cila shpreh vlerësimin e kualifikimit të fituar sipas vlerësimit nacional dhe atij në kredite”⁴. Ndërkohë që cilki i tretë është cikli i studimeve doktorale.

Ndërkaq ajo që mund të themi për sistemin e Arsimit të Lartë në Shqipëri që viti 2005 e nëështë fakti që: “*Ndarja e cikleve të Arsimit të Lartë është zbatuar me përpikmëri në të gjitha universitetet publike dhe jo publike.*

Të tre ciklet janë ndarë sipas skemës (3+2+3) (Bachelor+Master+Doktoraturë) ose sipas skemës (3+1+3)(Bachelor+Master Profesional+Doktoraturë). Sistemi i ETCS (krediteve) është ngritur në shkallë kombëtare”(Bologna Process, 2006).

Në raportin e fundit të Procesit të Bolonjës “*Bolonja nga pikëpamja e studentëve*” jepen të dhënat sesi e shikojnë studentët çështjen e mobilitetit dhe ndërkombëtarizimit. Raporti tregon vështirësitë që hasin studentët në integrimin në universitet. Sipas raportit dalin në pah vështirësitë që hasin studentët për njohjen e diplomave.

Ndër këto vështirësi renditen:

- 1-) Arsyet financiare (kjo arsye vërehet nga 34 nga 38 unionet studentore)
- 2-) Pengesa e dytë është mungesa e transparencës dhe informacionit,
- 3-) aftësitë e kufizuara të universiteteve, (15 nga 38 unione studentore).

⁴Ligji nr. 9120 datë 28.7.2003 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 10

Duhet të nënvizojmë se ky është një raport i përvitshëm i cili është i përpunuar nga Unioni Universitar European (ESU), organizatë e cila është krijuar që prej vitit 2003. Kjo organizatë merret e çështjet të arsimit.

Procesi i Bolonjës trajtonte tre problematika kryesore:

➤ **Unifikimi i diplomave**

Unifikimi i diplomave nënkupton njohjen e diplomave nëpërmjet “*Kartës së Bolonjës*” pa as edhe një dokument shtesë. Në pamje të parë duket sikurse më futjen e sistemit e Bolonjës këto probleme janë zgjidhur, por kjo nuk ka ndodhur. Ende sot ka mjaft vështirësi në njohjen e diplomave edhe në ekuivalentimin e tyre. Problemet duket sikur janë të thjeshta për t’u zgjidhur për shkak të marrëveshjeve që kanë arritur shtet midis tyre, nëraportin “*Historia ndërkombëtare e Arsimit të Lartë*” Hans de Wit dhe Gelber Merkes theksojnë se: “*duhen vërtet përpjekje të mëdha për të arritur të kemi një arsim të mirëfilltë dhe një sistem arsimor të unifikuar*. (Wit, 2013, pp. 52-53).

➤ **Si bëhet ekuivalentimi i diplomave?**

Sektori i njohjes së diplomave është pjesë e Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë. Aty kryhen njohjet e diplomave, çertifikatave dhe kualifikimeve të bëra jashtë. Njohja e titujve daktoralë nuk bëhet në këto insititucione. (IOM, 2010).

Pavarësisht përfshirjes në sistemin “*Kartës së Bolonjës*” Shqipëria nuk ofron një procedurë të shpejtë të njohjes së diplomave dhe krediteve. Në Ministrinë e Arsimit është ngritur një komision për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave por ky është një proces i ngadaltë dhe plot burokraci. Migrantët hasin në vështirësi për konvertimit e diplomave dhe ky është hapi i parë në rrugën e ri-integrimit.

Mënyra e aplikimit për të konvertuar diplomën bëhet në këtë mënyrë:

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë këto dokumenta

- a) Formularin i aplikimit.
- b) Diplomë ose çertifikatën e dorëzuar / vërtetim diplome.
- c) Listë notash.
- d) Dokumentet zyrtare të identitetit si dhe çertifikatë familjare.
- e) Mandate pagesë dhe 2 copë fotografi (IOM, 2010).

Apikimi nuk bëhet nëse mungon të paktën njëri nga dokumentat e sipër përmendura. Dokumentat pranohen origjinale ose të noterizuara. Dokumentat b, c, dhe d duhet të jenë të përkthyer për të gjithë shtetasit e huaj. Të gjitha këto dokumenta kanë vërtetësi nëse janë të vulosura me vulën Apostile, ose nga ambasada shqiptare me vulën shqiptare. Për të gjitha ato vende ku nuk përdoret kjo vulë marrëdhënia krijohet në rrugë ligjore ndërmjet ambasadave (IOM, 2010). IOM përmend SENJOD (Sektori i Njohjeve të Diplomave dhe të Bashkëpunimit Ndërkombëtar) si garantues institucional dhe si një nga rrugët ligjore më të rëndësishme në fushën e njohimit të diplomave. Pasi janë bërë të gjitha këto veprime, aplikanti merr një përgjigje nga SENJOD ndërmjet adresës: senjod@mash.gov.al. Sipas Ministrisë Arsimit dorëzimi i aplikimit duhet të dorëzohet gjithmonë në rrugë ligjore, e postuar nëpërmjet postës. Aktualisht ky format aplikim bëhet në formatin Pdf dhe ndiqet nëpërmjet aplikacioni E-Albania. Sipas të dhënave të publikuara nga gazeta shqiptarja.com proceduar për njohjen e diplomave kanë ndryshuar.

Aplikimi mund të kryhet vetën në formatin online dhe në rrugë shkresore. Në të dyja rastet aplikanti duhet të dorëzojë në rrugë postare në Ministrinë e Arsimit dokumentacionet, për njehësimin e çertifikatave dhe diplomave të marra nga jashtë. Të gjitha këto duhet të jenë në përputhje sipas kornizave, Kornizës Shqiptare të Kualifikimit (KSHK) dhe Kornizës

Europiane (KEK) të kalifikimit(me përjashtim të doktoraturave). Aplikimi duhet të përmbajë:

- Formularin e aplikimit të plotësuar personalisht (i cili shkarkohet nga faqja zyrtare e Ministrisë së Arsimit)
- Diplomën ose çertifikatën që tregon përfundimin e studimeve
- Listën e notave /suplementine diplomës
- Fotokopie e katës së indentitetit /pashaportës
- Mandat pagesën Hart-Copy (Portal, 2017)

➤ **Rajonalizimi i diplomave**

Krahas “*Ndërkombëtarizimit*” në kontekstin e globalizimit të Arsimit të Lartë jemi njohur edhe me të ashtuquajturin “*Rajonalizëm*“. Rajonalizmi është përcaktuar si një rezultat i ri i globalizmit dhe nënkupton rritjen e rëndësisë së rajoneve ekonomike, politike dhe arsimore. Ky proces ka sjellë krijimin e agjensive të përbashkëta midis rajoneve, si krijimi i tregjeve të punës, shoqata e tregëtisë së lirë si Këshilli Ekonomik Paqësor Atlantik ose Bashkimi Europian. Në procesin e Europianizmit ajo që ne duhet të kemi parasysh është që arsimi është bërë pjesë e kësaj ndarje që njihet me termin “*Rajonalizëm*”.Proçesi i Bolonjës është një *rajonalizëm* midis 38 shteteve që bashkërisht i njohin njëra-tjetrës të drejtën e njësimit të diplomimit.

3.3 Kuadri ligjor i Arsimit të Lartë si rregullator për kategorinë e studentëve migrantë

Misioni i Arsimit të Lartë nuk është vetëm edukimi por edhe zhvillimi nëpërmjet kualifikimit të shoqërisë. Qëllimi i Arsimit të Lartë në vendin tonë është ai të eci paralel me vendet e Bashkimit Europian. Rezulton se që nga viti 1999 përpjekjet për integrimin e

Shqipërisë në Bashkimin Europian kanë ecur paralelisht me përpjekjet për t'u bërë pjesë e Kartës së Bolonjës.

Në nëntor të vitit 2002 në Tiranë u zhvillua konferenca e Arsimit të Lartë në Shqipëri me tematikë: *“Reforma e Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe procesi i Bolonjës”*. Kjo konferencë u organizua nga MASH (emërtimi i sotëm MASR) dhe nga Këshilli i Europës. Punimet e konferencës u fokusuan në funksion të këtij procesi, duke dhënë rekomandimet dhe përfundimet përkatëse mbi mënyrën e funksionimit të kësaj reforme.

Duke ju përmbajtur kësaj reforme gati një vit më vonë Shqipëria do të vendoste si pikësynim aplikimin e Kartës së Bolonjës në universitetet shqiptare. Funksionimi i Kartës së Bolonjës u bë qëllimi parësor i Arsimit të Lartë në vend. Ministria e Arsimit parashtroi si ide bazë *“Nën sistemin arsimor do të ndodhin ndryshime, të cilat mund të përmbliidhen me kërkesat e deklaratës së Bolonjës, prirja e zhvillimit të Arsimit të Lartë është kahje europiane, ajo nuk mund të mbetet jashtë këtyre ndryshimeve”*. Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë në lidhje me platformën për diskutim *“Reformimi i Arsimit të Lartë”*, dha një këndvështrim të ri në lidhje me sistemin arsimor shqiptar.

Po në vitin 2003 Ministria e Arsimit raportonte se në vendin tonë prej vitit 2001 ka nisur forma e kreditimit të sistemit Arsimit të Lartë në vend, dhe ajo ishte në fazën e përpilimit të strukturave të kurrikulave në dy cikle studimore, duke u bazuar në përvojat më të mira europiane. Po në këtë kuadër pikërisht në vitin 2003 Ministria e Arsimit theksonte se tashmë po bënte një amandament në ligjin e Arsimit të Lartë për funksionin e sistemit të Bolonjës në vend. Në korrik të vitit 2003 sanksionohet me ligj: *“Studimet universitare organizohen në cikle studime”* (MASH, 2003). Në vitin 2003 do të hartohet edhe projekti i

ashtuquajtur *“Masterplani i Arsimit të Lartë”* (MASH, 2003) i cili u dha si projekt në të gjitha institucionet e Arsimit të Lartë.

Me VKM të vitit 2003 u vendos *“Për krijimin e sistemit të akreditimit të Arsimit të Lartë”* dhe u krijua Këshilli i Akreditimit dhe Agjensia e Akreditimit. Duke pasur parasysh procesin e akreditimit të Kartës së Bolonjës, Agjensia e Akreditimit ishte rregullatorja e garantimit të kritereve të dhëna nga procesi i Bolonjës. Agjensia e Akreditimit si një organ kolegjal, miraton kriteret e vlerësimit të programeve dhe institucionit(VKM, 2003).

Ligji Nr.9140 datë 28.7.2003: *“Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, Neni 10 tek i cili ndër të tjera përcakton se: *“Vlerësimi i shkollave të larta dhe akreditimi akademik, kryhen nga Agjensia e Akreditimit dhe nga Këshilli i Akreditimit”*. Duhet të theksojmë që Ministria e Arsimit, në këtë periudhë po kërkonte ndihmë nga vendet e Bashkimit European për monitorimin e aplikimit të procesit të Bolonjës në vend. (MASH, 2003)

Sipas detyrave të caktura nga Konferenca e Berlinit (Berlin, Conference, 2003) në Raportin Kombëtar të Arsimit 2004-2005, Ministria e Arsimit pohonte në atë kohë se: *“Janë krijuar të gjitha standartet dhe procedurat për vlerësimine brendshëm dhe të jashtëm”*. Sipas raportit të publikuar nga revista *National Report* e vitit 2004 ndër të tjera theksohej se: *“Shqipëria po merr të gjitha masat për të saksionuar me ligj të gjitha udhëzimet sipas procesit të Kartës së Bolonjës”* (Report, 2003).

Sipas të dhënave të vitit 2005 në përputhje me ndryshimet e ligjit 1999 me VKM Nr 761 data 2.12.2005 u realizua njohja e universiteteve jo publike. Në mbështetje të Nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1,12, e 13 të Ligjit 8461 datë 22.5.1999, për Arsimin e Lartë në

Republikën e Shqipërisë u vendos njohja e universiteve jo publike, të propozuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës si dhe nga Këshilli i Ministrave.

Shqipëria u bë pjesë e sistemit të Kartës së Bolonjës në vitin 2005 dhe kështu sistemi arsimor shqiptar shpалosi rrugën e lehtësimit të njohes së diplomave të fituara jashtë. Ky sistem ndër të tjera solli paraprakisht kërkesa dhe reforma të reja në Arsimin e Lartë. Kjo sfidë nuk përfshiu vetëm Shqipërinë por edhe vendet e Ballkanit Perëndimor në mënyrë që njehsimi i diplomave të ishte edhe më favorizues për të gjithë anëtarët e saj. Magna Carta thekson se: *"Universitetet e Europës duhet të vlerësojnë shkëmbimet dhe eksperiencat mes tyre"*. Aty theksohet se: *"midis universiteteve duhet të ketë shkëmbime eksperiencash dhe bashkëpunim projektesh. Këto inisiativa duhet të nxisin politika bashkëpunimi midis studentëve dhe të mundësojnë kontaktet mes tyre"* (Magna Carta Universitatum observatory, 1988).

Në ligjin e vitit 2007, Nr.9741 data 21.05.2007 *"Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë"*, Agjensia e Akreditimit tashmë ka ndryshuar dhe ka marrë emërtimin Agjensia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) e cila përfaqësohet si institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit duke mbikëqyrur edhe problematikat e brendshme mbi akreditimin e studimeve të studentëve përfshi edhe ata që janë kthyer nga jashtë. (MASH, 2007)

Duke u mbështetur tek APAAL në lidhje me zhvillimet e Arsimit të Lartë për vitet 2005-2007, rishikimi për politikat zhvilluese dhe integruese për Arsimin e Lartë janë zhvilluar në disa drejtime si në Institucionet e Arsimit të Lartë publik, në vlerësimet e stafëve akademike ashtu edhe në vlerësimet në fushat e mësuesisë.

Dokumenti i Strategjisë për Zhvillimin Universitar (2014-2020) trajton çështjet që kanë të bëjnë me cilësinë dhe arsimin gjithë përfshirës duke forcuar shërbimet mbështetëse në shkolla dhe në universitete, duke rintegruar studentët e kthyer në procesin e të mësuarit dhe duke u ofruar falas tekstet shkollore (Karameta, 2014).

Udhëzimi Nr. 9242 i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, datë 10.11.2015, *“Për regjistrimin dhe trajtimin e studentëve të kthyer”*, jep udhëzime për të gjitha drejtoritë dhe zyrat rajonale të arsimit në lidhje me studentët që kthehen nga migracioni dhe kërkojnë të regjistrohen në universitete (MAS, 2015). Ky dokument u bën thirrje këtyre drejtorive dhe zyrave që të marrin masa për pranimin dhe kthimin në universitete për studentët aplikantë, për të ngritur komisionet e pranimit në çdo sekretari dhe zyrë, për të përgatitur dëshmi të detajuara për pranimin e studentëve dhe për hartimin e planeve të ndërhyrjes nga ana e njësisë së shërbimit psiko-social.

Përveç kësaj ky udhëzim, udhëzon institucionet arsimore për të trajnuar studentët e regjistruar nëpërmjet planeve mësimore (akademike) për të kompensuar kreditet e humbura dhe për të fituar vitin akademik të lënë përgjysëm.

Të gjitha këto ligje të nëshkruara në lidhje me garantimin e kushteve dhe kritereve të vendosura nga BE përbënin një nga kushtet themelore të garantimit të një arsimi sipas Kartës së Bolonjës. Ndër të tjera, dokumenti i strategjisë parasheh që deri në vitin 2020 të gjitha universitetet do të kenë një shërbim psiko-social dhe pedagogët do të jenë të trajnuar dhe të aftë të punojnë me raste specifike.

Vala e fundit e migrimit shqiptar pas vitit 2013 përfshiu një numër të madh të individëve në moshë shkollimi. Është e mundshme që ata kanë braktisur shkollën (INSTAT, 2016). Ky fenomen ka pasur një mbulim të gjerë nga mediat elektronike dhe të shkruara të cilat i

referohen statistikave të Eurostat-it të siguruara nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë dhe nga të dhënat që vijnë nga Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR) dhe Zyrat e Arsimit (ZVA). Sidoqoftë, nuk ka të dhëna kombëtare për braktisjen e shkollës për azil. Ndërsa filloi procesi i kthimit të azilkërkuesve, në korrik 2015, integrimi i të rinjve në sistemin arsimor dhe programet mbështetëse në shkolla është një çështje shqetësuese që përballet me shumë sfida. Përcaktimi i Shqipërisë si një vend i sigurt i origjinës ka çuar në një rënie të fluksit të azilkërkuesve, siç po vazhdon procesi i riatdhesimit të tyre. Megjithatë, problemet me të cilat përballen të rinjtë duhet të adresohen siç duhet, me qëllim parandalimin e pasojave që mund të lindin si rezultat i mosmarrjes së masave të duhura.

Pavarësisht disa iniciativave të ndërmarra në këtë drejtim, universitetet po përballojnë sfidën e pranimit të studentëve në mungesë të udhëzimeve për hartimin e kurrikulave përkatëse për këtë grup të veçantë të synuar, dhe programe efektive të ri-integrimit psiko-social. Të rinjtë e kthyer, të cilët janë të papunë, të paarsimuar dhe/ose të pa trajnuar profesionalisht, mbeten kategoria më e përjashtuar dhe më e rrezikuar.

Ministritë përgjegjëse për çështjet e arsimit dhe migracionit kanë hartuar dokumente të politikave për ri-integrimin e migrantëve të kthyer.

Strategjia për ri-integrimin e qytetarëve shqiptarë të kthyer 2010-2015, e cila ende zbatohet si një dokument kyç i politikave kombëtare të Shqipërisë për migracionin, synon *“të sigurojë kthimin e qëndrueshëm të migrantëve nëpërmjet mbështetjes për procesin e ri-integrimit, pavarësisht nga forma e kthimit”*(IOM, 2010). Kjo strategji dhe plani i veprimit të saj fokusohet kryesisht në shtetasit shqiptarë të kthyer në Marrëveshjen e Ripranimit, Komisioni European-Shqipëri(Marrëveshja e Ripranimit) dhe marrëveshjet dypalëshe të ripranimit të nënshkruara midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera, ose përmes formave të

tjera të kthimit të detyruar. Një rishikim i strategjisë tregon se fokusi bie mbi migrantët e kthyer që nuk përmendin dhe/ose trajtojnë kategori të veçanta, si azilkërkuesit shqiptarë që kthehen në vendin e tyre të origjinës.

Në lidhje me ri-integrimin e qytetarëve shqiptarë, strategjia sugjeron bashkëpunimin me strukturat publike dhe shoqërinë civile për një integrim të plotë (kulturore, ekonomik dhe social) të një migranti në vendin e tij të origjinës. Ndër të tjera, plani i veprimit përcakton:

- Zgjerimi i fushëveprimit dhe i temave të trajtuara në seminarin vjetor të mësimeve, me qëllim të rritjes së aftësive të tyre në dritën e planit afatgjatë të ri-integrimit për personat e ripranuar;
- Të mbështesë ri-integrimin e studentëve shqiptarë të kthyer në sistemin e kujdesit shëndetësor, skemat e sigurimeve shëndetësore dhe mbrojtjen sociale përmes trajnimit të punonjësve socialë dhe sigurimin e shërbimit psikologjik për studentët e kthyer;
- Të mbështesë ri-integrimin e studentëve shqiptarë të kthyer në sistemin e përgjithshëm të arsimit dhe formimit profesional duke ofruar informacione dhe shërbime sociale;
- Të mbështesë ri-integrimin e studentëve shqiptarë të kthyer nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile me qëllim të krijimit të një baze të dhënash për monitorimin e shtetasve shqiptarë të kthyer në sportelet e migracionit.

Fokusi i këtij kërkimi është impakti që institucionet e Arsimit të Lartë do t'ju ofronin migrantëve që kërkojnë të vazhdojnë arsimin në Shqipëri. Në raportin që Ministria e Arsimit jep mbi numrin e këtyre migrantëve që janë në statusin e studentit, deklaron se

është një numër relativisht i madh. Sipas Ministrisë së Arsimit numri i studentëve të rikthyer është diku rreth 1000 studentë. Këta studentë migrantë duan të jenë pjesë e universiteteve shqiptare. Procesi i Arsimit të Lartë në vendin tonë, funksionon sipas një modelit të sistemit të Kartës së Bolonjës.

Sipas të dhënave të projekt draftit të qeverisë shqiptare për Strategjinë e Arsimit të Lartë për vitet 2010-2020 ndër të tjera thuhet se: *“Institucionet e Arsimit të Lartë janë vendimtarë për të ardhmen e vendit, ato sigurojnë burime njerzore dhe njerëzit e kualifikuar dhe janë promotorë të rritjes ekonomike në vend dhe në zhvillimin e shoqërisë. Qeveria është e vendosur që institucionet arsimore në vend t’iu përgjigjen nevojave ekonomike dhe sociale”* (European Commission, 2010). Duke parashikur këto projekt-strategji Arsimi i Lartë është udhëzuar që të eci në të njëjtin projekt me atë europian. Ky arsim duhet të plotësojë të njëjtat kushte të kërkuara nga Komisioni Europian për projektin e Europës së vitit 2020. Në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014-2020 theksohen këto prioritetet. Ndër të tjera theksi vihet tek rishikimi i kompetencave për kualifikimin ku thuhet se: *“Objekti kryesor i kësaj strategjie është identifikimi dhe skicimi i objektivave të duhura nxitëse, të punësimit në vend dhe të formimit profesional të forcës së punës, me qëllim që të hapen punë cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës”* (EASO, 2013). Strategjia ka në qendër të saj rritjen e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave të duhura nxitëse, të punësimit në vend dhe të formimit profesional të forcës së punës, në mënyrë që të hapen vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës, nëpërmjet politikave efektive të tregut të punës, ofrimit të arsimit dhe të formimit profesional cilësor për të rinjtë.

Në përputhje me vizionin që ka qeveria shqiptare ajo ka ndërmarë hapa për formimin profesional dhe kualifikimit më tej të të rinjve. Të gjitha këto plane dhe synime të qeverisë shqiptare janë pjesë e planit të strategjive europiane (European Commission, 2010). E parë në këtë kuadër në të gjitha kjo çështje e Arsimit të Lartë për të europianizuar sistemin arsimor ishte një nga përpjekjet më të mira që ka bërë qeveria shqiptare ndër vitet e fundit. Shqetësimi kryesor përkon pikërisht me migrantët nga mosha 18-24 vjeç të cilët për arsye kryesisht familjare janë detyruar të kthehen në vendin e tyre. Edhe pse politikat në mbarë botën për programet e përshtatjes dhe integritit janë në hapat e duhur në Shqipëri ende këto institucione shihen të kenë mungesë profesionalizmi duke marrë gjithashtu parasysh zyrat e këshillimit nëpër institucione. Në kontekstin botëror politikat si dhe programet e përshtatjes për migrantët dhe rintegrimin e tyre janë të shumta. Në vendin tonë vihet re një mungesë në profesionalizimin e institucioneve, duke marrë parasysh dhe faktin që prania e tyre është vënë re në vetëm dhjetë vitet e fundit. Në vendin tonë aktualisht numërohen rreth 36 sportele që merren me problemet e migrantëve të kthyer, megjithatë nuk shihet akoma ekzistenca e një qendre këshillimi për studentët migrantë. Duke qënë se universitetet shqiptare janë akoma në fazën eksperimentuese dhe të mbledhjes së të dhënave në lidhje me studentët e kthyer nga migracioni, shifrat nuk janë ende të sakta. Institucione të tilla ende nuk janë të gatshme sa duhet për t'u marrë më çështje të tilla. Këto institucione ende nuk kanë një zyrë të veçantë të këshillit të karrierës për këtë kategori studentësh. Studentët migrantë kanë dëshirë të vazhdojnë studimet e ndërprera. Duke parë që edhe Shqipëria është pjesë e kësaj aspirote mbi Arsimin e Lartë, ministritë përgjegjëse kanë rënë dakord mbi mundësinë për të krijuar kushte të barabarta, për kategorinë e të rinjve të kthyer nga migracioni.

KAPITULLI IV

METODOLOGJIA

4.1. Metodat e përdorura

Në lidhje me metodologjitë e punimit janë përdorur metoda cilësore dhe sasiore.

➤ Metoda cilësore

Metoda cilësore përdoret gjerësisht në hulumtimet e shkencave sociale për të shpjeguar kuptimin e fenomeneve. Këto fenomene përfshijnë veprime, besime, vendime, vlera etj. Metoda cilësore është një nga qasjet më natyrale dhe më funksionale për studiuesit. Bryman në librin e tij *“Social Research Methods”* shkruan se: *“mënyra me të cilën njerëzit studjojnë, kuptojnë dhe interpretojnë realitetin e tyre social është një nga motivet qendrore të hulumtimit cilësor”* (Bryman, 2008). Aspekt kyç i hulumtimit cilësor është edhe shpjegimi i fenomeneve duke mbledhur të dhëna empirike në fushën e kërkimore dhe duke i përpunuar ato në cilësinë e informacionit (Strauss, A & Corbin, J. M., 1990). Këto hulumtime përcaktojnë një hulumtim cilësor *“si çdo hulumtim që nuk bazohet në numërimin dhe sasinë e materialit empirik. Për ta hulumtimi cilësor është çdo lloj hulumtimi që prodhon gjetje që nuk vijnë nga procedurat statistikore apo mjete të tjera të përcaktimit të sasisë”* (Dabbs Jr, 1982). Dabbs nga ana tjetër përpiqet të dallojë metodën cilësore nga ajo sasiore. Ai tregon se nocioni i cilësisë është një nga aspektet më të rëndësishme të hulumtimit cilësor. Metoda cilësore i'u përgjigjet pyetjeve: kur, pse, çfarë dhe ku?.

Sipas Berg hulumtimi cilësor i referohet kuptimit, koncepteve, simboleve, përkufizimeve, karakteristikave, metaforave dhe përshkrimit të gjërave, ndërsa kërkimi sasior i referohet

numrave dhe masave të gjërave dhe reflekton në një mënyrë matematikore ose statistikore (Berg, 2001). Hulumtimi cilësor përdoret si mjet kuptim plotë interaktiv për të kuptuar gjërat thellësisht dhe jo vetëm të shprehur me numra. Në rastin e studentëve shqiptarë të kthyer nga migracioni është e rëndësishme përdorimi i metodës cilësore pasi kjo metodë na ndihmon në shtrirjen e informacionit. Këto metoda janë përdorur edhe më parë në fusha studimi si sociologjia dhe antropologjia sociale të cilat e ndihmojnë studiuesin në përthithjen e informacionit dhe përpunimin e rezultateve.

Mënyra sesi janë hartuar pyetësorët e këtij studimi përfaqëson më shumë me metodën cilësore. Në rastin e studimit mbi migracionin duke ju referuar edhe modeleve të mëparshme kjo metodë është efiçente pasi grumbullon të dhëna specifike. Metoda cilësore në rastin e studimit mbi migracionin jep informacione më preçize në përcaktimin e kampionit dhe e lehtëson së tepërmi studiuesin në përpunimin e të dhënave. Autorë si Cassarino, King, Christou, Vathi etj, kanë përdorur këtë metodë e cila ngjason me modelin e studimit të marrë në shqyrtim. Metoda cilësore ndihmon në hartimin e pyetësorëve duke e bërë informacionin edhe më të zgjeruar.

Në këtë studim janë përdorur *intervistat gjysëm të strukturuar* për grumbullimin e informacionit në universitete dhe zyrat e këshillimit të karrierës.

➤ **Metoda sasiore**

Metoda sasiore përqëndrohet në të dhënat numerike ose matematikore dhe tregon se nocioni i sasisë lidhet drejtpërdrejt me shifrat (Berg, 2001). Një hulumtim sasior është në thelb grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave numerike për të shpjeguar një fenomen të veçantë ose pyetjen specifike duke përdorur metoda sasiore. Tek studimi në fjalëmbi studentët që janë kthyer nga migracioni përdorimi i kësaj metode është i nevojshëm pasi kjo

metodëna siguron një informacion të bollshëm dhe të domosdoshëm. Duke qënë se në këtë studim shkencor jemi përpjekur të japim raporte numerike përfshirja e metodës sasiore ishte e domosdoshme. Pjesa më e kufizuar e metodës së hulumtimit sasior është se të dhënat shfaqen gjithmonë në një formë numerike, të cilat mund të analizojnë vetëm në mënyrë statistikore dhe të interpretohen vetëm në numra. Kjo metodë nuk jep shumë sqarime në hulumtimet e shkencave sociale, të cilat synojnë të eksplorojnë emocionet dhe besimet në fushën e veçantë të hulumtimit. Qëndrimi sasior njihet gjithmonë si qëndrim realist dhe pozitivist, ndërsa metoda cilësore është subjektive dhe interpretuese. Metodatat sasiore sipas realistëve kanë si objekt kërkimor realitetin ekzistues ose të vërtetën. Në rastin konkret studimor përdorimi i metodës sasiore për të matur ri-integrimin e të rinjve në institucionet arsimore shqiptare, na jep një panoramë më të qartë të studimit.

Pyetësorët si një instrument i matjes janë tregues i testimit të teorive mbi të cilat studimi mund të pranohet ose refuzohet (Berg, 2001). Modeli i metodës sasiore është dikuar nga autorë të cilët kanë bërë studime të ngjashme si Dervishi, Bajraba, Cassarino, King, Datta, Vathi etj. Sigurisht që qasjet sociologjike të metodologjisë mbi migracionin i kemi marrë kryesisht nga Cassarino i cili është edhe baba i sociologjisë së emigracionit.

4.2.Triangulimi metodologjik

Triangulimi metodologjik është një instrument matës i cili na jep rezultate ndërmjet tre metodave. Kjo metodë ka qënë shumë e përdorur nga autorë si Alan Bryman dhe Veronica Thurmond. Metoda e triangulimit metodologjiki referohet një kombinimi të metodave cilësore, sasiore ose metodave cilësore dhe sasiore së bashku (Thurmond, 2001; Mikkelsen, 2005).

Sipas Thurmond kjo metodë ka përparësinë e “*ekspozimit të dallimeve unike ose informacioneve kuptim plotë që mund të kenë mbetur të pazbuluara mepërdorimin e vetëm një qasjeje*”(Thurmond, 2001, p. 255). Ky studim ka kombinuar metoda të ndryshme të mbledhjes së të dhënave cilësore të cilat janë përshkruar si lloji i metodës së brendshme të triangulimit metodologjik (Mikkelsen, 2005). Studime si ai i Anderson përdorin intervistën gjysmë të strukturuar (si intervista që janë marrë model tek insitucionet në lidhje me ri-integrimin e migranëve) duke mbajtur shënime në terren të bisedave joformale nga burimet sekondare(Anderson, 1997). Avantazhi i përdorimit të këtij lloji triangulacioni është se ai ndihmon në “*vlerësimin e interpretimeve të gjetjeve, sepse vëzhgimet përforcuan të dhënat e marra nga intervistat*”(Thurmond, 2001, p. 254).

Ky lloji trekëndëzimi paraqet sfidat e veta. Një sfidë e madhe mund të jetë mungesa e eksperiencës në përdorimin e një metode të tillë. Thurmondi e përshkruan këtë metodë si një metodë relativisht e re dhe ‘*e modës*’, nga e cila janë tërhequr shumë hulumtues. Kjo metodë gjithashtu tregon se dallimet epistemologjike mund të shkaktojnë konflikt në lidhje me dizajnin e hulumtimit sidomos kur metodat cilësore dhe sasiore janë të kombinuara (Thurmond, 2001).

Përkundrajt këtyre vështirësive të mundshme, triangulimi bën një qasje më rigoroze në hulumtimin e shkencave sociale dhe mund të jetë shumë e dobishme për çdo studim. Shumë punime empirike që janë kryer në fusha të ndryshme në shkencat shoqërore kanë argumentuar se përdorimi i kombinuar i metodave cilësore dhe sasiore kanë sjellë rezultate më të plotanë studime. Këta shembuj konfirmojnë avantazhin e triangulimit metodologjik duke siguruar vlefshmëri dhe besueshmëri në çdo studim kërkimor.

Trianguliteti metodologjik i vjen në ndihmë studimit në fjalë pasi na ndihmon të jemi edhe

më të saktë. Trianguliteti metodologjik në rastin e studimeve të migracionit mat korrelacionin midis variablave dhe na ndihmon në vërtetimin e hipotezës. Sigurisht kjo risi e triangulacionit do ta bënte edhe më efikase dhe më të besueshëm hulumtimin shkencor. Ndërthurja e metodës cilësore me atë sasiore në kërkimin shkencor mbi studentët e kthyer nga migracioni, si dhe kombinimi i të dhënave të fituara nga zyrat e këshillimit të karrierës na bën më të besueshëm hulumtimin.

Përkrahësit e triangulacionit argumentojnë se përdorimi i triangulacionit edhe brenda një strategjie kërkimore (sasiore ose cilësore) është e dobishme, pasi ajo është e ndryshme duke qënë se pikat e forta dhe dobësia e secilës teknike plotësojnë njëra-tjetrën. Nga një këndvështrim sociologjik, mund të thuhet që triangulat qëndrojnë midis traditave të ndërtimeve, empirizmit dhe realizmit (Olsen, 2004, p. 12).

Sipas Olsen, (Olsen, 2004) dhe Bryman, (Bryman, 2008), triangulimi u bë më popullor me punën e (Webb, Campbell, Schwartz, & Sechrest, 1966). Kjo metodë e cila u bë edhe më e rafinuar me (Denzin & (Eds), 1970) duke zgjeruar idenë për metodat kërkimore.

Thurmond përshkruan katër forma të triangulimit.

1. *Triangulimi i të dhënave*: përfshin mbledhjen e të dhënave përmes disa strategjive të kampionit si dhe mbledhjen e të dhënave në kohë të ndryshme.
2. *Triangulimi i hetuesit*: i referohet përdorimit të më shumë se një hulumtuesi në terren për të mbledhur dhe interpretuar të dhënat.
3. *Triangulimi teorik*: i referohet përdorimit të më shumë se një pozicioni teorik në interpretimin e të dhënave.
4. *Triangulimi metodologjik*: i referohet përdorimit të më shumë se një metode për grumbullimin e të dhënave (Thurmond, 2001).

Në rastin e studimit të marrë në shqyrtim është përdorur më së shumti forma e triangulimit metodologjik. Duke qënë se kërkimi shkencor në lidhje me migracionin kërkonte një kombinim të veçantë metodologjik, metodologjia e triangulimit i përshtatet më shumë fushës kërkimore, sepse edhe grumbullimi i informacionit është më i gjerë. Ndëpërmjet metodës triangulare arrihet të maten të dhëna cilësore dhe sasiore. Metoda triangulare bën ballafaqimin midis përgjigjeve të dhëna nga intervistuesit dhe jep rezultatet e hipotezave. Sigurisht rasti i triangulimit metodologjik është më efektiv në nxjerrin dhe interpretimin e rezultateve. Kjo metodë e kombinuar midis asaj sasiore dhe cilësore e rrit besueshmërinë e studimit dhe vërteton më së miri hipotezën e ngritur.

4.3 Analiza statistikore e të dhënave sasiore

Të gjitha të dhënat që ne përfuam nga studimi u analizuan edhe përmes paketës statistikore që njihet me termin (SPSS). Analiza korrelacionale, na jep të dhënat e dala nga pyetësi në lidhje me ri-integrimin e studentëve në universitete. Për të testuar qëndrueshmërinë e brendshme të instrumentave u përdor alfa i Cronbach. Të dhënat primare u paraqitën në tabela dhe grafikë përmes analizave përshkuese (mesatare, devijim standard, minimum, maksimum dhe frekuenca). Në këtë seksion u përfshinë të dhënat demografike, totali për secilën grafik dhe karakteristikat bazë të tyre. Për vlerësimin e rezultateve të të gjitha testeve statistikore është vendosur niveli i domethënies statistikore 0,5. Të dhënat janë shqyrtuar për shpërndarjen normale. Kështu, në rastet, kur shpërndarja është normale, testet që përdoren për analiza të mëtejshme janë ato parametrike, përkatësisht T-test dhe ANOVA. Ndërkohë nëse të dhënat nuk kanë shpërndarje normale, përdoren testet joparametrike (Whitney & Wallis, 2000). Testet, T-test dhe ANOVA na i testojnë më qartë

qartë hipotezat e ngritura.

4.4 Modeli Ekonometrik i analizës së të dhënave cilësore.

Për të analizuar të dhënat e metodës cilësore ne kemi mbledhur të dhënat e analizave statistikore nëpërmjet të dhënave të SPSS 20 dhe Exel 2010. Pasi është bërë grumbullimi i përgjithshëm i të dhënave janë hedhur në sistem duke u kategorizuar. Nëpërmjet kësaj analize janë bërë edhe analizat e frekuencës mbi pyetjet e para dhe më tej është bërë analiza e tyre në mënyrë të detajuar. Natyrisht për të vërtetuar këto variabla u realizua edhe analiza bivariable e (Cassarino, 2004) dhe (Duvall, 2014). Duke u bazuar në këtë model i jemi përmbajtur kësaj formule: Formula $r=r(XY)$ ku vlera e korrelacionit r -ja në vetvete merr vlerën e segmentit $-1 \leq r \leq 1$. Nëpërmjet kësaj formule kontrolluam të dhënat ekonometrike dhe vetë regresionin linear.

Analiza e të dhënave cilësore është bërë duke u mbështetur në modelin e (Cassarino, 2004). Cassarino e ka përdorur këtë metodë në studime të ngjashme mbi fushën e migracionit. Për të bërë interpretimin e të dhënave cilësore, këto të dhëna janë ndarë në *sesione të ndryshme* dhe në *skedarë të ndryshëm*.

Skedarët ndahen në dy kategori:

a) në skedarë të marrë në shkrim nga vetë studiuesi

b) si dhe në skedarë të regjistruar në email.

Më tej është hartuar edhe një listë më vete e termave që duhen përpunuar. Duke dashur që shpjegimet mbi analizën e të dhënave të jenë më të qarta, janë bërë edhe *skematizime* dhe *indeksime të temave që identifikojnë* çdo pyetje dhe në specifikën që ajo trajton. Marrim këtu disa shembuj fjala vjen pyetjet rreth informacionit demografik, apo pyetjet rreth

informacionit mbi ri-integrimin e studentëve migrantë në universitet tona, apo pyetje; sa të përfaqësuar ndjehen studentët në këto institucione?. Siç edhe shihen në krahun e djathtë të pyetësorit një kategori pyetjesh kanë kodime të veçanta të tipit *RKL (Ri-integrimi në kuadrin ligjor)* apo edhe indeksim të tipit *REA (Ri-integrimi në etikën e arsimit)*. Sipas mënyrës së(Cassarino, 2004) këto kodime kanë funksione ndihmëse për të mbledhur më tepër numrat dhe shifrat. Për hedhjen e të dhënave është shumë e rëndësishme edhe vetë krijimi i tabelave dhe grafikëve dy dimensionale (Lee, 1966). Duke qënë se modeli ekonometrik ndihon në të përfitim të të dhënave cilësore u pa e udhës që modeli i skedimeve të veçanta do të ndihmonte nëmbledhjen e informacionit në mënyrë më të shpejtuar. Modelli i i përshtatur nga Cassarino dhe Devull në lidhje me këto tematika ndihmon në analizimin e të dhënave në mënyrë matematikore. Kodifikimi dhe indeksimi i të dhënave duke ju përqasur këtij modeli i jep më shumë rëndësi metodologjive të përdorura pasi e bën më efikas studimin.

4.5 Instrumentët matës të metodologjisë

Instrumentet matës të përdorur në këtë studim janë dy: *intervista gjysëm të strukturara* dhe *pyetësorët*. *Pyetësorët* janë ndërtuar në të njëjtën mënyrë për të gjitha kategoritë, që të gjitha pyetjet janë të strukturuar, intervistuesit i është kërkuar të japi një përgjigje e drejtpërdrejtë, në mënyrë që rezultatet të përfitohen sa më shpejt dhe informacioni të jetë sa më i plotë. Ndërsa tek *pjesa e intervistave gjysëm të strukturuara* pyetjet janë lënë më të hapura duke patur parasysh elementët kyçetë tematikës së punimit. Tek pyetësorët gjysëm të strukturuara biseda është zhvilluar në lirëshmëri të plotë për intervistuesin. Model i hartimit të pyetësorit është përshtatur me modelin e Kassarinos (Cassarino, 2004) mbi fenomenin e

migracionit. Hartimi i *pyetësorëve* dhe *intervistave* ka qënë testuar edhe më parë nga modeli i Cassarino mbi migracionin çka e bën edhe më të besueshëm impaktin që do të sjelli mbistudimin në fjalë. Testimi i pyetësorit nga ana jonë është bërë ndërmjet instrumentave të ngjashëm të përdorur nga (Cassarino, 2004)& (Duvall, 2014). I njëjti format pyetësori i është referuar gjithashtu edhe autorë si Christou & King mbi ri-integrimin e të rinjëve grek nga Gjermania në Greqi (Christou & King, 2006), çka e bën edhe më të besueshëm instrumentin matës.

1- ***Pyetësorët***

Pyetësorët u përdorën përpjesën e studentëve. Tek pjesa e pyetësorëve janë bërë të njëjtat pyetje për të gjithë studentët. *Pyetësorët* janë ndara secila në 6 (*gjashtë*) sesione. Studentëve ju është dhënë liri e plotë nëse ata nuk duan ti përgjigjen ndonjëres nga pyetjet.

Për të matur pyetësorët janë përdorur *dy teste kampione* të emërtuara si *teste pilot*. Me testin e paracaktuar për të arritur qëllimin e studimit, jemi munduar të përcaktojmë sa më mirë termat, fjalët kyçe dhe procedurën e përgjigjeve në mënyrë që nga ana e intervistuesit të përfitojmë një përgjigje sa më efikase në lidhje me studimin.

Koha në të cilën janë bërë intervistat, ballë për ballë, ka zgjatur rreth 2 vite nga periudha nëntor 2015 deri në maj 2017. Kjo periudhë ka qënë e favorshme sepse ka qënë brenda periudhës së dy viteve akademike. Kohëzgjatja e intervistave varion nga 20 deri në 40 minuta në varësi të studentëve.

Në studim janë marrë 200 studentë të kthyer nga emigracioni në vitet e fundit. Studentët në periudhën e intervistimit ishin akoma në rolin e studentit. Pothuajse të gjithë studentët e kthyer nga emigracioni ju përgjigjen pozitivisht intervistës dhe e kanë pritur me shumë pozitivitet këtë insiativë. Vetëm 7 prej tyre refuzuan të intervistohen pasi nuk panë një

interes në studim. Sipas këtyre studentëve tematika e studimit nuk do të kishte asnjë impakt në përmirësimin e sistemit arsimor dhe ata menduan se ky do të ishte një studim i cili do ti shërbente vetëm studiuesit për interesat e tij akademike.

Nga grupi i studentëve që pranuan të intervistohen rreth 60 studentë u intervistuan nëpërmjet thirrjes online në faqet zyrtare të universiteteve të tyre. Ky grup studentësh i'u përkiste universiteteve të Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Korçës, Elbasanit etj. Ndërsa pjesa tjetër është intervistuar duke shkuar dhe kontaktuar me ta në auditoret e universiteteve. Aty na u desh të shpjegonim arsyet e studimit si dhe ju garantuam ruajen e anonimatit si dhe të dhënave kofidencile të tyre. Gjithashtu na u desh të shpjegonim edhe interesin e temës dhe rëndësinë e saj.

Përpjekja jonë ishte që të arrinim numrin e studentëve që justifikonin studimin në raport me numrin e grupit të përfaqësimit në total. Për këtë arsye menduam që studimi të shtrihej në rang kombëtar. Kjo shtrirje na dha mundësinë të lidhim kontakte me shumë pedagogë dhe zyrat e karrierës së universiteteve ndonëse këto të fundit të pakta.

Në këtë pyetësor kemi të përdorur një instrument matës të quatur **CAPI-T** (intervistim personal të bërë me anën e kompjuterit). Këtë lloj instrumenti matës e përdorin studiuesit kryesisht për të reduktuar kohën dhe për të qënë sa më e saktë në përgjigje. Pyetjet kanë qenë të tipit mbyllës po/jo, të strukturuar. Të gjitha të dhënat e nxjerra në **CAPI-T** janë të paraqitur në mënyrë grafike dhe në shpjegime out-put-i dhe në shpjegime e termave të tjerë specifik që lidhen me ri-integrimin dhe adoptimin e studentëve në institucionet përkatëse e shprehur në shifra dhe në numra sipas funksionit të të dhënave.

2- Intervistat e gjysëm të strukturuar-semi struktura.

Intervista mund të jetë e strukturuar ose jo e strukturuar ose gjysëm e strukturuar. Në rastin

konkret, është përdorur intervista e gjysëm e strukturuar. Është përdorur kjo intervistë pasi është bazuar në literaturë shkencore duke përfshirë shumë pyetje të hapura por edhe pyetje të mbyllura. Për më tepër, përcaktimi i llojit të intervistës është një nga ndihmesat kryesore të grumbullimit të të dhënave. Intervistat e përdorura në hulumtime të tilla e bëjnë më fleksibël dhe dinamik studimin. Intervista gjysëm-strukturë nuk ka një përpikmëri si intervistat e drejtpërdrejta, pasi tek këto i intervistuari duhet të ndjehet më i lirë në mënyrë që të përftojmë sa më shumë informacione të detajuara.

Metoda e intervistës gjysëm të strukturuar jo domosdoshmërisht duhet të ndjekë dhe duhet të ketë përgjigjet e të gjitha pyetjeve. Për intervistat gjysëm të strukturuar, intervista zakonisht bëhet ballë për ballë, por mund të bëhet edhe përmes internetit (media sociale si skype, viber, google forum online, email etj) ose me telefon. Takimet ballë për ballë i ndihmojnë kërkuesit dhe të intervistuarit të kuptojnë rëndësinë e studimit duke shprehur përvojën dhe eksperiencën e tyre mbi situatën (Taylor & Bogdan, 1984). Ritchie & Leëis theksojnë se avantazhi i intervistës ballë për ballë nxjerr në pah problematikat që has i intervistuari dhe intervistuesi. Intervistuesi arrin të kuptojë nëpërmjet mënyrës së të shprehurit akoma më qartë të intervistuarin (Ritchie & Lewis, 2003). Pra, mund të thuhet se studiuesi preferon intervistën ballë për ballë për të eksploruar rëndësinë e kontekstit të ngjarjeve dhe problemeve. Për këtë hulumtim, u pa si më e përshtatshme metoda e intervistës ballë për ballë.

Studiues si Hammersley theksojnë në hulumtimet e shkencave shoqërore rëndësi ka edhe mënyra e të shprehurit gjuhësor. Ai thekson se: *“Fuqia shprehëse e gjuhës siguron burimin më të rëndësishëm të të dhënave. Tipari kryesor i gjuhës është aftësia e saj për të paraqitur përshkrimet, shpjegimet dhe vlerësimet e shumëllojshmërisë pothuajse të pafundme për çdo*

aspekt të botës, duke përfshirë edhe veten e tij.” (Hammersley & Atkinson, 1995). Kjo formë e intervistës do të na ndihmonte më tepër për pjesën e intervistave gjysëm të strukturuar. Kjo intervistë është e duhura për kërkimin shkencor në fushën e migracionit. Intervista të tilla i japin mundësi të intervistaurit të shprehe eksperiencat e fituara, si edhe të jetë protagonist i drejtpërdrejt në studim. Tek intervistat gjysëm të strukturara grumbullimi i informacionit është specifik dhe i veçantë pasi i intervistuari është lënë i lirë të shpreh opinionin e tij për problematikat e studimit. Tek këto lloj intervistash i intervistuari mund të na sjelli edhe sygjerime ose informacione të cilat mund të na zgjerojnë terrenin e studimit në të ardhmen. Kjo formë interviste është më e përshtatshme për tema me karakter social pasi nuk e kushtëzon studiuesin të japë përgjigje të mbyllura mohuese/pohuese (thjesht po ose jo).

Kjo lloj interviste për kërkime shkencore zakonisht përkufizohet thjesht si bisedë me qëllim për të mbledhur informacionin për një fushë të caktuar të hulumtimit. Intervista dhe eksplorimi i të dhënave është një moment i caktuar i hulumtimeve cilësore me anë të cilave studiuesit mund të kuptojnë fushën e studimit. Intervistat gjysmë të strukturuar shpesh janë burimi i vetëm i të dhënave për një hulumtim cilësor. Ato zakonisht janë të organizuara rreth një tematike dhe një sërë pyetjesh të paracaktuara që më parë nga ana e kërkuesit shkencor. Në këto raste lihen pyetjet hapura, ndërkohë që gjatë intervistës dalin edhe pyetje të tjera nga dialogu ndërmjet intervistuesit dhe të intervistuarit. Është tipari më i zakonshëm që kryerja e një interviste të thelluar gjysmë-strukture do të zgjasë 30 minuta deri disa orë për ta përfunduar atë intervistë. E gjitha kjo varet edhe nga aftësia që ka intervistuesi për të menaxhuar intervistën.

Ekzistojnë disa avantazhe dhe përfitime nga këto lloje intervistash. Sociologë që kanë bërë

intervista të këtij formati i japin rëndësi kësajforme të intervistës për shkak të informacionit që ajo na servir. Sipas Barriball na rreshton disa përparësi të përdorimit të intervistës gjysmë të strukturuar (Barriball & While, 1994).

- Kjo lloj interviste është e përshtatshme për eksplorimin e qëndrimeve, vlerave, besimeve dhe motiveve.
- Intervistat gjysmë të strukturara ofrojnë mundësinë për të vlerësuar vlefshmërinë e përgjigjeve të të anketuarit, duke vëzhguar edhe sjelljen joverbale, e cila është veçanërisht e dobishme kur diskutojmë çështje të ndjeshme në fushat kërkimore siç është edhe rasti i fenomenit të migracionit.
- Intervistuesi merr përgjigje që nuk i ka marrë nga askush tjetër më parë dhe kështu grumbullon informacione që nuk i kishte marrë dot në rrugë të tjera.
- Disavantazhi i intervistës gjysmë të strukturuar është se studiuesi nuk mund të intervistojë një të anketuar më shumë se një herë. Në këtë rast intervistuesi duhet të jetë shumë i qartë dhe kërkues në atë se çfarë synon.

Duke qënë se statistikën e migracionit të kthimit janë gati jo-ekzistente në Shqipëri, gjithashtu ne disponojmë pak të dhëna ku përmenden çështjet mbi migrantët e kthyer në Shqipëri. Zgjedhja e intervistës *gjysmë të strukturuar* për këtë hulumtim është bërë pikërisht për të kuptuar se si disa metoda janë më të përshtatshme dhe shpesh me kosto më të ulët, këto metoda mund të kontribuojnë ndjeshëm në realizimin e studimit.

Për vetë nga natyra migracioni i kthimit është fenomen kompleks për problematikat sociale. Grupi i studentëve, është një grup social i rëndësishëm. Ri-integrimi i tyre në universitetet shqiptare publike dhe jo-publike kishte nevojë për një metodë e cila mund të na ndihmojë në mbledhjen e të dhënave shkencore në një kontekst specifik dhe të strukturuar. Shumë

studiues të migracionit u mbështetën në metodën *gjysmë të strukturuar cilësore* të intervistës për të marrë njohuri të thella të përvojës së jetës (Gold & Nawyn, 2013). Prandaj edhe në rastin e këtij studimi përzgjedhja e kësaj interviste do të ishte me vend.

Metoda e *intervistës gjysmë të strukturuar* përdoret gjerësisht në hulumtimin e migracionit ndërkombëtar dhe kjo bëhet për të kuptuar fenomenet shoqërore, historike, politike në të cilat është gjendur migranti. Fenomeni social i migrimit si një faktor me ndikim të jashtëm në rastin e migrantit shihet në faktor në zhvillimin e shoqërisë. Në hulumtimin e migracionit, kjo metodë e përdorur për grumbullimin e të dhënave nga autorë si (Allen, Rubin & Earl R. Babbie, 2008). Sipas tyre kërkimi përcaktohet si një bashkëveprim komunikues midis hulumtuesit dhe pjesëmarrësit me qëllim të *“marrjes së interpretimeve të intervistuarve për përvojat dhe të kuptuarit e botës në të cilën ata jetojnë dhe studiojnë”*.

Avantazhi i zgjedhjes së kësaj metode në studimet e migracionit është:

- a) mundësia për të vënë të gjitha objektet në një platformë strukturore informacionet që u mbledhën nga procesi i intervistës, si gjurmët joverbale, shprehjet e fytyrës, gjestet e trupit, veshja e të intervistuarit dhe kontekste të tjera kulturore.
- b) Kjo metodë i mundëson një kërkuesi të kuptojë arsyet e kthimit të një migranti dhe të ilustrojë faktorët të influencuan në vendimin për tu kthyer.
- c) Kjo metodë i jep mundësi hulumtuesit të jetë në kontakt të drejtpërdrejtë me palën e interesuar.
- d) Kjo metodë i jep mundësi studiuesit të kursejë kohë sepse informacioni i përfituar është më i shpejtë.

Për të përgatitur strukturën e pyetësorit është bërë një ndarje në 6 (*gjashtë*) sesione.

Në sesionin e parë, u ndërtuan pyetjet me karakter demografik si mosha, puna, cikli i studimeve dhe kohëzgjatja në emigracion.

Në sesionin e dytë u ndërtuan pyetjet që synojnë sjelljen e informacioneve që janë të domosdoshme në studim si: sa ndjehen komodë në universitet shqiptare dhe vështirësitë që hasin në universitet? Sa realisht ata janë pjesë e aktiviteve shkollore? A kanë qënë të ftuar drejtpërdrejtë të jenë pjesë e aktiviteve shkollore? Nëse kanë qënë pjesë e qeverisë studentore? Nëse kanë qënë pjesë e forumeve apo klubeve studentore?etj.

Në sesionin e tretë të pyetësorit ne jemi marrë me njohjen e të drejtave të studentëve, duke i pyetur ata sesa të përfshirë ndjehen në këto institucione dhe se cilat janë liritë dhe të drejtat e tyre?. Në këtë pyetësor janë bërë edhe pyetje mohuese për të parë nëse studentët do ti ri-mohonin ose dotipohonin. Sipas sociologëve në këtë rast studentit kur i bëhet një pyetje mohuese e kundërshton në mënyrë kategorike ose e pohon në mënyrë kategorike. Pyetjet janë të tipit: A jeni ndjerë të detyruar të merrni pjesë në aktivitete të ndryshme? A jeni ndjerë të detyruar të ndiqni çdo leksion edhe pse ai është fakultativ (liri zgjedhje për të qënë ose jo i pranishëm)?. Jeni detyruar të merrni pjesë në aktivitete të cilat i përkasin profilit të cilit studioni? Jeni të detyruar t'i përgjigjeni pedagogut pa dëshirën tuaj? Jeni detyruar të jeni pjesë e një klubi pa dëshirën tuaj? A jeni i detyruar të mos flisni për çështje të ndryshme sepse ndikojnë në vlerësimin tuaj? A jeni i detyruar të paguani shkollën dy herë për shkaqe të mungesës së pagesës nga sekretaria?

Pyetësori ka një variacion përgjigjesh në varësi të dhënave që duam të grumbullojmë. Përgjigjet janë thjesht me *po*, *jo* ose *nuk e di* por edhe alternativa të tjera. Në këtë sesion ata janë përgjigjur në formën: *Gjithmonë*, *Shumëherë*, *Ndonjëherë*, *Rrallëherë*, *Asnjëherë*, sipas kollonave nga 1(një) në 5(pesë).

Tek sesioni i katërt, ju kemi kërkuar studentëve të marrim përgjigje rreth mënyrës sesi ata e perceptojnë veten në universitetet shqiptare?. Si ndjehen ata pjesë e këtyre universiteve? A ndjejnë përgjegjësi që duhet të punojnë dhe të bashkëpunojnë me institucionet arsimore? A janë kërkuar dhe të përgjegjshëm me veten dhe universitetin ku studiojnë? Sa e respektojnë orarin në shkollë? Sa i përmbahen rregullit të veshjes në shkollë? Sa të ndërgjegjshëm janë për detyrat që ju janë caktuar? A janë etiketuar si migrant i kthyer? A bashkëpunoi me bashkëmoshatarët tuaj në shkollë? Studentët këtu u janë përgjigjur pyetjeve në formën: Nga 1(një) në 5(pesë)?! Ku 1(një) është “*Gjithmonë*” dhe 5(pesë) është “*Asnjëherë*”.

Sesioni i pestë ka të dhëna të tipit sasior si: Cila është gjendja ekonomike? Sa janë të ardhurat mujore të shprehura në lekë? Me kë jetoni aktualisht? Me kë jeni konsultuar për të zgjedhur këtë universitet? A ka qënë ideja e rikthimit diçka nostalgjike? A është vendosur ideja e rikthimit në familje pasi filloi kriza ekonomike? Idenë e migrimit në Shqipëri a e keni marrë bashkarisht? A vendos babai në familjen tuaj gjithmonë? A vendos nëna në familjen tuaj gjithmonë? Vendosët të riktheheshit pasi kishit fituar mjaftueshëm. Vendosët të riktheheshit pasi donit të investonit diçka këtu? Në familjen tuaj sa respektohen të drejtat dhe liritë e pjestarëve në vendimarrje? Familja juaj vazhdon të jetë në emigracion dhe ju jeni rikthyer? Pyetja e fundit është ajo sesa mbështetse është familja për të ardhurat? Mund të shtojmë këtu që ky ishte edhe një nga sesionet më të gjata dhe më me më shumë informacion pasi i jep mundësi studentit të na japi sa më shumë informacione rreth vetes dhe rreth familjes së tij.

Te ky sesion kemi përsëri të njëjtën shtrirje të tipit, *Gjithmonë, Shumëherë, Ndonjëherë, Rrallëherë, Asnjëherë, psh.* në familjen time mbi mundësinë e migrimit janë bërë shumë pak biseda për një rikthim të mundshëm. Studentët tek ky sesion duhet të përgjigjeshin nga

1(një) në 5(pesë).

Sesioni i gjashtë konsiston në pyetjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet dhe lidhjet që krijojnë studentët migrantë me bashkëmoshatarët e tyre studentë. Në bazë të përgjigjeve që ata japin në marrim informacione të karakterit sasior. Në këtë sesion ne jemi përpjekur të marrim përgjigje nëpërmejt 8 (tetë) pyetjeve të cilat janë: A flisni me bashkëmoshatarët tuaj rreth problemeve që hasni në universitetin tuaj? A komunikon me ta për çfardo gjëje që është e rëndësishme për ju? A ndjeheni të paragjykur nga ata sepse vini nga emigracioni? A ju ndihmojnë bashkëmoshatarët për problemet e gjuhës? A ka në shoqërinë tuaj studentë migrantë dhe jo migrantë? A shkëmbeni me ta eksperienca që keni kaluar kur keni qënë në emigracion? A shoqëroheni me ta edhe jashtë universitetit? Pyetja e fundit lidhet me pjesën e vendeve që frekuentoni me bashkëmoshatarët tuaj që keni në universitet për të parë nëse frekuentojnë të njëjtat vende.

4.6 Struktura e intervistës për institucionet

Të njëten gjë mund të themi edhe mbi *strukturën e intervistës së institucioneve*, i cili bën pjesë në rastin e instrumentit matës cilësor. Intervista bën të ditur natyrën e studimit, qëllimin që do të arrijë ky studim, si jep arsyen përse është zgjedhur i intervistuari në këtë rast. Gjithashtu janë shpjeguar arsyet se mbi çfarë kriteresh është marrë në studim ky target grup, si edhe kushtet mbi të cilat është krijuar konfidencialiteti i të dhënave studimore, mbi natyrën sesi është ndërtuar e gjithë intervista dhe mënyrën sesi janë analizuar gjithë të dhënat dhe deklarimi i të dhënave të ndryshme mbi materialet audio që mund të kenë persona të ndryshëm. Intervistuesit ju kërkua nga ana e udheqësit shkencor që të vihen në dispozicion të gjitha informacionet e grumbulluara. Nga ana jonë institucionit ju garantua

siguri e plotë mbi burimet e të dhënave dhe duke garantuar konfidencialitetin e tyre. Teknikat dhe mënyrat sesi duhet të përdoren aparatet ndihmëse si diktofoni apo regjistruarit e tjerë. Ato nuk përdoren si një send për të arritur qëllimin por edhe si një mjet që na ndihmon në arritjen e rezultateve me të qarta, nëpërmjet regjistrimeve ne kemi mundësinë të rikthehemi disa herë materialit duke e ridëgjuar. Ajo që është këshilluar edhe nga udhëheqësi shkencor është momenti që i intervistuari nuk do të intervistohet diktofoni fiket në mënyrë të menjëhershme pa vazhduar më tej intervistën. Nëse i intervistuari për arsye të ndryshme e ndërpret intervistën nga ana jonë garantohet që për atë nuk do të ketë asnjë pasojë negative dhe as sanksionuese. Gjatë intervistës ose kontaktit të parë nga ana jonë nuk do të lihet pa e falenderuar për bashkëpunimin dhe për kontributin e tij. Të gjitha intervistat u deklaruan që do të kontrollohen nga udhëheqësi i temës dhe pasi të kontrollohen do të përzgjidhet vetëm informacioni që duket interesant për temën. Udhëheqësi shkencor do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me studjuesin gjatë gjithë periudhës së studimit. Intervista e institucioneve është strukturuar në këtë mënyrë. Në fillim janë drejtuar pyetje që kishin të bënim me të dhënat demografike si gjina, mosha dhe pozicioni i punës dhe funksioni apo eksperiencia në këtë pozicion. Më tej u vazhdua me pyetjet rreth e tjera.

Pyetjet janë ndarë në dy seksione.

Tek sesioni i parë janë parashtruar pyetje që kanë të bëjnë me informacionin e përgjithshëm në fushën përkatëse si edhe me rolin që kanë këto institucione në këtë drejtim. Gjithashtu si pjesë parësore janë bërë pyetje në lidhje me informacionet që kanë institucionet, për mënyrën sesi bëhet regjistrimi për kategorinë studentëve që janë kthyer

nga emigracioni. Gjithashtu tek pyetjet e sesionit të parë ju dha rëndësi kontributit të institucioneve për të ndihmuar të rinjtë. Janë hartuar pyetje të karakterit të përgjithshëm nëse kanë një marrëdhënie bashkëpunimi midis universiteteve dhe Ministrisë së Arsimit. Ndërsa tek *sesioni i dytë* është sesioni i politikave dhe i shërbimeve të institucioneve dhe universiteteve, për një ri-integrim sa më të shpejtë të studentëve. Tek ky sesion janë bërë pyetje të tipit: A përfitojnë të njëjtat shërbime studentët migrantë si studentët e tjerë? Sa mundësi kanë ata të ri-integrohen në universitetet tona? I njëjti pyetësor është zhvilluar edhe për zyrat e këshillimit të karrierës. Sa ekzistojnë ato dhe sa të rëndësishme janë ato? Si dhe cilat janë planet dhe projekte për të ardhmen?

4.7 Vlefshmëria e të dhënave të rezultateve të punimit

Ajo që përbën shqetësimin kryesor është vlefshmëria dhe besueshmëria e të dhënave të grumbulluara nga studimi. Megjithëse shumë hulumtues argumentuan se në rastin hulumtimeve cilësore dhe sasiore afati për vlefshmërinë nuk është përfundimtar, nga ana tjetër, ata kanë kuptuar nevojën për një kontroll të masës në hulumtimin cilësor (Creswell & Miller, 2000).

Vlefshmëria është një lloj mënyre tradicionale për të kuptuar besueshmërinë; ky koncept është i ngjashëm me "*qëndrueshmërinë e një instrumenti matës*" (Long & Johnson, 2000). Vlefshmëria nënkupton: "*përcaktimin nëse një instrument matës në fakt mat atë që supozohet të matet*" (LoBiondo-Wood & Haber, 2014) ose "*shkalla në të cilën një instrument mat atë që është menduar për tu matur*" (Beck, Hgler, & Polit, 1995). Zakonisht, vlefshmëria është një mjet matës i bazuar në besueshmërinë ose të vërtetën. Hammerslay sugjeroi se disa nga pretendimet e të intervistuarit brenda përvojës sonë të përbashkët janë:

“shumë pak gabim dhe këto mund të pranohen pa asnjë skepticizëm. Informacione të tjera mund të kenë keqinterpretohen nga ana e studiuesit, prandaj kërkohen dëshmi të forta për të demonstruar vlefshmërinë e të dhënave” (Hammersley, 1992). Zakonisht, kemi vendosur vlefshmërinë duke marrë parasysh tre aspekte kryesore që janë:

- a) vlefshmëria e përmbajtjes,**
- b) vlefshmëria e lidhur me kriterin dhe**
- c) vlefshmëria e konstruktit**

Johnson shtoi se: *“vlefshmëria e përmbajtjes varet nga madhësia e mostrave dhe vlefshmëria e lidhur me kriterin varet nga ndërtimi i kujdesshëm i instrumentit dhe konstruktet. Vlefshmëria është një shkallë në të cilën adresohet fenomeni nën hetim”*. Ideja për të eksploruar të vërtetën duke matur besueshmërinë dhe vlefshmërinë është zëvendësuar nga ideja e besueshmërisë, e cila është e mbrojtur“ (Johnson, 1997) dhe vendosja e besimit në gjetjet (Yvonna, 1985). Ka dy përfaqje të përgjithshme për vlefshmërinë:

1. *Vlefshmëria e transaksionit* është një proces midis hulumtuesit dhe të dhënave të mbledhura, duke arritur një nivel të lartë të saktësisë.
2. *Vlefshmëria transformuese* përfshin zonën e kërkimit dhe kupton faktin shumë kritik. Vlefshmëria transformuese përpiqet të kuptojë kontekstin nga këndvështrimet dinamike dhe sociale. Të gjitha këto kritere matëse të vërtetësisë janë mbajtur nga ana jonë për të përdorur vlefshmërinë dhe besueshmërinë e rezultateve.

Në rastin e studimit të të dhënave u pa e udhës që vlefshmëria e të dhënave të matej nga metodat e sipër përmendura. Rezultatet e perzgjedhura nga INSTAT, IOM, MASH apo edhe

grupe të tjera interesi. Tek vlefshmëria e të dhënave përveç instrumenteve, ne ju referuam edhe variablave në studim si edhe modeleve të punimeve të mëparshme të bëra mbi migracionin shqiptar.

4.8 Përzgjedhja e kampionit/popullatës.

Mbledhja e të dhënave është bërë nga prilli 2014 deri në qershor 2017 duke marrë si shembull modelin Byte dhe Cassarino (Büthe, 2012)&(Cassarino, 2004), duke përdorur kampion përfaqësues në shkallë kombëtare mbi studentët migrantë. Në grupin e kampionimit janë përfshirë 200 studentë migrantë të pyetur nëpërmjet pyetësorëve. Studimi përbën një grup *kampioni specifik* duke qënë se paraqet një grup të intervistuarish në universitetet publike dhe jo publike. *Kampioni i shtresëzuar* është përdorur nga ana e studiuesit shkencor për të zgjedhur individët e kampionit. Ky lloj kampionimi i përshtatet kërkimit shkencor, pasi grupi i përfaqësuar është shumë i shpërndarë. Përcaktimi i kampionit shihet si një nga etapat thelbësore. Ne duhet të mbajmë parasysh që *kampioni i shtresëzuar*, përfaqëson grupin e studentëve në universitetet shqiptare publike dhe jo-publike të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Vlorës dhe Korçës etj. Shpërndarja është e pabartë sepse universitet nuk kanë shifra të sakta në lidhje me studentët e kthyer nga emigracioni. Numri më i madh të kampionit e kishin universitet publike. Kjo përzgjedhje u bë për dy arsye:

- Marzhi i gabimit në këtë lloj kampionimi është më i vogël dhe procedura e përzgjedhjes është me e lehtë.
- Sipas studimeve të mëparshme nga INSTAT dhe përfaqësuesve të tjerë është më e lehtë të menaxhohet marzhi i gabimit.

- Studentët, intervistohen pranë institucioneve të Arsimit të Lartë duke përfshirë të
- gjitha universitetet si publike dhe jo publike. Ajo që është kryesore në këtë studim është fakti se nuk duhet lejuar anëshmëri në intervistë.

Bazuar tek intervistat janë vendosur se paku dy kushte kryesore :

- Mosha nga 18-24 vjeç.
- Shtetas shqiptarë që kanë emigruar jashtë vendit të paktën mbi 1 vit dhe që është rikthyer me vullnet të lirë në vendin e tij.
- Shtetas shqiptarë të cilët në momentin e intervistës vazhdojnë studimet e larta.

Në lidhje me madhësinë e kampionit është parë me përparësi përfaqësimi i sa më shumë studentëve të rikthyer. Duke marrë parasysh të dhënat e fundit të IOM dhe INSTAT, duke llogaritur edhe numrin total të të kthyerve, zbritur kategorinë moshore të tyre dhe mbajtur numrin e të kthyerve në moshën 18-24 vjeç. Ky numër i kësaj grupmoshe është diku tek 19.987 individë.

E ilustruar grafikisht nga INSTAT 2016.

Grupmosha	Gjithsej
18-24	19.987
25-29	26.428
30-34	20.970
35-39	14.274
40-44	12.090
45-49	9.817
50-54	9.792
55-59	7.529
60-64	4.342
65+	8.347
Gjithësej	133.544

Tabela 3-1: Të kthyerit shqiptarë sipas grupmoshës(INSTAT, 2016)

Gjatë përcaktimit të strukturës së intervistës janë bërë edhe konsultime me studjues të fushës të cilët kanë bërë studime të ngjashme. Për të ulur marzhin e gabimit mund të themi se në të vërtetë kampionimi i grupit është parë si thelbësisht i shtresëzuar, pasi ky kampion është më justifikues në lidhje me studimin. Ky kampion ka përfshirë vetëm migrantë të kthyer në pesë vitet e fundit dhe kategoria moshore nga 18-24 vjeç. Duke patur parasysh kriteret për numrin që duhet të ketë grupi i të përfaqësuarve u përdorën 200 intervista të drejtpërdrejta vetëm për studentët migrantë. Besueshmëria e kampionit për studim në këto përmasa është konsultuar nga disa burime dhe autorë të ndryshëm. Për të bërë sa më të besueshëm dhe më të vërtetë studimin ndër të tjerë do të përmendim vetëm një autor Howe i cili thekson se: “*Madhësia minimale e kampionit të studimit, duhet të jetë të paktën 5 herë më e madhe sesa vetë numri i variablave, të përdorur në instrumentin matës, ndërkohë që*

një madhësi optimale dhe e pranueshme do të jetë raporti 10/1 pra numri i të anketuarve të jetë 10 herë më madh sesa variablat e studimit”(Howe, 1988).

Ndërkohë që autorë të tjerë për të përcaktuar numrin e të anketuarve në përputhje me variablat theksojnëse: *“vetë madhësia e kampionit kërkon të jetë 5 apo 10 herë më e madhe sesa variablat e pavarura në mënyrë që studimi të jetë i besueshëm”* (Hill, 1977). Ndërsa Hoelter një tjetër autor që është shumë i njohur në terrenin sociologjik na jep një model më efikas sesa ai i (Duvall, 2014) mbi metodën cilësore. Ai sugjeron nëpërmjet metodës cilësore se: *“ne na duhen 100 deri 200 anketime për ti dhënë përgjigje çdo variabli në një studim”* (Duvall, 2014).

Duke marrë parasysh të gjitha punimet e mëparshme dhe konsultat me sociologë të njohur shqiptarë, si Prof.dr Kosta Bajraba dhe Prof.dr Zyhdi Dervishi, të cilët kanë kontribuar në studime të ngjashme, u pa me rëndësi që të merren në studim 200 studentë të rikthyer nga emigracioni. Pyetësorët përfshijnë universitetet publike dhe ato jopublike në rang kombëtar. Nga ana tjetër u mendua të përfshihen në kampionim, përfaqësues të institucioneve të Arsimit të Lartë. Në institucionet e Arsimit të Lartë janë bërë 20 intervista, nga të cilët 10 janë të intervistuar nga universiteti jo publik dhe 10 nga universitetet publike. U intervistuan përfaqësues të administratës si: sekretarët mësimorë, burimet njerëzore, si edhe zyrat e Këshillimit të Karrierës. Përcaktimi i këtij kampioni u pa i rëndësishëm:

1. Ky është një nga kampionimet më të rëndësishme në studim dhe që u përdor si një nga levat më të rëndësishme të studimit për të treguar numrin e përfaqësimeve. Ky lloj kampionimi bën të mundur shtresëzimin e popullatës në mënyrë që të garantohet përfshirja e grupeve dhe të prezantohen karakteristikat të popullatës në përpjestim të drejtpërdrejtë me statistikën ekzistuese të popullatës për studim

(Matthews & Ross, 2010). Duke marrë parasysh edhe të dhënat e nxjerra nga Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë në lidhje me numrin e përgjithshëm të kësaj kategorie, si edhe duke u bazuar tek numri i përgjithshëm i individëve, u bë përpjekje për të ruajtur raportin midis meshkujve dhe femrave që ndjekin studimet në universitetet publike dhe jo publike. Të gjitha këto janë bërë për të përcaktuar kuotat dhe karakteristikat e kampionimit si edhe realizimit të pyetësorve.

2. Në kampionim janë përfshirë: të dyja gjinitë meshkuj-femra që janë kthyer nga emigracioni në pesë vitet e fundit në raportin **2-1**.
3. Së dyti në këtë lloj kampionimi janë përfshirë studenët nga të dyja ciklet, cikli i parë dhe cikli i dytë. Ky kampionim përfshinte institucionet publike dhe jopublike.

Raporti sipas statistikave është**3:1**

4. Së treti studentët e përfshirë në intervista të drejtpërdrejta nga universitete publike dhe private ishin në raportin **4:1**
5. Së katërti në mënyrë që përfaqësimi të ishte edhe më i plotë u bënë intervista të drejtpërdrejta 200 studentëve më numër përfaqësimi gati të barabartë në mënyrë që grupi i të përfaqësuarve të ishte sa më i bindshëm në hulumtimin shkencor.

Për shembull nga 200 intervista ne jemi munduar të ruajmë raportin meshkuj femra 50 me 50 por nuk jemi në gjendje të ruajmë numrin e barabartë midis cikleve prandaj 75 studentë i kemi intervistuar në ciklin e parë dhe vetëm 25 në ciklin e dytë. Ndryshe nga studimet e tjera në të cilat prezantojnë një numër më të lartë studentësh në universitet publike këtu rezulton se shpërndarja është gati e barabartë. Duhet patur parasysh që në këtë rast tek kampionet me shtersëzime kemi një përzgjedhje të intervistave jo në listë emërore por në

një intervistim të zgjedhjes së lirë, prandaj është menduar që pyetësit të jenë në dy forma të drejtpërdrejta dhe nëpërmjet forumeve online.

4.9Përcaktimi i variablave

Ashtu sikurse përcaktimi i kampionit, edhe *përcaktimi i variablave* është një nga hallkat e rëndësishme në studimin shkencor. Përcaktimi i *variablave të varur* dhe *të pavarur* u mbështet në këto dy metodologji. Në këtë studim kemi përdorur së paku këtë ndarje, *variabla të varur* dhe *variabla të pavarur* si edhe *variabla të ndërmjetëm*.


Përcaktimi i variablave u bë në bazë të rezultateve të *regresionit të shumëfishtë*. Përcaktimi i variablave u bë sipas *testimit T* të hipotezës duke iu referuar Christensen, Johns dhe Turner (Christensen, Johnson, & Turner, 2015).

- ✓ **Te variablat e varur** kemi përfshirëri-*integrimit social kuturor*, që matet nëpërmjet variablave të tillë, si: pedagogu, i studenti, i grupit të bashkëmoshatarve, familja, dhe migranti etj.
- ✓ **Te variablat e pavarur** kemi përfshirë*regullatorët e ri-integrimit*dhe këtu kemi parasysh zyrat e Këshillit të Karrierës,sekretaritë, universitet, Ministrinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve etj.
- ✓ **Te variablat e ndërmjetëm**, që ndërhyjnë si indikatorndihmues në matjen e *variablave të varur* dhe *të pavarur*, kemi përfshirë reformat institucionale, Kartën e Bolonjës, Marrëveshjet Ndërinstitucionale, Programet Erasmus etj.

KAPITULLI V


REZULTATET E STUDIMIT DHE ANALIZA

5.1. Statistika Përshkruese(sesioni 1)




Grafiku 5-1: Gjinia e studentëve të intervistuar

Të gjitha informacionet e marra do të përshkruhen si elemente bazë tëinterpretimit të dhënave të përgjithshme. Grafiku 5-1 na jep të dhëna rreth gjinisë së studentëve të shprehur në përqindje dhe në numra. Siç rezulton numri i femrave të intervistuara është më i madh sesa numri i meshkujve. Të shprehur në përqindje rreth 53% që kanë pranuar të jenë pjesë e intervistave janë femra dhe 47% janë meshkuj. Femrat përbëjnë rreth 6% më shumë. Ndërsa të shprehur në numra ata që kanë pranuar të jenë pjesë e pyetësorit janë 105 femra dhe 94 meshkuj. Mund të shtonim si informacion shtesë që numri më i madh i femrave mund të lidhet edhe më pjesën e mosfrekuentimit në leksioneve dhe seminareve nga anae studentëve meshkuj dhe ky mosfrekuentim ka ndikuar për të patur këto shifra. Së dyti kjo mund të lidhet edhe me numrin më të madh të femrave që duan të arsimohen.




Grafiku 5-2 Mosha e studentëve të intervistuar

Tek grafiku numër(5-2) ne kemi të paraqitur në përqindje grupmoshat e kampionit të ndarë kategori moshore. Nga 18-20 vjeç, 20-22 vjeç dhe 22-24 vjeç dhe grupi i atyre që i kanë kaluar të 24+ vjeç por që për arsye të ndryshme vazhdojnë të frekuentojnë studimet. Nëse shohim grafikun, pjesën më të madhe e zënë studentët e grupmoshës 20-22 vjeç. Ata përfaqësojnë 31% ose 60 studentëve të intervistuar. Ndërsa përqindjen më të vogël e zënë studentët me moshën nga 22-24 vjeç me një përfaqësim diku prej 21%, e shprehur në numër 40 studentë të intervistuar. Ajo që nuk pritej nga ana jonë ishin studentët mbi 24 vjeç të përfaqësonin diku mbi 26% ose rreth 52 studente. Nga përgjigjet e marra nga kjo grup moshë ka rezultuar se procedurat e njohjes së diplomave dhe të krediteve nuk kanë qënë favorizuese madje gati penguese. Si pasojë shumë nga studentët e pyetur ose janë detyruar të nisin studimet nga e para ose duke ju njohur më pak kredite shumë prej tyre kanë humbur edhe vitin akademik. Ky numër përfaqësonte gati 47 studentë të pyetur nga ana jonë. Ky grafik tregon vështirësitë burokratike për plotësimin e dokumentave.



Grafiku 5-3: Viti akademik i studentëve të kthyer


Te ky grafik kemi të paraqitur numrin e studentëve të kthyer në pesë vitet e studimit duke përfshirë të dy ciklet, bachelor dhe master dy vjeçar. Viti i parë akademik i ciklit bachelor përfaqëson rreth 15% ose 30 studentëve të intervistuar. Viti i dytë akademik përfaqëson 22% ose 44 studentë të intervistuar në të gjitha universitetet shqiptare. Viti i tretë akademik përfaqëson 27% ose e shprehur në numër 53 studentë të intervistuar. Numri më i vogël i të intervistuarve ishte tek studentët e masterit. Në vitin e parë master ne kemi një përqindje diku tek 20% të studentëve të intervistuar ose e shprehur në numër 41 studentë. Ndërsa viti i dytë master përfaqëson 15% të të intervistuarve ose 30 studentë. Theksojmë që ishin edhe 2 studentë që nuk kanë specifikuar nivelin e studimit dhe ne nuk mund ti detyronim ta bënin këtë.



Grafiku 5-4: Universiteti ku janë zhvilluar intervistat


Grafiku numër katër tregon shpërndarjen e studentëve në universitetpublike dhe ato jo publike ku studentët migrantë kishin rifilluar studimet e lëna përgjysëm. Te ky grafik ne jemi përpjekur që të kishim një shpërndarje sa më gjithë përfshirëse. Pavarësisht përpjekjes për të përfaqësuar të gjithë universitetet në vend nuk arritën të kishim kontakte me të gjitha universitetet e vendit pasi nga zyrat e arsimit dhe të migracionit nuk na u dhanë shifra mbi këtë grup studentësh. Numri më i madh i të studentëve të intervistuar është në Universitetin e Tiranës. Duhet theksuar se intervistat që janë zhvilluar në Universitetin e Tiranës kanë qënë intervista të drejtpërdrejta. Ndërsa pjesa pjesa më e madhe e intervistave të zhvilluara në universitetet e rretheve janë zhvilluar në formatin online. Por një numër i vogël intervistash në universitetet e Shkodrës, Korçës dhe Elbasanit janë zhvilluar drejtpërdrejt. Ndërsa përse i përket ndarjes universitet publik dhe jo-publik vërehet se përqindja më e madhe e studentëve të kthyer vazhdojnë studimet tek universitetet publike. Kjo mund të shpjegohet me numrin më të madh të studentëve që vazhdojnë studimet në univesitetet publike, por edhe me arsye të tjera. Disa universite nuk u treguan të gatshëm të

bashkëpunonin dhe një pjesë nuk kishin të dhëna për studentë të kthyer.




Grafiku 5-5: Preferencat studimore të të kthyerve

Tek ky grafik janë paraqitur degët ku studentët kanë rifilluar studimet e tyre. Nga ky grafik kuptohet se studentët kanë zgjedhur pothuaj gjithë gamën e degëve. Rreth 24% e studentëve ndiqnin studime në degët e shkencave të natyrës dhe ato të mjekësisë. Një specifikë që u vu re tek ky grup studentësh ishte se ata ishin rikthyer me vullnet për të vazhduar studimet në universitet shqiptare për dy arsye. Së pari tarifat sidomos në degët e mjekësisë ishin shumë herë më të ulëta në raport me vendet nga ata vinin. Së dyti shumë nga këta studentë kishin hasur vështirësi në marrjen e provime për shkak të kërkesave të larta që kishte aty. Gati 28% janë pjesë e shkencave sociale, ku përfshin shumë profile si filozofi, psikologji, punë sociale por dhe shkenca politike. Pjesa më e madhe e studentëve të shkencave sociale kishin bërë transferim studimesh. Rreth 19% ishin studentë të cilët studionin në degë për ekonomi. Një numër i konsiderueshëm diku 16% janë pjesë e shkencave të komunikimit dhe të gazetarisë ndësa pjesa tjetër për 13% studionin drejtësi.



Grafiku 5-6: Orientimi për të ndjekur studimet

Te ky grafik janë paraqitur këshillat që studentët kanë marrë parasysh në lidhje me profilin që ata kanë zgjedhur. Po të vërejmë me kujdes ato ndahen në mënyrë gati të barabartë, midis medias familjes dhe shoqërisë. Numri më i madh i studentëve janë shprehur se kanë gjetur informacion të bollshëm në lidhje me universitetet dhe profilet që ata kanë dashur nga media. Një pjesë e konsiderueshme rreth 28% kanë marrë këshilla nga familja. Këtu studentët janë shprehur se kanë ndjekur traditën familjare, sipas profesioneve të prindërve. Nga ana tjetër një numër po i madh studentësh kanë marrë këshilla nga shokët të cilët jetonin në Shqipëri duke i besuar eksperiencës së tyre në universitetet shqiptare. Tek ky grup shpesh herë ka ndikuar edhe prania e të njohurve në universitetin ose degën që ata do të ndiqnin në Shqipëri. Dhe së fundi një grup studentësh të cilët përbëjnë rreth 16% nuk kanë dhënë informacione specifike në lidhje me orientimet dhe këshillat që ata kanë ndjekur për të vazhduar studimet e larta në Shqipëri.




Grafiku 5-7: Konsultimi për të zgjedhur këtë universitet.

Tek ky grafik ne kemi paraqitur mendimin dhe konsultat që kanë ndjekur studentët për zgjedhjen e universitetit. Sipas përgjigjeve të dhëna nga studentët na rezulton se 49% e tyre janë konsultuar me familjen për të zgjedhur universitet ku ata ndjekin studimet aktualisht. 28% e studentët kanë marrë në konsideratë këshillat që të afërmit dhe shokët që jetojnë në Shqipëri në lidhje me universitetin e zgjedhur. Shumë pak prej tyre gati 13% kanë marrë të dhëna për të zgjedhur universitetin nga institucionet arsimore. Kjo përqindje e ulët siç theksuan edhe ata lidhet edhe me faktin se institucionet arsimore shqiptare nuk kanë në faqet e tyre zyrtare të dhëna dhe informacione specifike në lidhje me prirjet e tyre.

Ndërkohë që 10% e studentëve të kthyer u përgjigjën se informacionin për të zgjedhur universitetin në Shqipëri e kishin marrë nga media e ndryshme që operonin në vendin tonë.

5.2 Motivet e rikthimit (Sesioni 2)



Grafiku 5-8: Ideja e kthimit u vendos vetëm pas krizës ekonomike.


Pyetja e parë e cila ju drejtuam studentëve të kthyer ishte se kur ju lindi ideja për tu kthyer?.

Përgjigjet e tyre ishin interesante dhe i bashkonte fakti që ata nuk ishin kthyer me dëshirë dhe së dyti faktori kryesor ishte kriza ekonomike botërore e vitit 2008. Për shumicën e tyre rreth 30% vendimi për tu kthyer u mor menjëherë pasi erdhi kriza ekonomike.

Një pjesë përsëri e konsiderueshme që përbënin rreth 25% nuk e mori vendimin për t'u kthyer nga shpërthimi i krizës por si pasojë e zgjatjes së saj. Ndërsa 20 % e studentëve të pyetur e mendonin kthimin si një mundësi, por gjithsesi kriza ekonomike pati ndikimin që ata u kthyen në këtë moment. 15% e studentëve u përgjigjen se fill mbas humbjes së vendit të punës nga ana e prindërve ata vendosën të ktheheshin. Ndërsa 10% e studentëve u shprehën se kthimin mbrapa e kishin parë si mundësinë e fundit por zgjatja e krizës humbja e vendit të punës ulja e të ardhurave ndikoi tek vendimi për t'u kthyer.

Në familjen time ideja e rikthimit deri në momentin e kthimit ka qënë diçka nostalgjike


■ Gjithmonë ■ Shpesh ■ Ndonjëherë ■ Rrallë ■ Asnjëherë



Grafiku 5-9: Ideja e rikthimit deri në momentin e kthimit ka qënë diçka nostalgjike

Ne nuk u mjaftuam vetëm me pyetjen e mësipërme në lidhje me vendimin për t'u kthyer por ju drejtuam atyre dhe një pyetje të dytë. Kjo si pyetje ishte më gjithë përfshirëse sepse përfshinte ndjenjën e atdhe dashurisë, të trashëguar nga familja. Pyetjes se a kishit dëshirë për tu kthyer?

Rreth 34% e studentëve u përgjigjën se *gjithmonë*, kanë patur nostalgji për t'u kthyer në vendin e origjinës. Duhet të theksojmë se kjo kategori studentësh ka lindur në Shqipëri dhe kishin ikur në një moshë të madhe nga Shqipëria. 23% e studentëve u përgjigjën se *shpesh*, kishin nostalgji për vëndin. Ndërsa 25% e studentëve u përgjigjën se *ndonjëherë*, kishin patur nostalgji për t'u rikthyer dhe për vëndin. 8% u përgjigjën se *rrallë* kishin nostalgji për t'u kthyer kurse 10% e studentëve të pyetur u përgjigjën se *asnjëherë*, nuk kishin patur nostalgji për vëndine tyre. Studentët që ju përgjigjën sipas dy kategorive të fundit theksuan se lidhjet me Shqipërinë i kishin patur të pakta dhe e njihnin shumë pak vëndin e origjinës.




Grafiku 5-10: Vendim-marrja për t'u kthyer në Shqipëri

Pyetjen e tretë në lidhje me vendimarrjen për t'u kthyer ne jua kemi drejtuar studentëve për të kuptuar nese ata e kishin marrë këtë vendim me familjen apo individualisht?. 25% e studentëve u shprehen se vendimin për t'u kthyer ata e kishin marrësë bashku me familjen e tyre. Ata mendonin se mbas krizës ekonomike do të ishte më mirë kthimi pasi shpenzimet këtu do të ishin më të ulta sesa në vendin ku ata ishin emigrantë. 25% e studentëve të pyetur janë përgjigjur se vendimin për t'u kthyer e ka marrë babai. Babai mendonte se eksperiencia e fituar në emigracion do t'ju ofronte mundësi më të mira në vendin e origjinës. Ndërsa 20% e studentëve të kthyer u përgjigjën se vendimin e kthimit e kishte marrë ai/ajo së bashku me babain. Ai kishte biseduar me familjarët e tij për t'u rikthyer në Shqipëri. Ndërsa 15% e studentëve u përgjigjen se vendimin për t'u kthyer e kishte marrë nëna dhe vetë studenti. Ndërsa 15% e studentëve të pyetur u përgjigjën se vendimi për t'u kthyer ka qënë individual. Këtu bëjnë pjesë edhe studentët të cilët kishin familjen në Shqipëri por që për arsye të ndryshme kishin ndërprerë studimet në vendet europiane.

A e patët të vështirë vendimin për tu kthyer në Shqipëri dhe si mendonit ta ndërtonit jetën këtu


■ vendosëm të investonim ■ karriera ime ■ kishim para
 ■ probleme dokumentacioni ■ nuk kishim alternativ tjetër



Grafiku 5-11: A e patët të vështirë kthimin në Shqipëri?.

Sipas grafikut të analizuar më sipër ne i pyetëm studentët se a e patën të vështirë vendimin për t'u kthyer në Shqipëri dhe a mendonin ta ndërtonin të ardhmen këtu. 40% e studentëve të pyetur janë përgjigjur se të ardhmen në Shqipëri e shihnin ata dhe familja e tyre e shihnin si një mundësi të mirë investimi. Ky ishte grupi i studentëve të cilët migrimin e shohin me pozitivitet. Ndërsa 20% e studentëve të intervistuar u shprehën se të ardhmen në Shqipëri e shihnin si një mundësi shumë e mirë për të ecur përpara në karrierën e tyre. Në vendin e tyre ata mendonin se do të kishin më shumë mundësi që të zhvillonin një karrierë sipas profilit të diplomës së tyre. 15% e studentëve u përgjigjën se ishte mungesa e dokumentacionit në vendin ka ata ishin emigrantë që i detyroi ata të rikthen. Po 15% e studentëve të pyetur mbi mundësinë e të ardhmes në vendin tonë janë shprehur se ata nuk kishin asnjë alternative tjetër veçse të ktheheshin. Ndërsa 10% e studentëve u përgjigjën se mund të ndërtonin të ardhmen pa problem në Shqipëri pasi kishin fituar mjaftueshëm para dhe mund të vazhdonin një jetesë normale në Shqipëri.

Njohuri mbi migracionin e kthimit




Grafiku 5-12: Njohuri mbi migracionin e kthimit

Te ky grafik jemi munduar të mbledhim të dhëna sasiore në lidhje me atësesa informacion kanë studentët mbi migracionin e kthimit. Po të vërejmë me kujdes të dhënat konstatojmë më shumë se gjysma rreth 60% kanë aspak ose pak informacion. Këta studentë nuk kishin njohuri mbi **statusin e migrantit** që ata kishin sapo ktheheshin në vendin e origjinës. Pas rikthimit ata e quanin veten si **emigrantë** në vëndin e lindjes, çka nënkupton që ata e ndjenin vetën të përjashtuar. Duhet theksuar se një numër i madh i tyre kishin emigruar në moshë fare të vogël dhe kujtimet e tyre me momentin e largimit ishin të vakëta. Ndërsa një numër i konsiderueshëm i tyre kishin lindur jashtë Shqipërisë. Rreth 40% e tyre kishin janë përgjigjur se kishin mjaftueshëm ose shumë pak informacion në lidhje me migrimin.

Të shprehur në numëra 88 prej tyre kanë thënë që kishin shumë pak informacion. 12 studentë u shprehën se nuk kishin asnjë informacion. Ndërsa 40 studentë u shprehën që kishin informacion rreth migrimit. Numri i studentëve që nuk kishin fare informacion ishte po ashtu 40 studentë nga 200 të pyetur.

Burimet e informacionit të migracionit të kthimit




Grafiku 5-13: Burimet e informacionit të migracionit të kthimit

Te ky grafik janë shpjeguar burimet e informacionit që kanë studentët mbi fenomenin e migracionit. Nga përgjigjet e të intervistuarve sasia më e madhe e informacionit që ata kanë rreth migracionit vjen nga media. Në përqindje të përafërt është edhe informacioni që vjen nga familja. Informacioni që ata marrin për migracionin nga rrethi shoqëror është gati i barabartë rreth 22% me dy burimet e para. Ndërsa informacioni që ata marrin në ambientet e shkollës zë vendin e katër. Ashtu sikurse kemi theksuar edhe në kapitujt e mësipërm këtu del në pah se universitetet kanë bërë shumë pak në lidhje me kategorinë e studentëve të kthyer. Ata nuk kanë ngritur akoma **struktura specifike** që të informojnë dhe t’iu vijnë në ndihmë kësaj kategorie studentësh. Nga përgjigjet na ka rezultuar se vetëm Universiteti European i Tiranës ka arritur që të bashkëpunojnë dhe të informojë studentët në lidhje me ri-integrimin e tyre në jetën e përditëshme dhe në universitet. Rreth 14% të informacionit në lidhje me migrimin studentët e marrin nga burime të tjera.

Mundësinë e ri-emigrimit familjar


■ Gjithmonë ■ Shpesh ■ Ndonjëherë ■ Rrallë ■ Asnjëherë



Grafiku 5-14: A ekziston mundësia e ri-emigrimit familjar

Në këtë grafik tregohen përgjigjet që në morëm mbi pyetjen e mësipërme. 37% e studentëve u përgjigjën se në bisedat me familjen e tyre *gjithmonë* diskutojnë mbi mundësinë e ri-emigrimit. 17% e studentëve të pyetur u përgjigjën me *asnjëherë*, mbi mundësinë e ri-emigrimit.


Nga informacionet e mëtejshme që ata dhanë kuptohej se ky grupi ishte ri-integruar në Shqipëri pas rikthimit. Po ashtu 17% e studentëve u përgjigjën se *shpesh*, diskutojnë me familjet për t'u rikthyer në vendin ku ata kishin emigruar më parë. 15% e studentëve të kthyer u përgjigjën me *ndonjëherë* mbi mundësinë e ri-emigrimit. Ndërsa 14% e studentëve u përgjigjën me *rrallë* mbi mundësinë e ri-emigrimit. Shihet qartë se shumica e të kthyerve e shikojnë mundësinë e ri-emigrimit si një opsion të mundshëm. Kjo tregon se Shqipëria akoma nuk ofron mundësitë për të ri-integruar migrantët e kthyer ose të tjerë që duan të kthehen në të ardhmen. Kjo shihet edhe nga të dhënat e dala së fundmi nga INSTAT ku raporti i atyre që hynë dhe atyre që dalin është më i madh për kategorinë e njerëzve që dalin nga vendi ynë.



Grafiku 5-15: Emigrimi i studentit përsëri pas mbarimit të studimeve.

Përveç pyetjes në lidhje me ri-emigrimin familjarë ne ju drejtuam studentëve edhe një pyetje në lidhje me mundësinë e ri-emigrimi individual nga e tyre. Siç e shohim edhe nga grafiku e mësipërm përgjigjet e tyre tregojnë se pjesa më e madhe kërkojnë të ri-emigrojnë. 58% e studentëve të pyetur u përgjigjën me *gjithmonë* kur u pyetën se a do të ri-emigronin përsëri pas përfundimit të studimeve. E parë në këtë këndvështrim më shumë sesa gjysma e të kthyerve duan të rikthen në vëndin ka ata kanë qënë emigrantë. Ndërsa 32% e studentëve u përgjigjën me *shpesh* kur u pyetën se a do të ri-emigronin. Pjesa tjetër 5% u përgjigjën me *ndonjëherë* dhe 2% e studentëve u përgjigjën me *rrallë*. Vetëm 3% e studentëve u përgjigjën se *asnjëherë* nuk e mendonim ri-emigrimin. Pavarësisht se çfarë i shtyu ata që të ktheheshin në atdhe siç shihet nga rezultatet që shprehen në grafik shumica e këtyre të kthyerve është përgjigjur se në përfundim të studimeve do të ri-emigrojnë përsëri. Kjo përgjigje është një këmbanë alarmi për shtetin dhe për gjithë shoqërinë shqiptare e cila për më shumë se 25 vitesh vuan pasojat e një *emigracioni të pandalshëm*.

5.3 Përfshirja e studentëve në jetën universitare (Sesioni 3)




Grafiku 5-16: Ndjesia e studentëve në universitete

Tek grafiku numër 16 ne kemi pyetur rreth mënyrës sesi ata ndjehen tek universiteti që kanë zgjedhur të vazhdojnë studimet. Rreth 36% ose 70 studentë janë shprehur se ndjeheshin mirë me zgjedhjen që kanë bërë dhe kanë dhënë alternativën *mirë*. Studentët të cilët janë shprehur se ndjehen *shumë mirë* janë diku 30% e përkthyer në numra 58 studentë. Ndërsa studentët të cilët kanë thënë që janë *mjaftueshëm të kënaqur* janë diku 26% ose 52 studentë. Përgjigjja “*mjaftueshëm*” që dha ky grup studentësh lidhet me një sërë problemesh që ata ngrinin. *Së pari* ata ishin të pakënaqur me përgatitjen e stafeve akademike në universitet shqiptare, përfshirë pedagogët dhe stafin e administratës. *Së dyti* ata shprehnin pakënaqësi në lidhje me mangësitë që hanin në programet mësimore. *Së treti* një pjesë e lidhnin pakënaqësinë me kushtet fizike që ofrojnë universitet shqiptare. Kjo e fundit lidhej më së shumti me universitet publike.

Ndërsa pjesa e pakënaqur ishte rreth 8% ose 17 studentë. Ky grupim përfshinte ata studentë të cilët ishin kthyer pa dëshirën e tyre, por për asye të ndryshme siç mungesa e


dokumentacionit ose kirza ekonomike. Këta nuk e shihnin universitetin shqiptar si alternativën më të mirë. Duhet patur parasysh që këta studentë vijnë nga kryesisht të europës ku panvarsisht krizës ekonomike cilësia e universiteteve nga ata vinin ishte shumë herë më lart se universitetet shqiptare.



Grafiku 5-17: Ndihma nga stafi univeritar kundrejt studentëve të kthyerve.

Te ky grafik paraqiten marrëdhëniet student-pedagog. Rreth 44% e studentëve kanë dhënë përgjigjen “*gjithmonë*” kur janë pyetur, sesa kanë qënë të ndihmuar nga stafi universitar në lidhje me ri-integrimin e tyre në universitetet shqiptare. Në numër këta ishin 86 studentë. Ndërsa rreth 37% e studentëve u shprehen se “*ndonjëherë*” kanë gjetur ndihmesë nga pedagogët e tyre. Në numra këta ishin 74 studentë. Ndërsa pjesa e studentëve të cilët pranojnë që nuk kanë patur *asnjë ndihmesë* është diku tek 19.% e përkthyer në numra 38 studentë. Gjithashtu këtu theksojmë që ka edhe studentë të cilët nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje dhe përsëri ne nuk e dimë arsyen. Nëse bëjmë një matematikë të thjeshtë midis atyre që kanë thënë *ndonjëherë* dhe *asnjëherë* matematikisht del se 112 studentë. Duke parë këtë


grafik kuptojmë se më shumë sesa gjysma e studentëve nuk kanë gjetur mbështetje nga stafi akademik. Duhet theksuar në lidhje më ri-integrimit të tyre në universitete, roli i stafit akademik nuk ka qënë shumë favorizues për studentët. Duhet të pranojmë se panvarsisht se ne ju garantuam studentëve ruajtjen e ë dhënave, shumë prej tyre kanë refuzuar të përgjigjen. Kjo tregon që ata nuk kanë dashur të japin një përgjigje pozitive apo negative, çka tregon se ata nuk ndjehen shumë konfident me pedagogët e tyre.



Grafiku 5-18: Sa të ri-integruar ndjehen studentët e kthyer.

Tek pyetja e drejtpërdrejtë sasiore, sesa ndihen të ri-integruar studentët, rreth 64% ose 125 studentë ijanë përgjigjur pozitivisht. Duhet të theksojmë se këta janë studentë të cilët nuk kishin shumë vite në emigracion dhe lidhjet me vendin kishin qënë të forta dhe ata nuk ishin shkëputur për periudha të gjata kohore. Pjesa e cila është përgjigjur “*disi*” është 23% ose 45 studentë. Ata theksuan se ekzistonin ndryshime të mëdha midis universiteteve shqiptare dhe univeriteteve prej nga ata vinin. Ndryshimet konsistonin si në kushtet e ambjenteve universitare por edhe tek metodat e mësimdhënies. Pjesa e cila e ka mohuar totalisht ri-integrimit janë përbën 13% ose 26 studentë. Tek ky grup duhet të theksojmë se hyn ai grup studentësh i cili nuk e shikon rikthim në Shqipëri si një zgjidhje përfundimtare.


Ata shprehen se sapo t'u jepet një mundësi ata do të rikthehen në vendin prej nga ishin kthyer ose në ndonjë vend tjetër europian ose SHBA. Këtyre pyetjeve 4 studentë nuk u kanë dhënë asnjë përgjigje.



Grafiku 5-19: Kontributi nga ana e universiteteve për ri-integrimin e studentëve

Të paktën nga 198 përgjigjet e dhëna gati 60 % e studentëve kanë thënë që *universiteti duhet të bëjë më shumë për studentët* që janë kthyer nga emigracioni. Kjo tregon se universitetet shqiptare janë të papërgatitur ose nuk kanë infrastrukturën dhe stafin akademik përkatës për të pritur studentë që vijnë nga universitetet europine, qofshin këta shqiptare ose jo. Pjesa më e madhe prej tyre mendonin që stafi i pedagogëve në universitet tona nuk ju mundësonin atyre një integrim të shpejtë pasi ata nuk ishin në gjendje t'ju ofronin leksionet në gjuhën angleze. Madje shumë prej tyre theksonin se universitetet duhet të krijojnë mundësi dhe të vënë në dispozicion personelin akademik për këta studente. Vetëm 20% e tyre studentëve kanë pohuar që *universiteti ka bërë mjaftueshëm* për ri-integrimin e tyre. Ky kontigjent studentësh kryesisht studionte në universitetet jo-publike


dhe pjesa më e madhe tyre i përkisnin Universitetit Europian të Tiranës. Këta studentë u shprehën se këtu kanë gjetur një komoditet në burime materiale. Gati 20% e studentëve të pyetur u *shprehën se univeristetet nuk kishin marrë asnjë masë* për ri-intergrimin e tyre. Këtu kemi hasur edhe studentë që kishin vështirësi në të folurin dhe të kuptuarin e gjuhës shqipe. Këta ishin studentë që kishin lindur ose kishin emigruar në moshë fare të vogël. Sipas tyre universiteti duhet t'u mundësonte të paktën disa kurse për përmirësimin e gjuhës shqipe.



Grafiku 5-20: Ftesa në aktivitete

Tek grafiku numër 20 ne ju kemi bërë studentëve pyetjen nëse: "*Kanë marrë një ftesë të drejtpërdrejtë në aktivitetet që zhvillohen në universitet*"?. 28 studentë të pyetur deklarojnë se janë ftuar në aktivitetet shkollorë *gjithmonë* kur ka patur të tilla. Ndërsa 40 studentë kanë deklaruar se janë ftuar *shpesh* në këto aktivitete. Ndërkohë 39 studentë kanë deklaruar se *ndonjëherë* janë ftuar në këto aktivitete. Një kategori e përafërt me dy të parat pra 41 studentë kanë deklaruar se janë ftuar *rrallë* në këto aktivitete. Ndërkohë që një grup prej 50 studentësh janë shprehur se *asnjeherë* nuk janë ftuar në aktivitete që zhvillohen në


universitetet e tyre. Siç shihet nga grafiku i mësipërm shumica e studentëve janë ftuar për të marrë pjesë në aktivitetet që zhvillohen në universitet, por nga ana tjetër nuk është i vogël edhe përqindja e atyre që nuk janë të ftuar në këto aktivitete. Ata përbëjnë $\frac{1}{4}$ e numrit total të studentëve të intervistuar.



Grafiku 5-21: Pjesëmarrja në klubet universitare

Te grafiku më sipër përshkruhet pjesa e grafikut të studentëve që janë pjesë e grupit të klubeve të ndryshme në universitet si psh klubi, i filozofisë, kabineti i biologëve, klubi i ekonomistëve etj. Tek ky grafik studentëve ju është kërkuar që të shënonin sesa aktivë ishin ata në forumet e ndryshme universitare. Në zgjedhjet e kërkuara ata duhet të zgjidhnin disa alternativa. Alternativa që kryeson në këtë grafik është pikërisht kollona më bazën *rrallë* të cilën e kanë zgjedhur 50 studentë. Rreth 43 studentë janë përgjigjur me “*gjithmonë*”. Ndërsa 39 studentë janë përgjigjur se kanë qënë pjesë e forumeve “*shpesh*”. Këta përbëjnë grupin më të ri-integruar të studentëve të kthyer. 39 studentë kanë zgjedhur alternativën *ndonjëherë*. Pjesa që nuk kishin marrë *asnjëherë* pjesë në forumet universitare ishte 29

studentë të intervistuar. Nga vëzhgimi, ka rezultuar se ata studentë që ju janë përgjigjur pozitivisht pyetjeve për pjesëmarrje në këto klube janë studentë të universiteteve jo publike.




Grafiku 5-22: Pjesëmarrja në qeverinë studentore

Te ky grafik ne kemi parë me shumë përparësi përfshirjen e studentëve në jetën universitare dhe në vendimarrjen në universitet. Në të gjitha universitetet çdo shtet i jep të drejtën studentëve që të zgjedhin një qeveri studentore. Në universitet shqiptare kjo qeveri zgjidhet nga vetë studentët të cilët zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Këta përfaqësues zgjedhin qeverinë studentore e cila nga ana e saj zgjedh kryetarin e qeverisë studentore. Në grafikun e mësipërm ne kemi pyetur studentët e kthyer nga migracioni sesa ata janë të përfshirë në forume apo qeverinë studentore. Nga vëzhgimet e përgjigjeve rezulton se 50 studentë janë përfshirë *gjithmonë* në këto aktivitete. Duhet të theksojmë se kjo kategori studentesh vjen nga universitet jo publike dhe këta studentë janë vlerësuar për aftësitë e tyre dhe eksperiencën në universitet perëndimore. Numri i studentëve që ka dhënë përgjigje *shpesh*, *ndonjëherë* dhe *rrallë* është i ulët, respektivisht 28, 22 dhe 21. Ndërsa pjesa më e madhe 74

studentë kanë dhënë alternativën “Asnjëherë” pra nuk kanë qënë pjesë e qeverisë studentore. Analiza e këtij grafiku tregon që universitet nuk e vlersojnë eksperiencën që kanë këta studentë të ardhur nga vendet e europës. Për universitetin përfshirja e tyre nuk përbën ndonjë përparësi.


5.4 Problemet që hasin studentët e rikthyer (Sesioni 4)



Grafiku 5-23 I detyruar për të ndjekur çdo leksion të lëndës

Si një aspekt negative dhe pozitive në të njëjtën kohë shihet të jetë fakti që studentët janë të detyruar të ndjekin çdo leksione edhe pse ndjekja e leksioneve të një lënde sipas Kartës së Bolonjës është një zgjedhje fakultative. Studentë sipas procesit të bolonjës janë të detyruar të ndjekin të gjitha orët e seminareve, ndërsa ndjekja e leksioneve është një liri fakultative e studentëve. Sipas përgjigjeve të studentëve rreth 45% e tyre kanë dhënë përgjigjen së *gjithmonë* detyrohen nga ana e pedagogëve të ndjekin leksionet pasi mungesa në to nuk i bën ata kalues në provim. Ndërsa 35% e studentëve kanë dhënë përgjigjen “*shpesh*” ndjehen të frustruar për të ndjekur leksionet pasi kjo ndikon drejtpërdrejt në notën e tyre si edhe në qëndrimin që do të mbajë pedagogu ndaj tyre. Duke bërë një analizë të përgjigjeve


të dhëna nga studentët del se rreth 80% e studentëve pranojnë se pedagogët i detyrojnë studentët që të ndjekin leksionet pavarësisht se ato janë fakultative. Mund të jenë shumë arsye që pedagogët detyrojnë studentët që të ndjekin leksionet edhe pse ato janë fakultative. Kjo mund të lidhet edhe me të kaluarën dhe formimin e shumë pedagogëve që vijnë nga një kulturë e tillë e mësimdhënies. Vetëm 20% e studentëve kanë dhënë alternativat e tjera dhe vetëm 10% janë përgjigjur se *nuk janë detyruar* që të ndjekin leksionet. Pra në shumë pak raste është parë se ky fenomen praktikohet akoma edhe sot ku presupozohet që universiteti duhet të garantojë lirinë e plotë. Raporti që krijohet midis studentëve dhe pedagogëve nuk është një raporti cili do të përshpejtonte procesin e ri-integrimit të tyre.



Grafiku 5-24: Të detyruar për të ndjekur aktivitete që nuk kanë lidhje me studimet.

Sipas grafikut 23% e studentëve janë përgjigjur se *gjithmonë* kur zhvillohen aktivitete në universitet ata detyrohen që të marrin pjesë në to. Ndërsa 30% e studentëve janë përgjigjur se *shpesh* detyohen që të marrin pjesë në aktivitete që nuk kanë lidhje me studentët. Kur janë pyetur se :”*çfarë lloj aktivitetesh janë këto?*” ata janë përgjigjur se këto kanë qënë


aktivitete si promovime librash nga ana e pedagogëve, konferenca të ndryshme që zhvillohen nëpër universitete. Numri i studentëve që është përgjigjur *ndonjëherë dhe rrallë* është respektivisht 25% dhe 10%. Duhet theksuar se shpesh ndodh që studentët të merren nga auditorët ku zhvillojnë leksione, madje duke nderprerë edhe leksionet e kursit të tyre. Siç del nga grafiku ky është një fenomen i përhapur në universitetet shqiptare. Vetëm një numër i vogël, rreth 12% e studentëve kanë dhënë përgjigjen *asnjëherë* nuk janë detyruar që të marrin pjesë në aktivitete që nuk janë të interesuar.



Grafiku 5-25: Si janë marrëdhëniet pedagog-student

Përsëri edhe tek kjo pyetje ne ju kemi kërkuar studentëve të përgjigjen. Këtu shihet qartë përgjigja e studentëve të cilët janë shprehur se gati 35% e tyre janë thonë se *gjithmonë* kanë patur një marrëdhënie të mirë me pedagogët e tyre. Kur studentët janë pyetur në lidhje për lirshmërinë në marrëdhëniet me pedagogët 40% e studentëve janë përgjigjur se marrëdhëniet e tyre me pedagogët *shpesh* është një marrëdhënie e lirëshme dhe pa eksese. Por gjithësesi ata shtojnë se kjo marrëdhënie lidhet me personalitetin e pedagogut apo edhe


me rëndësinë që ka lënda për studentin. Një numër i vogël studentësh shprehen se marrëdhënia e tyre me pedagogët është e ftohtë, prandaj ata kanë zgjedhur *altrenativat, ndonjëherë dhe rrallë*. Këta përfaqsojnë respektivisht 5% dhe 11% të studentëve të pyetur. Ndërsa një numër studentësh që përbëjnë 9% të numrit të studentëve të pyetur janë shprehur se kanë marrëdhënie të ftohta më pedagogët e tyre. Duke parë këtë grafik del se marrëdhëniet e studentëve të kthyer me pedagogët në të gjitha universitetet shqiptare është një marrëdhënie korrekte.



Grafiku 5-26: Detyrimi për të blerë libra pa dëshirë

Grafiku numër 26 na paraqet një nga problematikat kryesore që ekziston sot në universitetet shqiptare. Studentët e kthyer janë pyetur se: “*a janë të detyruar të blejnë libra pa dëshirë*”? Ata kanë dhënë këto përgjigje. 20% e studentëve shprehen se *gjithmonë* janë detyruar nga ana e pedagogëve që të blejnë libra pa dëshirën e tyre. Ndërkaq 23% e studentëve të pyetur kanë deklaruar se *shpesh* janë të detyruar të blejnë librat e pedagogëve pa dëshirën e tyre. Ndërsa 28% e studentëve janë shprehur se *ndonjëherë* janë të detyruar të blejnë librat e pedagogëve. Kundërpyetja jonë se ku do gjenin ata bazën materiale të studimit pa blerë

librat mori përgjigjen se atyre ju kushtonte më lirë ti fotokopionin ato. Ndërsa kur ne insistuam dhe pyetëm nëse lejohej fotokopjimi në vendet nga ata vinin, ata u kundërpërgjigjën se mund ti gjenin librat pa pagesë në bibliotekat universitare. Grupi i studentëve që *rrallë* e has këtë fenomen përbënte 24% të të intervistuarve. Ndërsa studentët që nuk kanë qënë të detyruar të blejnë librat e pedagogëve të tyre janë 5%. Siç del edhe në grafik fenomeni i shitjes së librave është një problem shqetësues në universitetet shqiptare.




Grafiku 5-27: Presioni i për të mos folur për probleme pasi ndikon në vlerësimin.

Te ky grafik paraqitet përsëri marrëdhënia *student-pedagog*. Grafiku është mjaft interesant, pasi po ta shikojmë bie në sy që pjesa dërrmuese e studentëve 70% e tyre janë shprehur se ndjehen të kushtëzuar për të folur për probleme të ndryshme pasi kjo ndikonte në vlerësimin e tyre. Ky është një numër mjaft shqetësues për lirinë universitare. Ky fakt është edhe më shqetësues po të kemi parasysh që ky kampion studentësh vjen nga një eksperience europiane. Në universitetet prej nga studentët vinin egzistonte një liri e madhe për tu shprehur. Fenomeni i kufizimit të shprehjes ishte me problematik në universitetet e

rretheve. Pothuajse të gjithë studentët qëndiqnin studimet në universitetet e rretheve u përgjigjën se ndjeheshin të kufizuar të shpreheshin. Gati 25% e studentëve janë shprehur se *shpesh* ju është dashur të heshtin pasi të flasësh drejtpërdrejtë kjo ndikon në pjesën e vlersimit të tyre dhe vetëm 5% e tyre përgjigjen me *ndonjëherë*. Pothuajse të gjithë studentët kishin rezerva në të drejtën për tu shprehur, dhe rezultati ndryshon me pyetjen e bërë tek grafiku 5-25.


5.5 Jetesa pas kthimit(*Sesioni 5*)



Grafiku 5-28 Me kë jetoni

Tek ky grafik ne kemi pyetur studentët se “*më kë jetojnë*”?, ata aktualisht. Nga përgjigjet ka rezultuar se 40% e studentëve të kthyer jetojnë me familjarët e tyre. Ky është grupi i studentëve të cilët janë rikthyer me familjet e tyre nga migracioni për shkaqe tërësisht ekonomike. 22% e studentëve të pyetur janë grupi i studentëve të kthyer të cilët pas migracionit jetojnë jo me familjen e tyre por me qera. Duhet nënvizuar se ata janë studentë të cilët janë rikthyer për vazhdimin e studimeve dhe që nuk janë vendosur në qytetin e lindjes por kanë bërë një migracion të brendshëm psh. në Tiranë, Vlorë etj. Pjesa e cila


shprehet se jeton me shokë në ambiente me qera është 14%. 12% e studentëve të intervistuar janë shprehur se jetojnë me shokët e tyre në konvikte studentore. Këta studentë theksojnë se kanë zgjedhur konviktin në pamundësi për të përballuar shpenzimet. 10% e studentëve nuk na kanë dhënë një shpjegim në lidhje me jetesën e tyre.



Grafiku 5-29: Gjendja ekonomike

Tek grafiku numër 29 studentët janë pyetur në lidhje me gjendjen ekonomike dhe nëse të ardhurat e tyre mbulojnë shpenzimet e shkollimit. Nga përgjigjet e dhëna na rezulton se 48% e studentëve të intervistuar theksojnë se ata arrijnë të përballojnë mirë shpenzimet te tyre. Sipas tyre është familja që i ndihmon të përballojnë të ardhurat. 22% e studentëve të intervistuar kanë thënë se gjendja e tyre ekonomike është shumë e mirë dhe ata janë shumë të kënaqur me jetesën e tyre studentore. Këtu duhet të theksojmë se pjesa më e madhe e këtij grupi i studentësh vazhdojnë studimet në universitet jo publike dhe të ardhurat familjare janë të larta. 21% e studentëve të intervistuar thonë se me vështirësi i përballojnë të ardhurat. Ky është grupi i studentëve të cilët kanë patur vështirësi ekonomike edhe në emigracion. 9% e studentëve të pyetur në lidhje me gjendjen ekonomike janë shprehur se kanë një gjendje shumë të vështirë ekonomike. Pjesa më e madhe tyre punonte për të


përballuar shpenzimet për vazhdimin e studimeve. Këta studentë madje thonë se nuk kanë asnjë ndihmesë ekonomike nga shteti shqiptar.



Grafiku 5-30: Shpenzimet mujore

Jo pa qëllim ne tek të dhënat sasiore kemi futur edhe pyetje në lidhje me shpenzimet mujore të studentëve. Në mënyrë që të kuptojmë edhe më qartë sesa janë shpenzimet në muaj të një studenti që është kthyer nga migracioni dhe sesi ata i përballojnë studimet. Tek përgjigjet që na japin studentët vërejmë diferenca të mëdha me shpenzime që kryejnë studentët për shkollimin. 18% e studentëve shprehen se kanë të ardhura të pamjaftueshme prandaj dhe shpenzimet e tyre nuk shkojnë me shumë se 10000 lekë të reja në muaj, ndërsa 19% e studentëve u përgjigjën se shpenzojnë mes 10 mijë dhe 20 mijë lekë të reja në muaj. Këto përgjigje korrespondojnë edhe me gjendjen ekonomike familjare të shprehun në grafikun 5-29. 26% e studentëve u shprehen se shpenzimet mujore janë mes 20000-40000 lekë të reja në muaj, ndërsa 18% e studentëve u përgjigjën se shpenzimet e tyre variojnë midis 40000-60000lekë në muaj. Gati 18% e studentë deklarojnë se kanë të shpenzime mujore që shkojnë nga 60000-80000 lekë të reja. 8% u përgjigjën se kanë shpenzime mbi 100 mijë.


lekë të reja.



Grafiku 5-31: Mbështetja e familjes në të gjitha drejtimet dhe në pagesën e shkollës.

Tek ky grafik ne kuptojmë që familja është një nga mbështetësit kryesorë të studentëve në vazhdimin e studimeve. 65% e studentëve u përgjigjën se *gjithmonë* ata kanë patur mbështetje familjen për pagesat dhe shpenzimet e tjera shkollore. 25% e studentëve të pyetur u përgjigjën se *shpesh* ata kanë kërkuar ndihmën e familjes për të përballuar tarifat e shkollës ose shpenzimet e tyre. 5% e studentëve të intervistuar u përgjigjën me *ndonjëherë* kur pyetën se a kanë patur nevojën e familjes së tyre për të përballuar shpenzimet e tarifave shkollore. 4% e studentëve të pyetur kanë thënë se *asnjëherë* nuk kanë patur nevojën e mbështetjes së familjes për të përballuar shpenzimet pasi ata kanë qënë në marrëdhënie punë të vazhdueshme dhe njëkohësisht kanë ndjekur studimet. 1% e studentëve të intervistuar u përgjigjën se *rrallë* ata kanë patur nevojën e familjes për të përballuar


shpenzimet e tyre. Nga sa mund të shihet pjesa më e madhe e studentëve ka pasur gjithmonë mbështetjen e familjes për të vazhduar studimet.



Grafiku 5-32: Vështirësitë në shkollë dhe biseda rreth tyre në familje


Grafiku i mësipërm na paraqet përgjigjet në lidhje me problematikat që hasen tek studentet në ambientet shkollore dhe gadishmërinë që kanë ata për të diskutuar këto problematika me familjarët. Në rezultatet e sipërpërmendura na rezulton se 70% e studentëve bisedojnë gjithmonë me familjarët e tyre për problematikat shkollore. Madje ata shprehen se vetëm familjarët e tyre mund t'ju japin zgjidhje këtyre problemeve. Këta studentë theksojnë se vështirësitë e ndryshme nuk gjejnë zgjidhje nga universitetet por vetëm nga familjarët. Ndërsa pjesa e cila shprehet se *shpesh* ju duhet të diskutojnë me familjarët për këto probleme janë 30 % e të intervistuarve. Nëse e shohim në kendvështrimin e përgjithshëm do të vëm re se pothuajse të gjitha problematikat gjejnë zgjidhje vetëm nga familja dhe shumë pak problematika gjejnë zgjidhje nga institucionet e Arsimit të Lartë si universitetet apo edhe Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë.

5.6 Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët(Sesioni 6)



Grafiku 5-33: Komunikimi me bashkëmoshatarët për çdo gjë të rëndësishme

Një nga shqetësimet kryesore të këtij kërkimi shkencor është edhe marrëdhënia që studentët kanë krijuar me grupin e studentëve dhe bashkëmoshatarëve të tyre. 35% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *gjithmonë* ata kanë patur një komunikim shumë të mirë me grupin e bashkëmoshatarëve. Po 35% e studentëve të intervistuar janë shprehur *shpesh* ata komunikojnë me grupin e bashkëmoshatarëve. 25% e studentëve të intervistuar shprehen *ndonjëherë* ju ndodh që të diskutojnë me bashkëmoshatarët probleme të rëndësishme. 5% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *rrallë* ju takon të flasin me bashkëmoshatarët e tyre për probleme të rëndësishme. Tek ky grafik ne jemi interesuar të dimë sesa të lehtë e kanë ata integrimin me grupin e bashkëmoshatarëve dhe nga ana tjetër të kuptojmë sa tolerante janë studentët tanë të pranojnë studentët e ardhur nga emigracioni.




Grafiku 5-34: Paragjykimi i shoqërisë për të rinjtë e rikthyer


Duke analizuar grafikun numër 34 në lidhje me paragjykimin nga ana e grupit të bashkëmoshatarëve ne kemi marrë përgjigjen se 55% e studentëve të intervistuar nuk janë ndjerë *asnjëherë* të etiketuar si emigrantë. Ata shprehen se që nga momenti që janë kthyer grupi i bashkëmoshatarëve i ka mirëpritur në grupin e tyre. 35% e studentëve të pyetur janë shprehur me *rrallë* janë ndier të paragjykuar. 3% e studentëve të kthyer nga migracioni theksojnë se *ndonjëherë* janë etiketuar si studentë të kthyer nga migracioni. Ndonjëherë ata janë emërtuar nga grupi i bashkëmoshatarëve të tyre me nofka si “*grekë*” apo edhe “*italianë*” si “*Jorgo*” apo “*Pipino*”. Studentët theksojnë se kjo vjen edhe për shkak të stilit të veshjes apo mënyrës së të folurit e cila ndryshon shumë nga studentët të cilët nuk kanë qënë emigrantë. 4% e studentëve të kthyer e kanë ndjerë këtë paragjykim si grup migrantësh të kthyer. Shihet se shoqëria i mirëpret të rinjtë e rikthyer pa i paragjykuar se pse u kthyen ata nga emigracioni.

Grafiku numër 35 tregon se ne kemi pyetur studentët nëse ata gjejnë ndihmesë studentët për problemet të gjuhës. Sipas grafikut 60% e studentëve shprehën se *gjithmonë* kanë gjetur mbështetje nga grupi i bashkëmoshatarëve në lidhje me problemet gjuhësore dhe kjo bën që

ata të arrijnë të ri-integrohen shpejt me kulturën e vendit të origjinës. Këta studentë shprehen se janë mjaft mirënjohës ndaj grupit të bashkëmoshtarëve dhe shprehin pakënaqësi për universitetet të cilat nuk kanë mundësuar një grup mësimor për të zhvilluar disa orë leksionesh për të përmirësuar nivelin e gjuhës. 30 % e studentëve të intervistuar theksojnë se *shpesh* ata kanë ndihmën e studentëve të tjerë për të kuptuar shumë koncepte që nuk arrijnë ti kuptojnë. 5% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *asnjëherë* nuk e kanë patur mbështetjen e grupit të bashkëmoshtarëve. Ndërsa 5% e studentëve të pyetur theksojnë se *rrallë* ata kanë patur mbështetjen e grupit të bashkëmoshtarëve për problemet e gjuhës.



Grafiku 5-35: Ndihmesa nga bashkëmoshtarët




Grafiku 5-36: Shoqëria me migrantë dhe jo-migrantë


Përsa i përket grafikut numër 36 ne kemi pyetur studentët migrantë nese ata ndjehen plotësisht të ri-integruar në vendin e origjinës. Pyetja që ne ju kemi drejtuar atyre “nëse ne grupin ku ata bënë pjesë ka studentë migrantë dhe jo migrantë?”. 67% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *gjithmonë* ata shoqërohen me grup bashkëmoshatarësh që i përkasin të dyja kategorive si atyre që janë kthyer nga emigracion dhe atyre që janë pjesë e grupit të cilët nuk kanë qënë në emigracion. 33% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *shpesh* ata janë në grup me të dyja grupet si në grupin e studentëve që janë kthyer nga emigracioni ashtu edhe në grupin e studentëve që nuk kanë qënë ne emigracion. Sipas grafikut ne kuptojmë se studentët në grupin e bashkëmoshatëve janë plotësisht të ri-integruar sepse asnjë nga studentët nuk ka zgjedhur altrenativat, *rrallë*, *asnjëherë*, *ndonjëherë* çka tregon se ata e gjejnë veten të ri-integruar plotësisht.

Grafiku numër 37 është një grafik i cili lidhet me shkëmbimin e eksperiencave midis të rinjve migrantë dhe studentëve që nuk kanë qënë në emigracion. Sipas këtij grafiku në pyetjen që ne kemi bërë për studentët që janë kthyer nga emigracioni nëse: “bashkëmoshatarët i pyesin ata për eksperiencën e tyre jashtë vendit”. 75 % e tyre shprehen

se *gjithmonë* studentët e tjerë që nuk kanë studiuar asnjëherë jashtë janë shumë kurioz të dinë rreth eksperiencës atje. 25% e studentëve të intervistuar thonë se *shpesh* grupi i bashkëmoshatëve i pyesin rreth eksperiencave që ata kanë kaluar kur kanë qënë në emigracion. Përsëri edhe tek ky grafik na rezulton se marrëdhënia e studentëve migrantë me studentët e tjerë është mjaft e mirë. Siç na rezulton edhe tek ky grafik asnjëri nga studentët nuk ka zgjedhur alternativën, *rrallë*, *asnjëherë*, *ndonjëherë*.



Grafiku 5-37: Kurioziteti i shoqërisë rreth eksperiencës së këtyre të kthyerve



Grafiku 5-38: Shoqërimi i të rinjve studentë me bashkëmoshatarët e tyre

Mesa shihet 35% e studentëve të intervistuar shprehen se *asnjëherë* nuk shoqërohen me bashkëmoshatarët e tyre jashtë ambiente e universitetit. Kjo nënkupton se ata mbajnë këto marrdhënie vetëm në ambjentet brenda universitetit. 25% e studentëve u përgjigj me *shpesh* që do të thotë se një pjesë e tyre shoqërohen me ta dhe jashtë universitetit dhe ruajnë kontakte të mira shoqërore. 20% e studentëve të intervistuar kanë zgjedhur të përgjigjen me *gjithmonë* pasi ruajnë marrëdhënie edhe jashtë ambjenteve të universitetit. 15% e studentëve të pyetur u përgjigjën se *rrallë* ju ndodh që të shoqërohen me bashkëmoshatarët e tyre. 5% e studentëve të intervistuar u përgjigjën se *ndonjëherë* ata shoqërohen në ambjentet jashtë universitetit. Siç vihet re marrëdhënia shoqërore mes të rinjve të kthyer dhe shoqërisë së universitetit shihet të jetë një marrëdhënie me shumë brenda ambjenteve të universitetit. Studentët shqiptarë jashtë universitetit kanë grup grupet e vjetra shoqërore dhë nuk e favorizon ri-integrimin pasi kështu ata kanë më pak kontakte me njëri-tjetrin.

5.7 Analiza e të dhënave nga pyetsorët në institucionet e universiteteve pubike dhe jo publike

Ashtu sikurse e theksuam edhe më sipër kriza ekonomike është vetëm një nga arsyet që studentët kthehen. Shumica e studentëve të intervistuar erdhën nga Italia dhe Greqia si edhe në pak raste ishin nga vendet e tjera të Europës. Përveç arsyeve ekonomike, studimi tregon se një numër i konsiderueshëm i kthimeve është për arsye “*patriotike*” si dhe perspektivat për një status më të mirë shoqëror, të cilat vështirë se mund të arriheshin në vendet ku kishin emigruar gjatë krizës ose pas krizës ekonomike (Dibra, Semini, & Allmuca, 2016). Vitet e fundit numri i të rinjve të kthyer nga migracioni që kërkojnë përfundimin e studimeve të larta është shtuar shumë. Pengesat janë të shumta dhe të rinjtë kryesisht hasin probleme burokratike ashtu dhe sociale duke e vështirësuar procesin e regjistrimit apo transferimit të

studimeve në vendin e origjinës. Duke qënë se migracioni në vendin tonë ka nisur herët dhe është shtuar me kalimin e kohës ri-integrimi është bërë një fushë shumë e rëndësishme. Sipas Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale: *“numri i migrantëve është shtuar gjatë viteve të fundit por akoma nuk ka një numër ekzakt të studentëve migrantë të rikthyer në vendin tonë qëkërkojmë sigurinë e plotë të garantimit të kushteve për vazhdimin e studimeve nëpërmjet njohjes së diplomave nga shteti ynë”*. Në të njëjtin shkrim mbi politikat e Ministrisë së Punëve dhe Çështjeve sociale theksohet se: *“Është një bashkëpunim që ka marrë, qeveria shqiptare së bashku me BE për ri-rintegrimin e migrantëve edhe mundësia e tyre për të marrë një zanat dhe për të qënë pjesë e strukturave sociale, duke ju përmbajtur lidhjeve të Bashkimit Europian”*⁵.

Nga intervistat e kryera në institucionet e Arsimit të Lartë si sekretaritë dhe zyrat e Këshillimit të Karrierës ne arritëm të japim disa informacione më të plota për reformat e Arsimit të Lartë. Intervistat të cilat u zhvillua në të gjitha universitetet shqiptare si ato publike dhe ato jo publike. Duhet të theksojmë që tek kjo pjesë në kemi intervistuar dy zyra kryesore të universiteteve si sekretaritë mësimore dhe zyrat e Këshillimit të Karrierës pranë sekretarive në të gjitha universitetet. Siç shihet edhe nga rezultatet e më poshtme bashkëpunimi i fakulteteve dhe këtyre zyrave ka qënë i kënaqeshëm. Këtu duhet veçuar vetëm disa vonesa të vogla që u justifikuan nga ana e të intervistuarve si thjesht një procedurë burokratike mbi nxjerrjen e të dhënave. Nga ana e kërkuesit shkencor u deklarua se do të ruhej anonimati dhe respektimi i privatësisë si për institucionet ashtu edhe për vetë individët të cilët morën pjesë në këto intervista.

⁵<http://www.panorama.com.al/2016:6>

Për të bërë përshkrimin e këtyre të dhënave u desh që të ndërtohet një tabelë e cila do të përshkruante moshën, gjininë, pozicionin e punës si edhe emrin e institucionit. U realizuan 10 intervista në universitetet publike dhe 10 intervista në universitetet jo publike në mënyrë që të kishim mundësinë të bënim një shpërndarje të barabartë dhe të bënim një përcaktim më të qartë në lidhje me ri-integrimin e studentëve. Qëllimi ynë kryesor ishte të analizonim mënyrën sesi ata trajtoheshin dhe sesa janë të integruar në universitet tona. Grupmosha e të intervistuarve për punonjësit e institucioneve është relativisht mesatare, nga 29-46 vjeç. Vitet e eksperiencës në punë variojnë nga 3-24 vjet eksperiencë pune. Të intervistuarit e marrë në pyetje, janë pyetur në lidhje me politika e ri-integrimit të studentëve të kthyer nga migracioni.

Nga përpunimi i të dhënave ne vume re që universitetet e rretheve si Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Durrësit, Universiteti i Vlorës kishin një zyrë Këshillimi të Karrierës. Këto universitete vepronin në bazë të një takimi konsultativ në ditë të caktuara që organizonin për të zhvilluar biseda me grupin e këshillimit të karrierës. Ato ishin më tepër takime fiktive sesa ishin jepnin kontribut në punësimin e studentëve.

Pyetësorët janë ndarë në dy sesione **Sesioni A** dhe **Sesioni B**

Tek sesioni A ne kemi pyetur pyetur sekretarët pranë universiteteve nëse: ***“Kanë informacione sesa është numri i studentëve të kthyer?”***.

Shumica e të intervistuarve janë përgjigjur që kanë shumë pak ose aspak informacion për studentët e kthyer dhe nuk kanë shifra të sakta. Pjesa më e madhe e tyre shprehën se kategoria e studentëve që kthehen nga migracioni për të qënë pjesë e universitetit ndjek rrugën e regjistrimit nëpërmjet Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë.

Sekretaret në universitete janë pyetur: ***“A ka studentë të kthyer nga emigracioni në universitetin tuaj që duan të vazhdojnë studimet dhe sa është numri i tyre ?”***

Sekretaria UT: *“Në këtë universitet ne kemi studentë të kthyer mirëpo në lidhje me këtë tematikë unë nuk kam informacion pasi të dhënat nuk janë të përpunuar nga Ministria e Arsimit”*. Përgjigja e marrë nga ky institucion na jep shumë pak apo aspak informacion. Të njëjtën pyetje ne e kemi bërë edhe pranë sekretarisë të Universitetit Europian të Tiranës ku zyra e burimeve njerëzore dhe sekretariati i studentëve na dhanë këtë përgjigje:

Sekretaria UET: *“Po ne kemi studentë të kthyer nga migarcioni kryesisht nga vendet fqinje si Greqia dhe Italia apo edhe studentë që kanë bërë transferim studimesh në vende si Anglia, Hollada, Danimarka etj. Numri i këtyre studentëve nga viti 2006-2017 rezulton të jetë diku me 144 studentë”*.

Duhet të theksojmë se në universitet të tjera jo publike në Tiranë si: “Universiteti Mesdhetar i Tiranës”, “Albania University”, “Tirana Busness University” ku kemi shtruar të njëjtën pyetje, përgjigja që kemi marrë është se nuk kanë një shifër të saktë në lidhje me numrin e studentëve që studiojnë aty dhe që janë kthyer nga migracioni.

Tek universitetet jo publike takimi është bërë me administratorët të cilët luanin edhe rolin e kordinatorit. Po e njëjta përgjigje është marrë edhe nga universitetet e rretheve si Universiteti i Korçës, Universiteti i Vlorës apo edhe Universiteti i Durrësit të cilët nuk ishin në gjendje të na jepnin një përgjigje definitive në numra për studentët e rikthyer nga emigarcioni. Duke parashtruar kategorinë mbi reformat e Arsimit të Lartë për numrin e studentëve të kthyer nga gjendja e universiteteve ne nuk arritëm të paktën të kishim shifra të sakta.

Përsëri në lidhje më pyetjen e radhës ***“ Si bëhet ekuivalentimi i diplomave për kategorinë e studentëve të kthyer?***

Sekretaria e UT thotë se: *”Ne proçedojmë mbi bazën e ekuivalentimit të krediteve dhe suplemenetit të notave në bazë të programit të ardhur nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.”*

Sekretaria e UET:*”Raste të tilla kemi hasur plot dhe në këtë rast ne kemi dërguar diplomat pranë Ministrisë së Arsimit dhe kemi ekuivalentuar kreditet. Brenda universitetit nga ana jonë janë bërë lehtësira por kemi hasur edhe mangësi nga vetë ministria në shumë raste në njohjen e kreditimit të plotë në profilin përkatës pasi është e vërtetë që ne opreojmë me sistemin e Bolonjës por vende si Greqia kanë shumë programe të ndryshme nga ato që ne operojmë.”*

Sekretaria në Korçë:*”Në këto raste ne e çojmë dosjen në Minsitrinë e Arsimit dhe ata na kthejnë përgjigje në cilin vit dhe program mund ti fusim, ne bejmë vetëm regjistrimin në bazë të kreditëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit”*

Sekretaria Vlorë:*”I dërgojmë në Tiranë”*

Sekretaria Shkodër:*”Nuk di çka me të thanë, ne kemi pas shumë pak raste te cilat nuk jemi marrë ne por vet Ministria e Arsimit”. Në gati 10 intervista pranë sekretarive përgjigja që ne kemi marrë nga këto institucione është e vakët, madje në shumë raste ato janë informacione jo korrekte. Shumë pak sekretari na kanë dhënë përgjigje me sistemin e Bolonjës dhe me proçesin e akreditimit, në lidhje me dokumentacionin është folur shumë pak dhe ndoshta aspak. Procesi i njohjes së Kartës së Bolonjës është një proces deri diku i sukseshëm por mangësitë mund të vinin edhe nga mungesa e programe të ngjashme dhe lëndëve të cilat trajtohen në vite akademike të ndryshme. Kujtojmë këtu rastin e vendeve si*

Greqia apo edhe Italia, vende të cilat pavarësisht Kartës së Bolonjës, mundohen edhe sot të ruajnë traditat e shkollave të vjetra filozofike klasike.

Pyetja e radhës është nëse:”**Universitet kanë marrëdhënie më institucionet e tjera që ndihmojnë në proceduar e riakreditimit për të thjeshtëzuar ekuivalentimin dhe regjistrimin?!** Kjo ishte një pyetje e cila morëm pak a shumë të njëjtën përgjigje, që pjesa më e madhe mbulohej nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë nga Agjensitë Publike të Arsimit të Lartë, si edhe nga shkrimet dhe komunikimet e dekanatit, të cilat funksionim nëpër zyra të veçanta siç janë zyrat e kontratave dhe zyrat e burimeve njerzore. Ajo që pamë se në universitetet publike ishte se e gjithë lëvizshmëria bëhej nga sekretaritet. Universitetet private kishin edhe zyra të kontratave dhe zyra të sekretarive të dekanatit të cilat orientonin më mirë studentët për këshillin në regjistrim.

Duke dashur që ta marrin sa më shumë pyetje në kemi parë edhe aspektin tjetër me mënyrën sesi bëhet akreditimi dhe sesi funksionon sistemi i kreditimit. Kësaj pyetje të bërë sekretariteti i janë përgjigjur në mënyra të ndryshme.

Sekretaria e UT: “*Studentët bëjnë ekuivalentimin në Ministrinë e Arsimit dhe pastaj vijnë tek ne. Në bazë të krediteve ne përcaktojmë vitin akademik dhe degën që përfiton me studimet e marra në vendin ku kanë qënë emigrantë*”

Sekretaria e UET: “*Ne i sygjerojmë që të bëjnë akreditimin pranë Ministrisë së Arsimit dhe së bashku me zyrën e akreditimit bëjmë edhe suplementin e diplomave. Ndërsa në rastin e studentëve që bëjnë transefrim studimesh çdo student sjell listën e notave dhe bën ekuivalentimin e vetë rezultateve*”.

Sekretaria e UK: “*Ne si universitet marrim nga ministra ekuivalentimin e diplomave dhe akreditimin e krediteve*”.

Sekretaria e Durrësit: *“Po e njëjta gjë. Është Ministria e Arsimit ajo që përcakton si ekuivalentimin e diplomave ashtu edhe pjesë e transferimit të studimeve mbulohet nga ata. Janë vetë studentët të cilët merren me ekuivalentimin në zyrat e ministrisë”.*

Përgjigjet në lidhje me këtë pjesë kanë qënë të njëjtat edhe në disa universitete të tjera nëpër rrethe. Deri më tani kemi shqyrtuar edhe një herë mundësinë për të parë mënyrën e menaxhimit të sistemit arsimor. Shumë pak nga universitetet që kemi përfshirë në këtë studim mund të thuhet se na kanë sjellë informacione shteruese. Ato nuk ishin bashkëpunuese me studentët. Madje duhet theksuar që përfaqësuesit e këtyre insitucioneve kryesisht sekretaritë kishin shumë pak informacione. Ata ishin të prirur për të mos dhënë përgjigje rreth asaj që ne i kemi pyetur.

Në një nga pyetjet e përpunuara deri më tani në lidhje me marrëdhëniet që kanë universitetet me institucione e tjera parashtroam pyetjen: ***“Universiteti juaj ka marrëdhënie me institucionet të tjera që ndihmojnë studentët në procedura për ta thjeshtëzuar në ekuivalentimin e diplomave?*** Pjesa më e madhe e këtyre institucioneve nuk na ka dhënë një përgjigje specifike. Pjesa më e madhe është përgjigjur *Jo*. Gati mbi 90% e universiteteve kombëtare janë shprehur që nuk kanë asnjë marrëveshje me grupe të tjera interesi. Ata janë shprehur se asnjëherë nuk kanë lidhur marrëveshje me universitetet e huaja nga studentët vijnë apo nga grupe monitorimi për njohjen e diplomave. Ndërsa Universiteti European i Tiranës, pranon që vazhdimisht mundohet të lidhë marrëveshje me universitetet si motra në Europë dhe grupeve të tjera të interesit. Sipas zyrave të UET: *“Po ne kemi kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Arsimit, Agjensitë Publike, si edhe më zyrën e pranimit dhe zyrën e kontratave, si edhe marrëveshje të përbashkëta midis universiteteve”.*

5.7.1 Zyrat e Këshillimit të Karrierës

Punonjësit e zyrave të Këshillimit të Karrierës bëjnë pjesë në grupin e të intervistuarve që lidhet me pjesën e administrimit të jetës studentore. Ky grup ju ofron mundësinë studentëve të krijojnë lidhje me grupet e interesit si bizneset dhe organizatat për punësimin e tyre në të ardhmen. Zyrat e Këshillimit të Karrierës merren me angazhimin e tyre në jetën studentore dhe në krijimin e kushteve të reja sociale

Sesioni B është emërtuar si: **Sesioni i politikave sociale dhe shërbimeve për ri-integrim më të shpejtë**. Tek ky sesion, përfaqësuesve të Këshillimit të Karrierës ju janë bërë pyetje të drejtpërdrejta dhe të hapura në lidhje me ndikimin që ata universitetet shqiptare dhe bashkëpunimin që ofrojnë këto zyra me grupin e interesit. Edhe tek kjo pjesë janë formular rreth 9 pyetje të gjitha me zgjedhje të lirë, pa e detyruar të intervistuarin të përgjigjet më shumë sesa ai dëshiron. **Tek sesioni B** kemi intervistuar kategorinë e punonjësve të zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe pjesën e administratorëve të cilët duhet të theksojmë që shpesh herë patën edhe vështirësi në intervistimin e tyre për shkak të angazhimit dhe ngarkesës në punë.

Pyetja e parë që kishte të bënte me ri-integrimin e studentëve ishte: ***Studentët migrantë e kanë të lehtë të punësohen dhe a kanë ata bashkëpunim me universitetin tuaj?***

UT- *“Studentët më thënë të drejtën në universitetin tonë hasin vështirësi në pjesën e mundësisë të punësimit. Ky është një problem i përgjithshëm dhe jo vetëm për studentët e kthyer nga migracioni. Mendoj që është një situatë që do shumë reflektim nga ana e Ministrisë së Punës dhe Ministrisë së Arsimit për të bërë diçka në këtë drejtim. Pyetja e shtruar nga ju është diçka me vend, por mendoj që ende ka shumë punë për të bërë. Ne akoma nuk mund t’ju garantojmë atyre një mundësi punësimi”*

UET- *“Mendoj që po dhe e argumentoj pse? Sepse zyra e Këshillimit të Karrierës lajmëron gati çdo javë thirrje për punësime verore dhe sezonale për të gjithë studentët. Edhe ata të kthyer nga migracioni janë të përfshirë në aktivitete të tilla të universitetit. Ata janë pjesë e qeverisë studentore dhe dëgjohej çdo kërkesë të tyre. UET është i gatshëm për çfardo lloj bashkëpunimi dhe për çfarëdo lloj novacioni”.*

USH- *“Me shumë vështirësi hasin në aspektin e punësimit. Por edhe ri-integrimi në tërësi mbetet për tu parë. Tek pjesa e punësimit të gjithë studentët jo vetëm të sapo kthyerit kanë problem punësimin”.*

UD- *“Studentët migrantë hasin vështirësi në ri-integrim si në aspektin pedagogjik edhe në aspektin e jetës akademike ashtu edhe në punësimin e tyre. Mendoj që ne nuk merremi shumë me pjesën e përfshirjes në jetën akademike të studentëve dhe nuk kemi kontakte të forta bashkëpunuese”.*

UMSDH- *“Ne përpiqemi të ofrojmë kushte maksimale të gjithëve dhe përpiqemi të jemi transparent me ta në çfardo aspekti. Ne mundohemi që të krijojmë kontakte kyçe me bizneset dhe zyrat e avokatisë.*

UE- *“Nuk ka një politikë të tillë. Gjithësecili nga stafi akademik dhe ndihmës në universitet mundohet ti ndihmojë ata në formë të ndryshme për tu ri-integruar. Kontaktet e bashkëpunimit janë të pakta”.*

Në shumicën e të intervistuarve pjesa më e madhe janë këshillues të zyrave të karrierës. Ata kanë dhënë përgjigje shumë sipërfaqësore dhe shumë pak të detajuara, me përjashtime të vogla ku janë përmendur iniciativat e marra nga universitetet. Ajo që është padiskutim është përgjigja e përgjithshme e të gjitha zyrave të Këshillimit të Karrierës. Është pak a shumë e njëjta situatë. Gati në të gjithë universitetet publike të rretheve si Korça, Vlora,

Elbasani, Shkodra, Durrësi përgjigja ka qënë “*Me vështirësi*”. Universitetet jo publike si UET, UMSDH apo TBU mund të themi që janë shprehur që ne mundohemi të kontaktojmë me zyrat e punës apo edhe institucionet e tregut të lirë duke u mundësuar një punësim. Ne lidhim marrëveshje me banka, zyrat e avokatisë, apo edhe institucione të tjera për të zhvilluar praktikën por kjo lidhet pastaj me aftësitë e vetë studentit. Duke bërë një analizë të tillë edhe në vërtetimin e hipotezës kjo do të jetë një nga pyetjet që do të na japë edhe përgjigjen nën hipotezë.

Universiteti në rolin e punëdhënësit është i padukshëm. Universiteti nuk është garanti që promovon produktin e tij. Fatkeqësisht nuk funksionon si në vendet europiane apo SHBA ku universiteti promovon kualitetin e tij.

Tek pyetja 2 ne jemi marrë edhe me pjesën e shërbimeve, ku paraprakisht kemi shtruar pyetjen. ***“Cilat janë disa nga mundësitë që ju jepen studentëve në mënyrë që ata të ri-integrohen edhe më shpejtë?”***

UET: “Mendoj se mundësitë që UET jep janë të shumta. Pjesëmarrja në inagurime librash, diskutime të hapura në leksione të hapura nga studentë dhe pedagogë, thirrja në konkurse për esse dhe botime më të mira, si edhe thirrje për të qënë pjesë e grupeve apo klubeve të ndryshme sociale si edhe mundësitë për të promovuar talente në konkurse të ndryshme që organizon UET.”

UT: “Mendoj që edhe këtu ne mundësitë i kemi shumë të pakta. Ne mundojmë që ti përfishjmë studentët në aktivitetet që zhvillon fakulteti por edhe këto aktivitetve për shkak të fondeve janë shumë të pakta”.

UK: “Është një nga pyetjet më të vështira” (Pa përgjigje)

UD-(Pa përgjigje).

USH-*(Pa përgjigje).*

USDH- *“Mundohemi ti bëjmë pjesë të aktiviteteve dhe shpesh herë duke qënë se kanë një gjuhë të dytë përpiqemi ti angazhojmë në përkthime apo edhe me projekte të huaja.*

Normalisht mund të themi që ata kanë të gjitha mundësi si studentët e tjerë”.

UV-*“Mundësitë që kanë këta studentë janë të pakta por që ne mundohemi ti angazhojmë duke i lajmëruar dhe duke i ftuar të jenë pjesë e aktiviteve të ndryshme si të gjithë studentët e tjerë”.* Pavarësisht dëshirës dhe përpjekjes së zyrave të Këshillimit të Karrierës mundësitë që jep universiteti janë të limitura. Kushtet në të cilat operojnë universitetet shqiptare nuk i garantojnë studentëve asnjë siguri për t’u përfshirë në projekte serioze.

Pyetja e radhës ishte: ***A keni zyrë të Këshillimit të Karrierës posaçërsht për studentët e rikthyer apo është e njëjta zyrë si për të gjithë studentët e tjerë?***

UET- *“Ne kemi vetëm këtë zyrë të Këshillimit të Karrierës dhe kjo është e hapur çdo ditë nga e hëna ë të shtunë nga ora (08-16). Studentët janë të lirë të marrin pjesë sa herë ata kanë nevojë, edhe pse shpesh herë në takime dhe risi i kontaktojmë edhe vetë sipas grupeve dhe programeve që ofrojmë si me partnerët brenda dhe jashtë”.*

UT- *“Kemi vetëm një zyrë Këshillimi të Karrirës për të gjithë studentët dhe ajo është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte”.*

UE- *“Nuk kemi një zyrë specifike dhe në fakt ne vijmë vetëm ditën e enjte për të bërë takime me studentët dhe kur kemi informacione lamërojmë tek faqja zyrtare e universitetit”.*

UK- *Zakonisht dita e enjte është dita kur ne bëjmë takime me studentët jo vetëm për studentët e kthyer nga emigracioni”.*

UV- *“Kemi zyrat e Këshillit të Karrierës të hapura çdo ditë të javës dhe ofrojmë të njëjtat shërbime si të gjithë studentët e tjerë.”*

USH-*“Kemi zyra por vetëm në ditë të veçanta por nuk mund të them se janë shumë efektive”.*

UMSDH-*“Në çdo ditë të javës kemi takime dhe konsulta me studentët. Nëse ata kanë nevojë ata trajtohen si gjithë studentët e tjerë”.*

Tek kjo pyetje të gjithë intervistuarit na kanë dhënë përgjigje shumë të mbyllura. Ata kanë pohuar egzistencën fizike të këtyre institucioneve por nuk është sqaruar pjesa e projekteve konkrete apo zgjidhjet e drejtpërdrejta për studentët e kthyer në këto universitete.

Në pyetjen e radhës të zhvilluar para këtyre institucioneve ishte ajo e motivimit dhe të përkrahjes sociale: ***A ofroni bursa për këtë kategori studentësh?*** Duke parë në tërësi përpunim e pyetjes në të gjithë universitetet pa përjashtim përgjigja ka qënë e njëjtë se: *“Bursat vijnë nga projektet e ministrisë dhe në bazë të kategorisë së studentit ne i përfishijmë ata në projektet e bursave, të tipit të ekselencës ose të tipit të ndihmës ekonomike”.*

Pyetja e radhës që është edhe pyetja e parafundit në lidhje me këtë problem është ajo e iniciativës së institucioneve universitare për të lidhur marrëveshje me zyrat e tjera për mundësi punësimi. ***Ju vetë si institucion kini marrëdhënie me institucione e tjera në mënyrë që këtyre studentëve t’ju ofrohen rrugë të tjera punësimi jashtë universiteve?***

UET-*“Po ne kemi kontaktet me zyrat e punësimit kemi shkëmbime kontakti, me zyra avukatit si edhe kontakte me banka apo edhe vete me ministrinë e punës dhe të çështjeve socialeku ne mundësojmë shkëmbime dhe dërgojmë studentë për shkëmbim eksperiencash”.*

UT –*“Shumë pak më tepër na janë ofruar vetë bizneset private si Call- center, apo edhe zyrat e punësimit të huaja dhe ne i drejtojmë në këto zyra, mundohemi të krijojmë edhe kontakte me ta herë pas here”*

UK- “Shumë pak kontakte. Ato që na vijnë vetëm nga zyrat e punës INSTAT apo biznese private”.

UV- “Ky është një problem i madh për vetë universitet për të gjitha kategoritë e studentve dhe mendoj që do vazhdojë, ne kemi shumë pak mundësi për të mos thënë aspak në ofrojmëstudentë në treg dhe nuk ju japim asgjë siguri mbi të ardhmen e tyre”.

USH – “Aspak nuk ofrojmë asnjë kontakt të tillë”.

UTB- “Mund të themi më krenari që për shkak të natyrës që kanë universitet ne nxjerrim shumë pak student por pjesa më e madhe punësohen nëpërmjet kontakteve tona. Ne ju ofrojmë atyre mundësinë që të jenë dikush nëpërmjet lidhjeve që krijojmë me vetë bankat shqiptare”.

UMSDH- “Synimi ynë ky është ti ndihmojmë të gjejnë punë. Mundohemi të gjejmë kontakte me të gjitha institucionet e zyrave të punës”.

Ndërsa pyetja përfundimtare e bërë nga ana jonë është pikërisht ajo e planeve që kanë këto insitucione në lidhje me këta kategori studentësh. ***Cili është plani juaj në të ardhmen në lidhje me këtë kontigjent studentësh?***

Si një përmbledhje përfundimtare mund të themi që pjesa më e madhe e universiteve janë përgjigjur që ende nuk ka nje plan apo një projekt në lidhje me këta studentë. Ata do jenë pjesë e planeve dhe projekteve të përgjithshme që harton universiteti mbi studentët në tërësi. Universiteti i Shkodrës dh i Elbasanit në këtë rast na dhanë këtë përgjigje:

USH-“Të vetmin kontakt që ne kemi është Ministria e Arsimit”

UE- “Ne kontaktet na vijnë gjithmonë nga Udhëzimet e Arsimit të Lartë”.

Në pyetjen përfundimtare kemi marrë një përgjigje jo shumë të qartë, çka e bën edhe më të vështirë punën në terren për mbledhjen e të dhënave. Për të shpjeguar në mënyrë më të

qartë procesin e njehsimit të diplomave dhe regjistrimit të studentëve. Për këtë rast në lidhje edhe me objektivat e kërkimit shkencor ne jemi përpjekur të mbledhim informacione në lidhje me zhvillimin e bashkëpunimit midis universiteteve. Në lidhje me mënyrën sesi funksionon sistemi i krediteve për kategoritë e studentëve migrantë të kthyer. Pyetja ishte ***“Mund të më shpjegoni sesi funksionon sistemi i krediteve për kategorinë e studentëve migrantë të kthyer??***

UET- *“Studentët e kthyer nga jashtë mund të bejnë ekuivalentimin e diplomave në Ministrinë e Arsimit dhe më pas të vijnë në UET me dokumentacionin dhe me udhëzimet e përcaktuara nga udhëzimet e Ministrisë së Arsimit. Në këtë rast çdo student paraqet listën e notave dhe programin e lëndëve ku ai do të bëjë ekuivalentimin e diplomës. Ashtu sikurse e kam shpjeguar çdo student i interesuar duhet të na paraqesi një listë notash dhe syllabuset e lëndëve. Më pas ne bëjmë ekuivalentimin e krediteve. Vitin në të cilin ai do të vazhdojë studimet bëhet nëbazë të krediteve të marra. Gjithashtu ne i bëjmë të ditur edhe programin e degës që zgjedh dhenjohjen e programeve të ofruara nga ne”.*

UT- *“Sikurse edhe e kemi parashikuar të gjitha ekuivalentimet janë në përputhje me standartet që ofron Arsimi i Lartë dhe Ministria e Arsimit. Suplementimi nuk bëhet nga ne por është i vendosur nga Ministria e Arsimit”.*

UK- *“ Të gjitha janë përcaktuar nga Ministria e Arsimit”*

UD -*“Janë procedura që ndiqen nga Ministria e Arsimit. Ne bëjme regjistrimin në bazë të krediteve dhe japim informacione rreth programeve që kemi në dipozicion”.*

Në këtë pyetje më duhet të sqaroj se pothuajse të gjitha sekretaritë e universitetve si publike dhe ato jo publike në lidhje me ndihmesën që jepinin, ishte thjesht një ndihmesë burokratike por nuk kishte ndonjë marrëveshje ndërmjetësimi midis dy palëve. Ishte vetë

studenti i cili duhej që të shkonte derë më derë, nëpër institucione dhe të kontaktonte çdo palë pa qënë i ndihmuar nga universitetet. Ai i duhet të kontaktonte privatisht nëpërmjet Ministrisë së Arsimit si edhe të shkonte ndoshta edhe në vendin ku kishte qënë emigrant për dokumenta shtesë. Në këto intervista gjysëm të strukturuar menduam të shqyrtonim tetë pyetje. Pjesa më të madhe e intervistave janë zhvilluar zyrat pranë sekretarive dhe burimeve njerëzore.

Tek pyetja e fundit e bërë nga ana jonë ishte shqetësimi ynë i cili lidhet me faktin nëse studentët hasin pengesa me vazhdimësinë e studimeve aty ka ata i kanë lënë. Shqetësimi ynë lidhej me faktin e njohjes së krediteve. Shpesh herë mosnjohja e krediteve nga universitetet bënte që studentët të rrezikonin kthimin mbrapa një vit të studimeve. Në lidhje me këtë çështje ne kemi shtruar pyetjen: ***Nëse studentëve u njihen kreditet që kanë fituar në universitetin në të cilin ata kanë qënë emigrantë, a ju mundësohet vazhdimi i studimeve direkt në vitin përkatës apo ju krijohen pengesa dhe ju duhet të përsëritin vitin akademik duke ngelur një vit mbrapa?***

UET- “Ne ju bëjmë konvertimin e lëndëve në kredite dhe ju shpjegojmë nëse nuk kanë kredite e plotë ju japim dy zgjidhje :a) ose të japin provimet e atij viti në mënyrë që ta kalojnë në vitin e duhur ose b) mund të përsëritin gjithë vitin dhe kjo vendoset nga vullneti i studentit”

UT- “Zakonisht i jepet prioritet vitit dominues por nëse nuk ka kreditet e mjaftueshme atij i duhet të përsërit vitin. Nëse studenti ka më shumë se 60% të krediteve ne e këshillojmë të bëjë provimet që mungojnë dhe të fitojë vitin pasardhës”

UK- “Nëse ka më pak se 50% të krediteve përsërit vitin”

UD- *“Duhet të them se pa as edhe një diskutim ne ndjekim të gjithë rregullat e Ministrisë së Arsimit dhe e gjitha lidhet me numrin e krediteve të fituara”*

UMSDH- *“E njëjta gjë që kam shpjeguar edhe më sipër. Ne ndjekim udhëzimet e Arsimit të Lartë. Duhet të themi pa as edhe një mëdyshje që ne kemi si politikë universitare ti ndihmojmë duke ju dhënë mundësinë që të ndjekin vitin ku kanë lënë por me kusht që të shlyjnë provimet e vitit që nuk kanë mbushur kreditet”.*

Të paktën në të gjitha univeristetet përgjigja ishte gati e njëjtë. Këto insitucione nuk kishin marrë një inisiativë për të zhvilluar një projekt. As të bënin një propozim për një projekt mbi zhvillim e mëtejshëm të studimeve universitare. Sipas përgjigjeve të raportuara nga institucionet ishte numri i krediteve ai që përcaktonte nëse ata e fitonin vitin akademik dhe jo numri i lëndëve të dhëna. Në shumë raste studentët humbinin edhe vitin akademik për shkak të kurrikulave që ndryshonin nga universitet europiane.

Përsa i përket hipotezës: *“Praktikat e këshillimit mbi Arsimin e Lartë nuk ofrojnë alternativa institucionale në ri-integrimin e studentëve që janë kthyer nga migracioni”*. Siç shihet nga intervistat dhe rezultatet paraprake zyrtar e Këshillimit mbi Arsimin e Lartë nuk ofrojnë *alternativa institucionale* në ri-integrimin e studentëve që janë rikthyer nga migracioni. Mesa evidentohet ende vazhdojnë problematika të tilla. Mesa shihet më shumë se 70% e tyre nuk kishin as edhe një informacion të vetëm mbi kategorinë e studentëve të kthyer nga migracioni. Si pasojë e kësaj mungese informacioni këto zyra nuk arrinin të na jepnin një informacion zyrtar të konfirmuar dhe kjo nuk na e lehtëson mbështetjen e kësaj hipoteze.

Nëse ne analizojmë në mënyrë më të detajuar variablat, atë të varur që është universiteti, variablin e pavarur që janë studentët e kthyer si edhe variablin ndërhyrës të zyrës të

Këshillimit të Karrierës, duke i bashkuar me njëra-tjetrën do të thoshim që hipoteza mund të vërtetohet. Në këtë rast variabli i pavarur studenët nuk ndikohet nga variabli i varur që është universiteti edhe si për rrjedhojë fuqia që jep indikatorin ndihmës këshillimi i karrierës nuk ka efekt ngritës pozitiv. Në përmbledhje të këtij studimi mund të themi se rezulton mjaft shqetësues fakti që realiteti i ri-integrimit të studentëve që janë kthyer nga migracioni ende nuk ka gjetur një zgjidhje përfundimtare nga ana e institucioneve përkatëse.

Madje mund të shtojmë se institucionet e Arsimit të Lartë publik dhe jo publik ende nuk e janë marrë më seriozisht këtë pjesë. Për të mos thënë që ende nuk kanë shifra të sakta mbi numrin e studentëve të rikthyer nga migracioni. Për rrjedhojë mund të themi se dhe mundësitë dhe shanset që ju jepen këtyre studentëve për punësim apo integrim të mëtejshëm janë ende shumë të pakta. Si rezultat janë vetë të rinjtë ata që kanë dhënë një shtysë të madhe në integrimin e këtyre studentëve si edhe në vazhdimin e mëtejshëm të ri-integrimit të vetë studentëve. Ngelet akoma një nga dilemat më të mëdha pjesa e ri-integrimit të kësaj kategorie studentësh. Në këtë mënyrë institucionet në vend si familja, universitetet, Ministria e Arsimit apo edhe instanca të tjera duhet t'u japin akoma më tepër rëndësi këtyre studentëve. Është mjaft e qartë se sot në kohët kur sistemi arsimor në procesin e Bolonjës ofron mundësi të reja bëhet edhe më decisiv mundësia për të hapur dyert e një ri-integrimi të ri arsimor.

UNIVERSITET	BURIMET NJERZORE	KËSHILLIMI I KARRIERËS	ZYRA E KONTRATAVE
UNIVERSITETI I TIRANËS	2	1	+0
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	2	1	+1
UNIVERSITETI MESDHETAR	1	0	+1
UNIVERSITETI I KORÇËS	2	0	+0
UNIVERSITETI I VLORËS	2	0	0
UNIVERSITETI DURRËSIT	1	0	0
UNIVERSITETI I SHKODRËS	2	0	0
UNIVERSITETI I NEW YORK	2	1	-0
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY	2	1	-0
UNIVERSITETI I ELBASANIT	1	0	+0
Total	17	5	2

Tabela 5:1 Përfaqësimi i zyrave të këshillimit të karrierës sipas univesiteteve.

Paraqitja në këtë tabelë na tregon zyrat e përfaqësimit sipas univesiteteve, sipas të dhënave të grumbulluara vërehet se shumica e univesiteteve nuk kishin një zyrë specifike për këshillimin e karrierës. Në rang kombëtarë ne vume re se shumë pak universitet dispononin zyra të këshillimit të karrierës. Sipas përgjigjeve të marra zyrat e këshillimit të karrierës zhvilloheshin vetëm në ditë të caktuar të javës. E njëta gjë mund të thuhet edhe për zyrat e kontratave shumë pak universitet nënshkruanin me studentet një marrveshje mbi tarifat vjetore dhe rregullat studentore.

5.8 Regresioni i shumfishtë

Për t'ju përgjigjur pyetjeve të ngritura që në fillim të studimit është i nevojshëm testimi i hipotezave të përcaktuara më parë. Për të arritur këtë fillimisht është e nevojshme të përcaktohen “faktorët që ndikojnë në ri-integrimin e të rinjve të kthyer nga migracioni në univesitete”.

Analiza e regresionit të thjeshtë në këtë rast është pjesë e trianguaritit (metodës kërkimore të përzgjedhur për studim) dhe është e përshtatshme të përdoret për të parë varësinë mes variablave të marra në shqyrtim dhe të dhënave të mbledhura brenda kuadrit të këtij studimi. Më poshtë paraqiten variablat e marrë në shqyrtim

Variablat	Faktorët
Ri-integrimi përfaqësues	Pjesëmarrja në çdo aktivitet
	Ftesë e drejtëpërdrejtë për pjesëmarrje në aktivitete
	Ftesa e familjarëve dhe miqve në këto aktivitete
	Para-lajmërimi
	Përfshirja në shumë forume në universitet
	Anëtarësimi i klubeve të ndryshme në universitet
	Anëtarësimi në qeverinë studentore
Kodi ligjor i të drejtës studentore	Detyrimi për të marrë pjesë në aktivitete
	Detyrimi për të ndjekur çdo leksion
	Detyrimi për të marrë pjesë në aktivitete jashtë fushës studimore
	Detyrimi për t'u përgjigjur pa dëshirë
	Detyrimi për të qënë pjesë e klubit pa dëshirë
	Detyrimi për të blerë libra pa dëshirë
	Mosshprehja e problemeve për shkak të ndikimit në vlerësim
	Detyrimi për të paguar tarifën shkollore dy herë
Etika e rregullores në shkollë	Korretësia me orarin
	Respektimi i rregullave për veshjen
	Ndërgjegjshmëria për punën e caktu
	Etiketimi si emigrant i kthyer
	Koha e lirë me bashkëmoshatarët pa dhunuar institucionin

Influencimi i familjes	Jetesa
	Konsultimi për të zgjedhur univeritetin
	Tregje të reja
	Rritja e kënaqësisë së studentit
	Komunikim i shpejtë me studentët në universitet
	Gjendja ekonomike aktuale
	Të ardhurat mujore
	Bisedat e pakta për mundësitë e emigrimit brenda familjes
	Ideja e rikthimit, nostalgjia
	Ri-emigrimi pas krizës ekonomike
	Ideja e migrimit e marrë bashkarisht
	Familje patriarkale
	Familje matriarkale
	Rikthimi pas rritjes së gjendjes ekonomike
	Rikthimi për investim në atdhe
	Respektimi i të drejtës dhe lirisë së zgjedhjes
	Rikthimi pa familjen
	Ri-emigrimi pas mbarimit të studimeve
	Mbeshtetja e nga ana e familjes
Impakti i bashkemoshatarëve	Vështirësitë në shkollë

	Komunikimi i gjërave me vlerë nga bashkë-moshatarët
	Mos-paragjykimi
	Ndihma nga bashkëmoshatarët për problemet gjuhësore
	Shoqërizimi me studentë emigrantë dhe jo-emigrantë
	Kurioziteti rreth kthimit nga emigracioni
	Shoqërimi dhe jashtë universitetit
	Përzgjedhja e vendeve të frekuentimit

Tabela 5-2: Faktorët e ndikimit në ri-integrim

5.9 Testimi i hipotezës

Baza matematikore për të arritur një studim të mirëfilltë për këtë temë arrihet nga testimi i hipotezës. Sipas Christensen, Johnson dhe Turner (2015) duhe ndjekur disa hapa për të arritur testimin e saktë të tyre.

1. Përcaktimi i provës statistikore për përdorim
2. Përcaktimi dhe refuzimi i vlerës kritike
3. Përllogaritja e testit statistikor
4. Përfundimi: Refuzim apo pranim
5. Interpretimi i rezultateve

Pjesa më e rëndësishme përkon me përcaktimin e testit për përdorim. Në këtë studim regresioni i thjeshtë si dhe **testi T i hipotezës** u pa si mjeti më i përshtatshëm për testimin e tyre, duke qënë se hipotezat përfshijnë marrëdhënie mes një variabi të varur dhe një apo më shumë të pavarur.

Regresioni i shumëfishtë llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \dots + \beta_k X_k + \varepsilon$$

Ku: Y - është vlera e parashikuar e variablit të varur

β_0 - vlera e y ku të gjithë X = 0

X-variablat e pavarur

$\beta_1 \dots k$ -koeficienti i variablave të pavarura gjatë regresionit.

ε - gabimi standard

Procesi i regresionit tashmë konsiston në fitimin e vlerave të β (beta-s), koeficientit të regresit, që përlllogarisin vlerat reale të y (vlerën e parashikuar të variablit të varur) brenda regresionit. Për të testuar që nuk ka lidhje lineare mes variablave atij të varur dhe atyre të pavarur janë përdorur rezultatet ANOVA të analizës së variancës për të testuar hipotezën e ngritur si dhe rëndësinë e regresionit. Vlera për testimin e H_0 është raporti F. Ky test përdoret për të parë rëndësinë e R që tregon sa i rëndësishëm është modeli në tërësi. Rëndësia përcaktohet në nivelin 0.05 ose më shumë.

5.10.Rezultatet e regresionit

5.10.1 Hipoteza

H1: “Praktikat e këshillimit mbi Asimin e Lartë nuk ofrojnë alternativa institucionale në ri-integrimin e studentëve që janë kthyer nga emigracioni”

H2: “Praktikat e këshillimit mbi Arsimin e Lartë ofrojnë alternativa institucionale në ri-integrimin e studentëve që janë kthyer nga emigracioni”

Për të shqyrtuar hipotezën: **H1**: “Praktikat e këshillimit mbi Asimin e Lartë nuk ofrojnë alternativa institucionale në ri-integrimin e studentëve që janë kthyer nga emigracioni”

variablat e pavarur: Impakti i bashkëmoshatareve në ri-integrim, Kodi ligjor mbi të drejtat e studentëve, Etika e rregullores nëuniversitete, influenca e familjes në vendimin për t’u rikthyer të gjitha variablat, zyrat e këshillimit të karrieres, marrëdhënia pedagog- student, reformat e Arsimit të Lartë në procesin e Kartës së Bolonjës dhe vlerësimin e performancës universitare u futën në një bllok të vetëm. Është treguar dhe arritur në konkluzionin që modeli i regresionit të shumëfishtë paraqet një përqindje të konsiderueshme të variancës për të treguar impaktin e bashkëmoshatarëve në ri-integrim, kodin ligjor mbi të drejtat e studentëve, etikën e rregullores në shkollë, influencën e familjes në vendimin për tu rikthyer, në ri-integrimin e përfaqësuar si edhe për pasojë ndikimin e drejtpërdrejtë të zyrave të Këshillimit të Karrierës dhe administrimit të universiteteve.

Tabela 5-3 tregon se 580.7% e ndryshueshmërisë së vrojtuar në ri-integrimin e përfaqësuar shpjegohet nga tre variabla të pavarur (Impakti i bashkëmoshatareve në ri-integrim, Kodi ligjor mbi të drejtat e studenteve, Etika e rregullores në shkollë, Influenca e familjes në vendimin për tu rikthyer), $R^2 = 0.507$, R^2 e rregulluar = 0.497). Prandaj, impakti i bashkëmoshatarëve në ri-integrim, kodi ligjor mbi të drejtat e studentëve, etika e rregullores në shkollë, influenca e familjes në vendimin për tu rikthyer nuk shpjegojnë ri-integrimin e përfaqësuar në një mënyrë të qartë.

Përmbledhja e modelit

Modeli	R	R ²	R ² e përshtatur	Gabimi standard i vlerësuar
1	.712 ^a	.507	.497	.904

Tabela 5-3: Përmbledhja e modelit të regresionit

a. *Variablat e pavarura*: Impakti i bashkëmoshatareve në ri-integrim, kodi ligjor mbi të drejtat e studentëve, etika e rregullores në shkollë, influenca e familjes në vendimin për tu rikthyer

Për të parë dhe vërtetuar hipotezën përkatëse **H2** që: “Praktikat e këshillimit mbi Arsimin e Lartë ofrojnë alternativa institucionale në ri-integrimin e studentëve që janë kthyer nga emigracioni” u përdor analiza e variancës (ANOVA). Tabela 5-4 ilustron rezultatet e kësaj analize të variancës. Siç mund të shihet nga tabela, raporti i dy katrorëve të mesatare (F) ishte 3.460 (vlera F = 50.202, P < 0.01). Duke qënë se niveli i mesatares së vëzhguar është më i madh se 0.01, tre variablet e pavarur ndikojnë në ri-integrimin e përfaqësuar.

ANOVA^a

Modeli	Shuma e katrorëve	Shkallët e lirisë	Katrori i mesatares	F	Sig.
1 Regresioni	163.949	4	40.987	50.202	.000 ^b
Mbetjet	159.206	195	.816		
Totali	323.155	199			

Tabela 5-4: Tabela ANOVA

a. *Variabli i varur*: Ri-integrimi përfaqësues

b. *Variablat e pavarur*: Impakti i bashkëmoshatarëve në ri-integrim, kodi ligjor mbi të drejtat e studentëve, etika e rregullores në shkollë, influenca e familjes në vendimin për tu rikthyer

Për të testuar hipotezën H2 që koeficienti i pjesshëm i regresionit për variablat e marrë në shqyrtim është i barabartë me zero, janë përdorur statistikat dhe niveli i saj i signifkancës së vëzhguar. Rezultatet janë paraqitur në tabelën 5-5

Koeficientët ^a					
Modeli	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientët e standardizuar	t	Sig.
	B	Gabimi standard	Beta		
1 (Konstantja)	5.017	.394		12.743	.000
Kodi ligjor mbi të drejtat e studenteve	-.297	.079	-.221	-3.775	.000
Etika e rregullores në shkollë	.115	.060	.118	1.911	.057
Influenca e familjes në vendimin për tu rikthyer	-.109	.095	-.072	-1.140	.256
Impakti i bashkëmoshatareve në ri-integrim	-.562	.055	-.681	-10.151	.000

Tabela 5-5: Koeficientet

Variabli i varur : Ri-integrimi përfaqësues

Siç mund të shihet nga rezultatet në tabelën 5-22 H1 pranohet dhe bie poshtë H0. Kodi ligjor mbi të drejtat e studentëve (B = -0.221, t = -3.775, p > 0.001), Etika e rregullores në shkollë (B = 0.118, t = 0.060, p > 0.05) dhe inflenca e familjes për vendimin për tu rikthyer (B = -0.072, t = -1.140, p > 0.05). Peshat beta tregojnë se etika e rregullores në shkollë (B = 0.118) është relativisht më e fortë se Kodi ligjor mbi të drejtat e studentëve (B = -0.221), influencimi i familjes në vendimin për tu rikthyer dhe (B = -0.072) dhe Impakti i bashkëmoshatarëve (B = -0.681) në shpjegimin e Ri-integrimit përfaqësues.

KAPITULLI VI

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1 Përfundime

Ky kërkim shkencor është një humtim në fushat sociale dhe metoda e mbledhjes së të dhënave është sasiore dhe cilësore. Nga prezantimi i të dhënave paraprake na rezulton si grupi i marrë në studim janë migrantët cilët kanë jetuar të paktën një vit jashtë shtetit dhe janë kthyer në Shqipëri. Duke qënë se nuk mund të bënim një studim për të gjitha kategoritë moshore të migrantëve për shkaqe kryesisht financiare ne kemi marrë në shqyrtim vetëm kategorinë e të rinjve nga mosha 18-24 vjeç.

Kërkimi është përqëndruar vetëm tek kjo kategori moshore por në studim janë përfshirë vetëm ata të rinj të cilët ndjekin studimet e larta pranë universiteteve shqiptare. Duke analizuar problematikat që has kjo kategori moshore theksojmë se për këtë grup-moshë është shumë e rëndësishme vazhdimi studimeve të lëna në mes në vendet ku kanë qenë emigrantë. Për ta është e rëndësishme mosndërprerja e studimeve dhe vazhdimi i tyre në universitet shqiptare.

Nga rezultatet paraprake studentët e rikthyer shfaqin probleme të ndryshme në universitetet tona. Ata përballen me problematika gjatë gjithë kohës. Si rezultate paraprake ne vumë re se:

- ✓ 53% e tyre ishin femra dhe 47% ishin meshkuj. Mosha dominante 20-22 vjeç për femrat dhe 18-24 vjeç për meshkujt. Shumica e tyre ishin të regjistruar dhe ndiqnin

studimet e tyre në vitin e tretë bachelor, të përqëndruar në UT, në UBT, UET, UGJ, UV, UK, UB, USH etj.

- ✓ Femrat përbëjnë rreth 6% më shumë sesa meshkujt, ndërsa të shprehura në numra ata që kanë pranuar të jenë pjesë e pyetësorit janë 105 femra dhe 94 meshkuj. Mund të shtonim si informacion shtesë që numri më i madh i femrave mund të lidhet edhe më pjesën e mosfrekuentimit në leksioneve dhe seminareve nga ana e studentëve meshkuj dhe ky mosfrekuentim i rregullt i studentëve meshkuj ndikon në këto rezultate.
- ✓ Numri më i madh i të studentëve të intervistuar është në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Europian të Tiranës. Duhet theksuar se intervistat që janë zhvilluar në universitetet e Tiranës kanë qënë intervista të drejtpërdrejta me studentët. Ndërsa pjesa pjesa më e madhe e intervistave të zhvilluara në universitet e rretheve janë zhvilluar në formatin online duke u kontaktuar nga protalet zyrtare të universiteteve. Nga vetë vështirësia që kishim për të gjetur studentë që përfaqësonin këtë kampion mund të themi se janë dashur gati 8 muaj kërkime në mënyrë që të pëmbushin kriterin të pranueshëm që duhet në një kërkim shkencor për të kryer intervistimin.
- ✓ Shpërndarja në universitetet e studentëve të kthyer nga migracion ka qënë e larmishme. Nga rezultatet e pyetësorit na rezulton se 24% e studentëve i vazhdonin studimet në degët e shkencave të natyrës dhe ato të mjekësisë. Gati 28% janë pjesë e shkencave sociale, ku përfshiheshin shumë profile si filozofi, psikologji, punë sociale, shkenca politike etj. Pjesa më e madhe e studentëve të shkencave sociale kishin bërë transferim studimesh nga universitet europiane si Greqia dhe Italia, Holanda apo edhe vende të tjera të Europës. Rreth 19% e studentëve studionin në

degë për ekonomi. Një numër i konsiderueshëm diku 16% janë pjesë e shkencave të komunikimit dhe të gazetarisë ndërsa pjesa tjetër 13% studionin drejtësi. Pra siç perceptohet nga vetë rezultatet kontigjenti i studentëve të kthyer janë studentë të cilët kanë ambicje për tu arsimuar në profile të rëndësishme të tregut.

Studimi kishte për qëllim të eksploronte problematikat më të mëdha që studentët hasnin në univesitete:

- ✓ Në lidhje me atë se çfarë *dinin ata për rolin dhe statusin e tyre* në këto universitete, studentët janë shprehur se kishin pak ose aspak njohuri në lidhje me rolin dhe statusin e tyre në vendin e origjinës. Shumica e këtyre studentëve shprehen që nuk kishin shumë njohuri mbi migracionin si fenomen të kthimit dhe burimi kryesor i informacionit rreth migracionit ishte shoqëria dhe media. Ata më shumë ishin të njohur me statusin e emigrantit për shkak se kishin jetuar në një vend të huaj por nuk njihnin rolin e migrantit, si edhe të drejtat e tyre në vendin e origjinës. Roli dhe statusi që ata i atribuonin vetes ishte ai i emigrantit dhe jo ai i migrantit.
- ✓ Në analizën e të dhënave një rezultat i rëndësishëm për ne ishte *ri-integrimi në universitet shqiptare*. Në lidhje me ri-integrimin e tyre ata janë shprehur sesi janë ndjerë *relativisht mirë* pranë këtyre universiteteve shqiptare nga të cilat paraparkisht ne morëm përgjigje *relativisht pozitive*. Përpjesë më të madhe të studentëve të pyetur ata theksojnë se: *“ndihma ju ka ardhur nga stafi universitar dhe këtu ata veçojnë rolin e pedagogut”*.

Analizën e këtyre rezultateve ne e kemi parashtruar në gjashtë sesione të ndryshme. Paraprakisht në këto gjashtë sesione ne jemi munduar të përcaktojmë më qartë rëndësinë që kanë universitetet në ri-integrimin e tyre.

- ***Në sesionin e parë*** janë paraqitur të dhëna përshkruese sipas përgjigjeve të dhëna nga studentët na rezulton se 49% e tyre janë konsultuar me familjen për të përzgjedhur universitetin ku ata ndjekin studimet aktualisht. 28% e studentët kanë marrë në konsideratë këshillat nga të afërmit dhe shokët që jetonin në Shqipëri në lidhje me universitetin e përzgjedhur. Shumë pak prej tyre gati 13% u janë drejtuar universiteteve dhe institucioneve arsimore. Sesioni i parë është relizuar në këtë mënyrë në mënyrë që të prezantohet shtrati studimor dhe qëllimi i studimit.
- ***Sesioni i dytë në lidhje me arsyet dhe motivet e kthimit*** na kanë dhënë disa rezultate të rëndësishme. Në mënyrë që të sqaronim arsyet e kthimit u realizua ky sesion. Përgjigjet e arritura nga ky sesion na përcjellin të dhëna interesante sepse pjesa më e madhe e studentëve të pyetur deklaroi faktin :
 - a) *së pari* që nuk ishin kthyer me dëshirë por për shkaqe dhe rrethana të detyruar nga vëndi pritës.
 - b) *së dyti* si një nga faktorët kryesor ishte kriza ekonomike botërore e vitit 2008. Për shumicën e tyre vendimi për t'u kthyer u mor menjëherë pasi erdhi kriza ekonomike. Një pjesë përsëri e konsiderueshme që përbënin rreth 25% nuk e mori vendimin për t'u kthyer nga shpërthimi i krizës por si pasojë e zgjatjes së saj. Ndërsa 20% e studentëve të pyetur e mendonin kthimin si një mundësi, por gjithsesi kriza ekonomike pati ndikimin që ata u kthyen në këtë moment. 15% e studentëve u përgjigjen se fill mbas humbjes së vendit të punës nga ana e prindërve ata vendosën të ktheheshin.

Ne vumë re se një nga arsyt kryesore të kthimit që ishte i detyruar ishte kriza ekonomike kryesisht në të gjithë europën duhet theksuar se ka edhe nga ata studentë të cilët dhanë arsye të tjera. Nga përgjigjet e dhëna rezulton se :

- ✓ Rreth 34% e studentëve u përgjigjën se *gjithmonë*, kanë patur nostalgji për tu kthyer në vendin e origjinës. Duhet të theksojmë se kjo kategori studentësh ka lindur në Shqipëri dhe kishin ikur në një moshë të madhe nga Shqipëria.
- ✓ 23% e studentëve u përgjigjen se *shpesh*, kishin nostalgji për vendin.
- ✓ 25% e studentëve u shprehen se vendimin për t'u kthyer ata e kishin marrë së bashku me familjen e tyre. Ata mendonin se mbas krizës ekonomike do të ishte më mirë kthimi pasi shpenzimet këtu do të ishin më të ulta sesa në vendin ku ata ishin emigrantë.
- ✓ 25% e studentëve të pyetur janë përgjigjur se vendimin për t'u kthyer e ka marrë babai. Babai mendonte se eksperiencia e fituar në emigracion do t'ju ofronte mundësi më të mira në vendin e origjinës.
- ✓ 40% e studentëve të pyetur janë përgjigjur se ata e shihnin të ardhmen në Shqipëri dhe familja e tyre e shihte si një mundësi të mirë investimi. Ky ishte grupi i studentëve të cilët migrimin e shohin me pozitivitet.
- ✓ Ndërsa 20% e studentëve të intervistuar u shprehën se të ardhmen në Shqipëri e shihnin si një mundësi shumë e mirë për të ecur përpara në karrierën e tyre. Në vendin e tyre ata mendonin se do të kishin më shumë mundësi që të zhvillonin një karrierë sipas profilit të diplomës së tyre.
- ✓ 15% e studentëve u përgjigjën se ishte mungesa e dokumentacionit në vendin ka ata ishin emigrantë që i detyroi ata të rikthen.

- ✓ Po 15% e studentëve të pyetur mbi mundësinë e të ardhmes në vendin tonë janë shprehur se ata nuk kishin asnjë alternative tjetër veçse të ktheheshin. 37% e studentëve u përgjigjen se në bisedat me familjen e tyre *gjithmonë* diskutojnë mbi mundësinë e ri-emigrimit.
- ✓ 17% e studentëve të pyetur u përgjigjen me *asnjëherë*, mbi mundësinë e ri-emigrimit. Nga informacionet e mëtejshme që ata dhanë kuptohet se ky grupin ishte ri-integruar në Shqipëri pas rikthimit.
- ✓ Po ashtu 17% e studentëve u përgjigjen se *shpesh*, diskutojnë me familjet për tu rikthyer në vendin ku ata kishin emigruar.
- ✓ 15% e studentëve të kthyer u përgjigjen me *ndonjëherë* mbi mundësinë e ri-emigrimit.
- ✓ Ndërsa 14% e studentëve u përgjigjen me *rrallë* mbi mundësinë e ri-emigrimit.
- ✓ Ndërsa 32% e studentëve u përgjigjen me *shpesh* kur u pyetën se a do të ri-emigronin. Duhet të theksojmë se nëse marrim parasysh një mesatare midis atyre që janë në mëdyshje dhe atyre që janë të vendosur për t'u kthyer numri i studentëve të cilët e mendojnë kthimin në emigracion është më i madh se numri i atyre që duan të qëndrojnë në vendin e origjinës. Çka tregon se në të vërtetë kthimi për ta nuk është definitiv. Duke parë edhe trendin e viteve të fundit ku shumica e të rinjve në Shqipëri po synon emigracionin pa diskutim që numri i të rinjve që duan të largohen do të jetë i madh.

Sesioni 3: Përfshirja e studentëve në jetën universitare.

Tek ky sesion kemi arritur në disa rezultate mjaft interesante. Nga përgjigjet e dhëna nga

ana e studentëve rezulton se:

- Rreth 36% ose 70 studentë janë shprehur se *ndjeheshin mirë* me zgjedhjen që kanë bërë dhe kanë dhënë alternativën *mirë* në mënyrën sesi ata po integrohen në universitet tona. Studentët të cilët janë shprehur se ndjehen *shumë mirë* janë 30% e përkthyer në numra 58 studentë. Ndërsa studentët të cilët kanë thënë që janë *mjaftueshëm* të kënaqur janë diku 26%ose 52 studentë. Duke parë këto rezultate dhe duke i krahasuar me numrin e studentëve që të cilët ndjehen të kënaqur në universitetet publike dhe jo publike ne mund të themi se për këta të rinj integrimi nuk është i vështirë.

Pyetjes në lidhje me ofrimin e ndihmës nga ana stafit universitar dhe administrativ ata na kanë dhënë këto përgjigje:

- ✓ Rreth 44% e studentëve kanë dhënë përgjigjen “*gjithmonë*” kur janë pyetur, sesa kanë qënë të ndihmuar nga stafi akademik i universitet dhe nga stafi administrativ.
- ✓ Ndërsa rreth 37% e studentëve u shprehen se “*ndonjëherë*” kanë gjetur ndihmesë nga pedagogët e tyre dhe kanë argumentuar se jo të gjithë pedagogët janë të gatshëm për të dëgjuar ankesat dhe vështirësitë që ata hasin në leksione dhe seminare.
- ✓ Ndërsa pjesa e studentëve të cilët pranojnë që nuk kanë patur asnjë ndihmesë është diku tek 19.% e përkthyer në numra 38 studentë. Duke patur parasysh numrin e të intervistuar dhe grupin e kategorisë së studentëve 17% e tyre nuk kanë gjetur mbështetje do të theksonim se universitetet nuk ofrojnë një mbështetje maksimale për këtë kontigjent studentësh. Gjithashtu këtu theksojmë që ka edhe studentë të cilët nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje dhe përsëri ne nuk e dimë arsyen. Nëse bëjmë

një matematikë të thjeshtë midis atyre që kanë thënë *ndonjëherë* dhe *asnjëherë* matematikisht del se janë 112 studentë.

- ✓ Të paktën nga 198 përgjigjet e dhëna gati 60 % e studentëve kanë thënë që universiteti duhet të bëjë më shumë për studentët që janë kthyer nga migracioni. Kjo tregon se universitetet shqiptare janë të papërgatitura ose nuk kanë infrastrukturën përkatëse për të pritur studentë që vijnë nga universitetet europiane, qofshin këta shqiptare ose të huaj.
- ✓ Një rezultat tjetër mjaft tregues është edhe ai i cili nga tregon se *përfshirja e studentëve* në jetën universitare është përsëri e pakët. Në lidhje me angazhimin e tyre në jetën studentore ata janë përgjigjur se ndjehen shumë pak pjesë e jetës studentore. Këta studentë na janë shprehur se janë të pakta raste të cilat ata kanë qënë pjesë e aktiviteteve shkollore si edhe pjese e klubeve universitare. Nga 200 studentë të intervistuar 28 studentë deklarojnë se *gjithmonë* janë ftuar në aktivitetet universitare për të qënë pjesë e këtyre evenimenteve. Ndërsa 40 studentë kanë deklaruar se janë ftuar *shpesh* në këto aktivitete për të qënë thjesht vëzhgues dhe jo drejtues ata shprehen se ata kanë qënë në rolin e spektatorit, praktikisht ata kanë shërbyer si numër për të mbushur sallat por nuk kanë përfituar nga kjo pjesëmarrje. Ndërkohë 39 studentë kanë deklaruar se *ndonjëherë* janë ftuar në këto aktivitete por përfitimi përsëri nuk ka qënë i madh. Një kategori e përafërt me dy të parat pra 41 studentë kanë deklaruar se janë ftuar *rrallë* në këto aktivitete. Ndërkohë që një grup prej 50 studentësh janë shprehur se *asnjëherë* nuk janë ftuar në aktivitete që zhvillohen në universitetet e tyre jo. 39 studentë kanë zgjedhur alternativën *ndonjëherë* por pa na ilustruar shpjegime. Në një pyetje të ngjashme jo në lidhje më

aktivitet por në lidhje me formuet e qeverisjes studentore përgjigja ngelet e njëjtë. Pjesa që nuk kishin marrë *asnjëherë* pjesë në forumet universitare ishte 29 student të intervistuar në të gjitha universitetet e vëndit. Nga vëzhgimi, ka rezultuar se ata studentë që ju janë përgjigjur pozitivisht pyetjeve për pjesëmarrje në këto klube janë studentë të universiteteve jo publike ku edhe përzgjedhja e studentëve në forumet studentore bëhet më transparente nga qeveria studentore. Nga vëzhgimet e përgjigjeve rezulton se 50 studentë janë përfshirë gjithmonë në këto aktivitete. Duhet të theksojmë se kjo kategori studentësh vjen nga universitetet jo publike dhe këta studentë janë vlerësuar për aftësitë e tyre dhe eksperiencën në universitetet perëndimore. Numri i studentëve që ka dhënë përgjigje *shpesh*, *ndonjëherë* dhe *rrallë*shtëi ulët, respektivisht 28, 22 dhe 21. Ndërsa pjesa më e madhe 74 studentë kanë dhënë alternativën “*Asnjëherë*” pranuk kanë qënë pjesë e qeverisë studentore.

Sesioni 4. Problemet që hasin studentët e rikthyer.

- ✓ Sipas përgjigjeve të studentëve rreth 45% e tyre kanë dhënë përgjigjen se” *gjithmonë*“detyrohen nga ana e pedagogëve të ndjekin leksionet. Ndërsa 35% e studentëve kanë dhënë përgjigjen “*shpesh*”. Po të mbledhësh këto dy përgjigje del se rreth 80% e studentëve pranojnë se pedagogët i detyrojnë studentët që të ndjekin leksionet pavarësisht se ato janë fakultative.
- ✓ Sipas grafikut të paraqitur në KapitullinV rezulton se 23% e studentëve janë përgjigjur se *gjithmonë* kur zhvillohen aktivitete në universitet. Ata detyrohen që të marrin pjesë në to. Ndërsa 30% e studentëve janë përgjigjur se shpesh detyrohen që të marrin pjesë në aktivitete që nuk kanë lidhje me studimet e tyre. Kur janë pyetur

se çfarë lloj aktivitete zhvillohen në univesitete? Studentët na janë përgjigjur se këto kanë qenë aktivitete si promovime librash nga ana e pedagogëve, konferenca të ndryshme që zhvillohen nëpër universitete, por që shpesh here bëhen për të mbushur sallat dhe në të vërtetë nuk japin një zhvillim të mirëfilltë studimor. Numri i studentëve që është përgjigjur *ndonjëherë* dhe *rrallë* është respektivisht 25% dhe 10%. Këtu shihet qartë përgjigja e studentëve të cilët janë shprehur se gati 35% e tyre janë thonë se *gjithmonë* kanë patur një marrëdhënie të mirë me pedagogët e tyre.

- ✓ Kur studentët janë pyetur në lidhje për lirshmërinë në *marrëdhëniet me pedagogët* 40% e studentëve janë përgjigjur se marrëdhënia e tyre me pedagogët shpesh është një marrëdhënie e lirshme dhe pa eksese. Por gjithësesi ata shtojnë se kjo marrëdhënie lidhet me personalitetin e pedagogut apo edhe me rëndësinë që ka lënda për studentin. Një numër i vogël studentësh shprehen se marrëdhënia e tyre me pedagogët është e ftohtë, prandaj ata kanë zgjedhur altrenativat, *ndonjëherë* dhe *rrallë*. Këta përfaqsojnë respektivisht 5% dhe 11% të studentëve të pyetur. 20% e studentëve shprehen se *gjithmonë* janë detyruar nga ana e pedagogëve që të blejnë libra pa dëshirën e tyre.
- ✓ Ndërkaq 23% e studentëve të pyetur kanë deklaruar se *shpesh* janë të detyruar të blejnë librat e pedagogëve pa dëshirën e tyre. Ndërsa 28% e studentëve janë shprehur se *ndonjëherë* janë të detyruar të blejnë librat e pedagogëve. Grafiku është mjaft interesant pasi po ta shikojm, bie në sy që pjesa dërrmuese e studentëve 70% e tyre janë shprehur se: “*ndjehen të kushtëzuar për të folur për probleme të ndryshme pasi kjo ndikonte në vlerësimin e tyre*”. Ky është një numër mjaft shqetësues për

tëpërcaktuar lirinë e të shprehurit në universitete. Ky tregues na jep edhe përshkrimin e raporteve midis studentëve dhe pedagogëve. Fakti është edhe më shqetësues po të kemi parasysh që ky kampion studentësh vjen nga një eksperience europiane. Në universitetet prej nga studentët vinin egzistonte një liri e madhe për tu shprehur dhe marrëdhënia *pedagog-student*. Fenomeni i kufizimit të shprehjes ishte me problematik në universitetet e rretheve. Pothuajse të gjithë studentët që ndiqnin studimet në universitetet e rretheve u përgjigjën se ndjeheshin të kufizuar të shpreheshin.

- ✓ Gati 25% e studentëve janë shprehur se *shpesh* ju është dashur të heshtin pasi të flasësh drejtpërdrejtë ndikon në pjesën e vlersimit të tyre dhe vetëm 5% e tyre u përgjigjen me *ndonjëherë*.
- ✓ Në lidhje me pjesën ekonomike 21% e studentëve të intervistuar thonë se me vështirësi i përballojnë të ardhurat. Ky është grupi i studentëve të cilët kanë patur vështirësi ekonomike edhe në emigracion. 9% e studentëve të pyetur në lidhje me gjendjen ekonomike janë shprehur se kanë një gjëndje shumë të vështirë ekonomike. Pjesa më e madhe tyre punonte për të përballuar shpenzimet për vazhdimin e studimeve. Këta studentë madje thonë se nuk kanë asnjë ndihmesë ekonomike nga shteti shqiptar.
- ✓ 65% e studentëve u përgjigjën se *gjithmonë* ata kanë patur mbështetje familjen për pagesat dhe shpenzimet e tjera shkollore.
- ✓ 25% e studentëve të pyetur u përgjigjen se *shpesh* ata kanë kërkuar ndihmën e familjes për të përballuar tarifat e shkollës ose shpenzimet e tyre.

- ✓ 5% e studentëve të intervistuar u përgjigjën me *ndonjëherë* kur u pyetën se a kanë patur nevojën e familjes së tyre për të përballuar shpenzimet e tarifave shkollore. 4% e studentëve të pyetur kanë thënë se *asnjëherë* nuk kanë patur nevojën e mbështetjes së familjes për të përballuar shpenzimet pasi ata kanë qënë në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe njëkohësisht kanë ndjekur studimet. 1% e studentëve të intervistuar u përgjigjën se *rrallë* ata kanë patur nevojën e familjes për të përballuar shpenzimet e tyre. Krahas problemit ekonomik ky sesion ka parë edhe aspektin e ri-integrimit të kësaj kategorie.
- ✓ Rreth 50 % e studentëve të intervistuar theksojnë se ata *gjithmonë* nuk janë ndjerë të etiketuar si emigrantë. Ata shprehen se që nga momenti që janë kthyer grupi i bashkëmoshatarve i ka mirëpritur në grupin e tyre. 35% e studentëve të pyetur janë shprehur me *shpesh* ata i etiketojnë akoma si grup emigrantësh. 3% e studentëve të kthyer nga emigracioni theksojnë se *ndonjëherë* janë etiketuar si *studentë të kthyer*. Ndonjëherë ata janë emërtuar nga grupi i bashkë-moshatarëve të tyre me nofka si “grekë” apo edhe “italianë” si “Jorgo” apo “pipino”. Studentët theksojnë se kjo vjen edhe për shkak të stilit të veshjes apo mënyrës së të folurit e cila ndryshon shumë nga studentët të cilët nuk kanë qënë emigrantë. 4% e studentëve të kthyer e kanë ndjerë këtë paragjykim si grup migrantësh të kthyer. Shihet se shoqëria i mirëpret të rinjtë e rikthyer pa i paragjykuar se pse u kthyen ata nga emigracioni. Sipas grafikut 60% e studentëve shprehën se *gjithmonë* kanë gjetur mbështetje nga grupi i bashkëmoshatarëve dhe kjo bën që ata të arrijnë të ri-integrohen shpejt me kulturën e vendit të origjinës. Këta studentë shprehen se janë mjaft mirënjohës ndaj grupit të bashkëmoshtarëve dhe shprehin pakënaqësi për universitetet të cilat nuk kanë

mundësuar një grup për të zhvilluar disa ore leksionesh për të përmirësuar nivelin e gjuhës shqipe. 30 % e studentëve të intervistuar theksojnë se *shpesh* ata kanë ndihmën e studentëve të tjerë për të kuptuar shumë koncepte që nuk arrijnë ti kuptojnë. 5% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *asnjëherë* nuk e kanë patur mbështetjen e grupit të bashkëmoshatarëve. Ata shihet të mos kenë qenë drejtpërdrejt të ftuar në aktivitete po ama në aktivitete ata kanë qënë të ftuar gjithmonë së bashku me familjen e tyre duke treguar kështu që ri-integrimi i tyre bëhet më i lehtë kur përfshihen dhe familjarët.

- ✓ Një tjetër aspekt pozitiv shihet të jetë pjesëmarrja në klube të ndryshme universitare. Pjesëmarrja e qeverisë studentore shihet të jetë pothuajse gjithmonë prezente për ri-integrimin e këtyre të rinjve. Si edhe rezulton nga përgjigjet e dhëna ata gjithmonë janë ndjerë të detyruar të marrin pjesë në aktivitete që s'kanë lidhje me studimet e tyre si dhe të ndjekin leksionet edhe pse ato janë fakultative, duke bërë kështu që ata gjithashtu t'iu përgjigjen me detyrim pyetjeve të pedagogëve. Në të njëjtën kohë shihet të jenë të detyruar të paguajnë tarifë në shkollës dy herë. Ata janë të detyruar të mos flasin për probleme të caktuara pasi ndikon në vlerësimin e tyre.

Duke qënë se Shqipëria ndodhet në fazën më kyçe të zhvillimit të kapitalit njerëzor. Shumë studentë për një farë kohe kanë jetuar jashtë Shqipërisë. Një pjesë e tyre arrijnë të kualifikohen në një mjedis të ndryshueshëm nga vendi ynë. Vitet e fundit janë shënuar si vitet me rikthimin më tëvullshëm të kësaj kategorie studentore. Angazhimi i tyre duhet të jetë sa mikëpritës në mënyrë qëatyre t'u jepet mundësia për tu zhvilluar jo vetëm nëaspektin idividual por po ashtu dhe në kuadrin shoqëror. Duke marrë parasysh nismat e

reja dhe programet për ri-integrim janë të nevojshme politika gjithë përfshirëse dhe afatgjata, përse i përket personave të kthyer të cilët janë ende në proces studimesh. Në këtë aspekt nisma të ndryshme si Fondi i Ekselencës janë inisiativa shumë pozitive. Inisiativë e cila do tju vijë në ndihmë studentëve të kthyer që përfaqësojnë grupin e ekselencës. Për këto arsye është e rëndësishme përfshirja e studentëve sepse:

- Pikë së pari për shkak se *fenomeni i kthimit të studentëve të kualifikuar nuk rezulton* të ketë një plan të mirëfilltë menaxhues. Studentët të cilët rikthehen nuk ju ofrohen shërbime maksimale për shkak se Shqipëria nuk ka ende projekt programe të tilla për kategorinë e këtyre studentëve. Duke qënë se vendet e punës janë të limituara kjo krijon një ambjent jo fort miqësor midis studentëve të kualifikuar jashtë dhe atyre që janë kualifikuar në universitetet shqiptare.
- Së dyti, problemet e ndeshura gjatë kthimit janë të komplikuar. Këtu kemi parasysh faktorë që variojnë nga meritokracia deri tek luftimi i korrupsionit. Ri-integrimi i tyre pengohet duke ndërtuar sisteme të bazuara jo në meritokraci por në favorizime qoftë për sektorin publik dhe për atë privat. E gjitha kjo çon në kërkesa të jo barabarta midis atyre që kthehen dhe atyre që janë kualifikuar në vendin tonë. Duhet theksuar se kapitali njërëzor i vendit posedon individë të cilët janë të nevojshëm në tregun e punës po ashtu në të njëjtën kohë dhe të tjerë të specializuar duke i kaluar mundësitë e limiteve që ofrohen në aspekte të ndryshme në vendin tonë. Si e tillë nga rezultatet e marra deri më tani nga ky studim në mund të propozonim si mjaft efçente disa alternativa mbi të gjithë studentët migrantë që

fitojnë një diplomë në vendet e Europës. Një nga alternativat më efektive dhe më reale do të ishte:

- ✓ Grumbullimi i të dhënave statistikore të update-uara në lidhje me qytetarët shqiptarë që studiojnë jashtë vendit dhe kanë një diplomë nga këto vende. Të dhënat duhet të jenë të sakta mbi ata që janë kthyer, duke vlerësuar kështu siç duhet kapitalin njerëzor në vend dhe në diasporë nëpërmjet hartimit të politikave efikente mbi ri-integrimin.
- ✓ Fokusi drejt një programi që lejon nxitjen e qarkullimit si dhe angazhimin në mënyrë më të drejtë të ri-integrimit në botën akademike dhe kërkim shkencor. Kjo do të sigurojë një transferim të shkencëtarëve në Shqipëri. Duke u nisur nga kontributi i herëpashershëm në mënyrë paralele me investime në kërkimin shkencor dhe nisma për të rritur cilësinë në institucione akademike.

Sesioni 5 Jetesa pas kthimit në vendin e origjinës.

Ky është sesioni i cili trajton rezultatet në lidhje me mënyrën sesi ata e kanë organizuar jetesën pas kthimit, sipas rezultateve paraprake mund të theksojmë se:

- ✓ 22% e studentëve të pyetur në lidhje me vend qëndrimin e tyre nëse ata kanë banesat e tyre apo jetojnë me qira? Duhet nënvizuar se ata janë studentë të cilët janë rikthyer për vazhdimin e studimeve dhe që nuk janë vendosur në qytetin e lindjes por kanë bërë një migracion të brendshëm psh. nga Vlorë në Tiranë etj. Pjesa e cila shprehet se jeton me shokë në ambiente me qera është 14%. 12% e studentëve të intervistuar janë shprehur se jetojnë me shokët e tyre në konvikte studentore. Ndërsa 22% e studentëve të intervistuar kanë thënë se gjendja e tyre ekonomike është shumë e mirë dhe ata janë shumë të kënaqur me jetesën e tyre studentore dhe

kanë zgjedhur të jetojnë vetem. Këtu duhet të theksojmë se pjesa më e madhe e këtij grupi i studentësh vazhdojnë studimet në universitet jo publike dhe të ardhurat familjare janë të larta.

- ✓ 21% e studentëve të intervistuar thonë se me vështirësi i përballojnë të ardhurat. Ky është grupi i studentëve të cilët kanë patur vështirësi ekonomike edhe në emigracion.
- ✓ 18% e studentëve shprehen se kanë të ardhura të pamjaftueshme prandaj dhe shpenzimet e tyre nuk shkojnë me shumë se 10000 lekë të reja në muaj, ndërsa 19% e studentëve u përgjigjën se shpenzojnë mes 10 mijë dhe 20 mijë lekë të reja në muaj. Këto përgjigje korrespondojnë edhe me gjendjen ekonomike familjare të shprehun në grafikun 5-29.
- ✓ 26% e studentëve u shprehen se shpenzimet mujore janë mes 20000-40000 lekë të reja në muaj, ndërsa 18% e studentëve u përgjigjën se shpenzimet e tyre variojnë midis 40000-60000 lekë në muaj.
- ✓ Gati 18% e studentë deklarojnë se kanë të shpenzime mujore mbi që shkojnë nga 60000-80000 lekë të reja. 8% thonë që kanë shpenzime mbi 100 mijë lekë të reja. 65% e studentëve u përgjigjën se *gjithmonë* ata kanë patur mbështetje familjen për pagesat dhe shpenzimet e tjera shkollore. 25% e studentëve të pyetur u përgjigjen se *shpesh* ata kanë kërkuar ndihmën e familjes për të përballuar tarifat e shkollës ose shpenzimet e tyre. 5% e studentëve të intervistuar u përgjigjën me *ndonjëherë* kur u pyetën se a kanë patur nevojën e familjes së tyre për të përballuar shpenzimet e tarifave shkollore. 4% e studentëve të pyetur kanë thënë se *asnjëherë* nuk kanë patur nevojën e mbështetjes së familjes për të përballuar shpenzimet pasi ata kanë qënë në

marrëdhënie punë të vazhdueshme dhe njëkohësisht kanë ndjekur studimet. 1% e studentëve të intervistuar u përgjigjën se *rrallë* ata kanë patur nevojën e familjes për të përballuar shpenzimet e tyre.

Sesioni 6: Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët.

Sipas rezultateve 35% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *gjithmonë* ata kanë patur një komunikim shumë të mirë me grupin e bashkëmoshatarve. Po 35% e studentëve të intervistuar janë shprehur *shpesh* ata komunikojnë me grupin e bashkëmoshatarve. 25% e studentëve të intervistuar shprehen se *ndonjëherë* ju ndodh që të diskutojnë me bashkëmoshatarët probleme të rëndësishme. 5% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *rrallë* ju takon të flasin me bashkëmoshatarët e tyre për probleme të rëndësishme. 60% e studentëve shprehën se *gjithmonë* kanë gjetur mbështetje nga grupi i bashkëmoshatarëve dhe kjo bën që ata të arrijnë të ri-integrohen shpejt me kulturën e vendit të origjinës.

Këta studentë shprehen se janë mjaft mirënjohës ndaj grupit të bashkëmoshtarëve dhe shprehin pakënaqësi për universitet të cilat nuk kanë mundur një grup për të zhvilluar disa ore leksionesh për të përmirësuar nivelin e gjuhës. Ndërsa 30 % e studentëve të intervistuar theksojnë se *shpesh* ata kanë ndihmën e studentëve të tjerë për të kuptuar shumë koncepte që nuk arrijnë ti kuptojnë. 5% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *asnjëherë* nuk e kanë patur mbështetjen e grupit të bashkëmoshtarve. 67% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *gjithmonë* ata shoqërohen me grup bashkëmoshatarësh që i përkasin të dyja kategorive si atyre që janë kthyer nga migracion dhe atyre që janë pjesë e grupit të cilët nuk kanë qenë në migracion. 33% e studentëve të intervistuar janë shprehur se *shpesh* ata janë në grup me të dyja grupet si në grupin e studentëve që janë kthyer nga

emigracioni ashtu edhe në grupin e studentëve që nuk kanë qënë ne emigracion. Sipas grafikut ne kuptojmë se studentët në grupin e bashkëmoshatve janë plotësisht të integruar sepse asnjë nga studentët nuk ka zgjedhur altrenativat, *rrallë, asnjëherë, ndonjëherë* çka tregon se ata e gjejnë veten të ri-integruar plotësisht.

6.2 Rekomandime

- **Për institucionet e Arsimit të Lartë, universitetet, fakultetet dhe departamentet përkatëse:**
 - Të marrin masat e nevojshme për të krijuar një njësi funksionale të shërbimit psiko-social me staf profesional dhe me infrastrukturën e duhur;
 - Të ngrihen grupe të strukturës së mentorimit përstudenttët në çdo fakultet dhe departament,
 - Të mundësohet ngritja e një komisioni vlerësimi në çdo dekanat i cili në bashkëpunim me antarët e bordeve nëpër fakultete (siç është përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë) të vlerësojë të gjitha rastet e studentëve të kthyer,
 - departamentet të kryejë një vlerësim për të siguruar shërbim efektiv dhe cilësor,
 - departamentet përkatëse dhe zyrat e Arsimit të Lartë pranë ministrisë duhet të hartojnë planet për vlerësimin e procesit të ri-integrimit, në afatet specifike dhe me ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces,
 - Ti jepet përparësi promovimit të kësaj kategorie studentore si edhe të ngrihen klubeve/kurset specifike në universitete për t’ju ardhur në ndihmë studentëve

migrantë. Gjithashtu të marren masat e duhura për të planifikuar dhe menaxhuar klubet/kurset plotësuese për këtë kategori studentore,

- Të marrin masa me specifike në lidhje me zhvillimin e dokumenteve dhe rregulloreve për përgatitjen dhe miratimin e kurrikulave me qëllim që të plotësohen nevojat dhe vështirësitë që kanë studentët migrantët por edhe kategoria e emigrantëve në vendin tonë,
- Në bashkëpunim me institucionet e tjera të vendit apo edhe të huaja, organizatat jofitimprurëse të shoqërisë civile, të krijohet mundësia për ngritjen e grupeve profesionale në fushën e mësimdhënës në mënyrë që të ofrohen shërbime efektive në fushën sociale dhe në çështjet e ri-integrimit të studentëve migrantëve.

- **Për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

- Të hartojë dhe të lëshojë një urdhr të veçantë, gjithëpërfshirës dhe të standartizuar për të gjitha universitetet në vend dhe zyrat rajonale të arsimit për ri-integrimin të rinjve të kthyer në sistemin e Arsimit të Lartë;
- Marrja e masave për të zbatuar Urdhrin nr. 344 në të gjitha shkollat dhe universitetet në të gjithë vendin ku shërbimi duhet të ofrohet nga profesionistë të specializuar dhe të sigurojë që dy profesionistë (një punonjës social dhe një psikolog) të mbulojnë një numër të caktuar studentësh;
- Marrja e masave për të hartuar kurrikula plotësuese për kategorinë e studentëve të kthyer. Këto kurrikula duhet të marrin parasysh gjatësinë e qëndrimit në emigracion, arsimimin, kohëzgjatjen në vendin pritës dhe aftësitë intelektuale të secilit student të kthyer;

- Të merren masa për ngritjen e strukturave akademike, mentorë dhe mësimdhënës, ndërtimi i planeve individuale, metodat e punës, llojet e ndërhyrjes, sipas nevojave specifike të secilit student. Menaxhimi i rasteve të bashkëpunimit me shërbimet mbështetëse dhe ofrimin e shërbimit psiko-social për studentët migrantë.
- Përfshirja e asistentëve të pedagogëve si staf arsimor-mësimdhënës, të cilët të punojnë në baza individuale me këta studentë.
- Të respektohet në mënyrë rigoroze Kartën e Bolonjës dhe çdo marrëveshje e arritur me të.
- ministria të jetë sa më e hapur për bashkëpunime të reja me vendet e BE dhe të përfshihet sa më shumë në projektet europiane midis studentëve

- **Për zyrat e Këshillimit të Karrierës së universiteteve**

- Krijimi i grupeve për vlerësimin e nevojave të studentëve në nivel akademik/profesional me qëllim hartimin e planeve të ndërhyrjes për çdo student të kthyer;
- Angazhimi i studentëve në procesin e hartimit të planeve individuale të ri-integrimit me qëllim të lehtësimin e procesit duke e bërë atë më efektiv dhe gjithëpërfshirës;
